



ISSN 2309-3455

Social Studies


Studime Sociale

Vol. 16, No. 6 (60), 2022



- Blerina HAMZALLARI • Zyhdi DERVISHI • Ali PAJAZITI
- Enis SULSTAROVA • Blerta BODINAKU
 - Laurant KOLLCAKU • Sonila TOMORRI • Rina RASIMI
 - Julejda ALIAJ • Vanesa SULMINA
 - Eriola QAFZEZI • Dhurata LAMÇJA
 - Elda SOKOLI KUTROLLI • Lekë SOKOLI

www.sociology.al



“Social Studies” Journal is classified ‘Scientific’ by ANVUR

The journal “Social Studies” is classified as Scientific Journal by ANVUR, the National Agency for the Evaluation of the University System and Scientific Research of Italy - Ministry of Education, Universities and Scientific Research of Italy (MIUR), by decision no. 298, dated 21 December 2021.

The application was made in 2020 by Romina GURASHI (PhD) - from “Sapienza” University of Rome, Deputy Editor of the journal “Social Studies”.

Since 2020, ANVUR has monitored the journal “Social Studies” with international experts, and the official response has been returned by Dott. Marco Malgarini, director of ANVUR, on 19 January 2022.

La rivista “Studi Sociali” è classificata ‘Scientifica’ dall’ANVUR

La rivista “Social Studies” è classificata ‘scientifica’ dall’ANVUR, Agenzia Nazionale per la Valutazione del Sistema Universitario e della Ricerca Scientifica d’Italia - Ministero dell’Istruzione, dell’Università e della Ricerca Scientifica d’Italia (MIUR), con decisione n. 298, del 21 dicembre 2021.

La richiesta è stata presentata nel anno 2020 da Romina GURASHI (PhD), dell’Università La Sapienza, Vicedirettore della rivista “Studi Sociali”.

Dal 2020 ANVUR segue con esperti internazionali la rivista “Social Studies” e la risposta ufficiale è stata data dal Dott. Marco Malgarini, il Dirigente Area Ricerca ANVUR, il 19 gennaio 2022.

Revista “Studime Sociale” klasifikohet si revistë shkencore nga ANVUR

Revista “Studime Sociale” është klasifikuar si revistë shkencore nga ANVUR, Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor të Italisë - Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor (MIUR), me vendim no. 298, datë 21 dhjetor 2021.

Aplikimi është bërë në vitin 2022 nga Romina GURASHI (PhD), Universiteti La Sapienza Romë, njëherësh Deputy Editor e revistës “Studime Sociale”.

Nga viti 2020, ANVUR ka monitoruar me ekspertë ndërkombëtarë revistën “Studime Sociale” dhe përgjigja zyrtare është kthyer nga Dott. Marco Malgarini, drejtor i ANVUR, më 19 janar 2022.

SOCIAL STUDIES [STUDIME SOCIALE]

Vol. 16, No. 6 (60), 2022

Editorial Team

Editor:

Leke SOKOLI – Tirana, ALBANIA

Deputy Editors:

Sejdin CEKANI – Tirana, ALBANIA

Besim GOLLOPANI – Pristine, KOSOVO

Ali PAJAZITI – Skopje, North MACEDONIA

Romina GURASHI – Roma, ITALY

Deputy Editor for Membership and Finance:

Elda SOKOLI KUTROLLI

International Editorial Board

Servet PËLLUMBI – Chair, Albanian Institute of Sociology, ALBANIA

Aida GOGA – University of Tirana, ALBANIA

Agri SOKOLI – St. Louis International School Milan, ITALY

Anisa SUBASHI – Municipality of Tirana, ALBANIA

Apostolos G. PAPADOPOULOS – Harokopio University, GREECE

Arjana MUÇAJ – University of Tirana, ALBANIA

Besnik PULA – Center for the Study of Social Organization; Princeton University, USA

Brunilda ZENELAGA – University of Tirana, ALBANIA

Doreta KUÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Enis SULSTAROVA – University of Tirana, ALBANIA

Erenestina GJERGJI HALILI – University of Tirana, ALBANIA

Goran BASIC – Department of Sociology, Lund University, SWEDEN

Illir GËDESHI – Center for Economic and Social Studies, ALBANIA

Irena NIKAJ – University Fan Noli of Korca, ALBANIA

Jasminka LAŽNJAK – University of Zagreb, CROATIA

Jonida LAMAJ – Albanian-American Development Foundation, ALBANIA

Klea FANIKO – University of Geneva, SWITZERLAND

Klejda MULAJ – University of Exeter, ENGLAND

Konstantin MINOSKI – Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, North MACEDONIA
Kseanela SOTIROFSKI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA
Ledia KASHAHU – University Aleksander Moisiu of Durres, ALBANIA
Matilda LIKAJ – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA
Miranda RIRA – Albanian Sociological Association; ALBSA, ALBANIA
Rando DEVOLE – Researcher AIS Roma, ITALY
Sergiu BALTATESCU – University of Oradea, ROMANIA
Shaban SINANI – Albanian Academy of Science, ALBANIA
Shkëlzen HASANAJ – University of Siena, ITALY
Svetla KOLEVEA – Institute for the Study of Societies and Knowledge, BULGARIA
Tonin GJURAJ – European University of Tirana, ALBANIA
Zana STRAZIMIRI – University of Tirana, Albania

© Albanian Institute of Sociology / Instituti Shqiptar i Sociologjisë

Design: **Orest Muça**

“Social Studies”, Scientific Journal, certified by the Highest Scientific Committee, Ministry of
Education and Science of Albania

Decision no. 170, date 20th of December 2010

Contacts:

Mobile: ++355692044722; ++355694067682

E-Mail: albsa@sociology.al; studime.sociale@gmail.com

www.sociology.al

Contents:

Blerina HAMZALLARI Zyhdi DERVISHI	<i>Këndvështrime teorike dhe Saktësime logjiko-gjybesore në parashtrimin e njohurive të Shkencave shoqërore në gjubën shqipe</i> 5
Ali PAJAZITI	<i>Fetaria në kohë pandemie: Konteksti global dhe ai i Maqedonisë së Veriut</i> 17
Enis SULSTAROVA	<i>Sami Frashëri për qytetërimin, racat dhe kombet</i> 27
Blerta BODINAKU	<i>Një eksplorim i tipareve të ideacionit paranoid dhe hostilitetit në shoqërinë shqiptare</i> 41
Laurant KOLLCAKU Sonila TOMORRI	<i>Impakti shumëdimensional i diabetit te fëmijët e prekur; familjarët e tyre, sistemi shëndetësor dhe shoqëria</i> 51
Rina RASIMI	<i>Roli i mërgatës në zhvillimin e kulturës dhe artit letrar shqiptar</i> 61
Julejda ALIAJ Vanesa SULMINA	<i>Illegal constructions and the “delicate” legalization process</i> 69
Eriola QAFZEZI	<i>Form and/or formality: An insight into retention of evoked meaning(s) through forms of address in English-Albanian translation</i> 79
Dhurata LAMÇJA	<i>Role of technological tools in statistical learning and educational leadership</i> 91
Elda SOKOLI KUTROLLI Lekë SOKOLI	<i>“Studime Sociale”, shifra, fakte dhe përgjithësime</i> 99
Elda SOKOLI KUTROLLI Lekë SOKOLI	<i>“Studime Sociale” – artikujt, autorët e bashkautorët e 60 numrave, 1998-2022 (Index) “Social Studies” - articles, authors and co-authors of 60 issues, 1998-2022 (Index)</i> 107

**KËNDVËSHTRIME TEORIKE
DHE SAKTËSIMË LOGJIKO-GJUHËSORE NË
PARASHTRIMIN E NJOHURIVE TË SHKENCAVE
SHOQËRORE NË GJUHËN SHQIPE¹**

Blerina HAMZALLARI
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Sociologjisë
E-mail: bhamzallari@gmail.com

Zyhdi DERVISHI
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Sociologjisë
E-mail: zderivishi@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Në kompleksitetin e jetës së përditshme në jemi pjesë e strukturave të ndryshme shoqërore, në të cilat mbartim role specifike, të cilat bashkëshoqërohen edhe nga një kontekst i caktuar i nivelit dhe llojit të komunikimit që përdoret në to. Në rrjedhën e viteve gjithnjë e më shumë po vërehet artikulumin me gabime logjike i gjuhës shqipe, jo vetëm në koncepte shkencore të ndërlukuara në mjedise akademike, por edhe në fjalë e njësi frazeologjike të thjeshta që përdoren dendur në jetën e përditshme. Gabime të tilla dhe mungesa e kujdesit për përmbajtjen dhe logjikën gjuhësore shpesh nxit krijimin e situatave të turbullta, me keqkuptime në komunikim dhe deri në konflikt. Është e nevojshme të tejkalohen sa më parë situata kaq problematike, jo vetëm për elegancë akademike në komunikim, por edhe për të shmangur konflikte që burojnë nga komunikimi dhe përforcohen në veprimtarinë e

¹ Ky artikull prek një fushë mjaft të gjerë kërkimi, të cilën autorët synojnë t'a bëjnë objekt të një projekti kërkimor kompleks mbarëkombëtar disa vjeçar (që të përfshijë gjithë hapësirën shqiptare në Ballkan).

jetën e të konfliktuarëve dhe sidomos për të konsoliduar logjikën e të komunikuarit, si një kusht i domosdoshëm i zhvillimit mendor e intelektual të nxënësve dhe studentëve, të të gjithë shqiptarëve. Në përmirësimin e logjikës së komunikimit ndër shqiptarët, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, bashkëndikojnë një tërësi faktorësh si familja e shkolla, media të ndryshme, veçanërisht programe të ndryshme televizive dhe letërsia artistike, komunikimet me teknikat elektronike të sofistikuar etj. Ky artikull është ndërtuar mbi analizën e përmbajtjes së tekstit. Vlerësohet se një element shumë i rëndësishëm që përforcon fuqinë ndikuese të faktorëve të tillë është gjuha e teksteve të lëndëve shoqërore që qarkullojnë në arsimin parauniversitar, që nga klasa e parë deri në atë të dymbëdhjetën. Kemi vërejtur se në logjikën gjuhësore të shtjellimit të teksteve të tillë ka mangësi të shumëllojshme, të cilat ndikojnë në keqformimin gjuhësor dhe intelektual të nxënësve. Ndërkohë që në shoqërinë shqiptare dallgët e anarkisë problematike ende godasin edhe sistemin arsimor, një studim i tillë është një provë për të trajtuar mangësitë kryesore në parashtrimet logjiko-gjuhësore të dijeve shoqërore në tekstet e shkollave, duke filluar me ato të shkollave të mesme. Në shkencat shoqërore përsosmëria është një nocion limit që nuk arrihet, por që lipset synuar vazhdimisht jo vetëm nga autorët e rinj, por edhe nga ata më me përvojë. Për të rilevuar rëndësinë e teksteve të shkollave për formimin e shumanshëm qytetar të shqiptarëve, mjafton të kujtojmë se ndër autorët e parë të teksteve në gjuhën shqipe ka qenë personaliteti më i rëndësishëm për kombin shqiptar pas Gjergj Kastrioti – Skënderbeut, magjistari i fjalës shqipe, poeti kombëtar Naim Frashëri si dhe mjaft rilindës të tjerë të mëdhenj, të cilët kanë shkruar tekste në shqip për shkollat.²

Koncepte kyçe: *tekst mësimor, logjikë gjuhësore, këndvështrime teorike, shkenca sociale.*

Dr. Blerina Hamzallari është drejtuese e njësisë bazë të Sociologjisë në Universitetin e Tiranës që prej 18 janar 2018 e në vazhdim. Ajo ka përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të ciklit të dytë në Sociologji në Universitetin e Tiranës në vitet 2005-2010. Në korrik të vitit 2017 u diplomua “Doktor” në shkencën e Sociologjisë. Nga viti 2012 e në vazhdim ajo ka qenë lektore e disa lëndëve universitare si “Sociologji e familjes”, “Teori sociologjike”, “Tipologji të konfliktit bashkëkohor”, “Hyrje në Sociologji”, “Shkrim akademik”, etj. Interesat kryesore të kërkimit janë: Familja, martesat, të rinjtë, gjinia, konflikti dhe ndërmjetësimi, drejtësia restauruese, komuniteti dhe familjet, farefisnia, komunikimi ndërkulturor etj.

Prof. Dr. Zyhdë DERVISHI është Profesor në Departamentin e Sociologjisë të Universitetit të Tiranës. Në vitet 2012-2016 ka kryer funksionin e drejtuesit të Departamentit të Sociologjisë dhe të drejtuesit të Shkollës Doktorale, pranë këtij Departamenti. Në korrik 1981 u diplomua “Punonjës i shkencave politike” në Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Për rezultate të shkëlqyera në studime Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e shtetit shqiptar e dekoroi me “Medalje e Artë”. Në vitin 1986 mbrojti tezën e doktoratës. Pas vitit 1990 kreu disa specializime afatmesme e afatshkurtra në fusha të sociologjisë së kulturës, të sociologjisë së shkencës dhe të artit në Itali dhe Gjermani. Është lektor i parë i lëndëve universitare Sociologji e përgjithshme, Sociologji kulture, Sociologji njohje arti dhe Komunikim simbolik që zhvillohen në Universitetin e Tiranës. Tekstet dhe monografite e tij janë studiuar dhe studiohen nga studentë të disa degëve si pjesë e programeve të disa lëndëve sociologjike që zhvillohen në disa universitete të hapësirës shqiptare.

² Shënim i rëndësishëm: Duke zbatuar me korrektësi standardet e shkrimit akademik autorët i janë referuar me saktësi teksteve të lëndëve shoqërore, por pa shënuar emrin e autorit ose të autorëve dhe të shtëpive botuese që i kanë botuar ato (Këto të dhëna janë paraqitur të plota në dorëshkrim. Autorët janë të gatshëm t’ia vënë në dispozicion çdo autori ose shtëpie botuese që do t’i kërkojë). Kësisoj do të ketë një shmangie të arsyetuar e të qëllim të nga standardet akademike, sepse këtë studim autorët nuk e vlerësojmë si polemikë me autorët e teksteve dhe me punonjësit e shtëpive botuese, por si ndihmë miqësore dhe përgjegjësi profesionale për përmirësimin e punës së tyre për realizimin e teksteve.

1. (Mbi)Përgjithësime të skajshme, gabime dhe kontradikta

Në shumë tekste të lëndëve shoqërore që qarkullojnë vitet e fundit në shkollat e mesme të Republikës së Shqipërisë ka përgjithësime të skajshme, të cilat nga pikëpamja logjiko-gjuhësore janë të gabuara. Për ta konkretizuar, në hyrje të një teksti “Ekonomia 12” (Tiranë 2018) theksohet: “Së fundmi, ekonomistët analizojnë... pjesën e popullsisë, e cila nuk mund të gjejë punë” (f. 5). Në trajtë kaq të përgjithësuar ky formulim është i gabuar. Në konceptin e popullsisë përfshihen edhe një numër i madh anëtarësh të shoqërisë të pazënë profesionalisht me punë të dy grup-moshave: fëmijët e të rinjtë nën moshën e aftë për të punuar dhe pensionistët. Numri dhe pesha specifike e pensionistëve kanë prirje të rriten ndjeshëm gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit në shumicën e shteteve të botës. Ndër njerëzit që nuk punojnë janë edhe invalidët, numri dhe pesha specifike e të cilëve rriten ndjeshëm nga njëri vit në tjetrin. Formulimi i saktë që shmanë gabimin e sipëranalizuar mund të ishte: *“Ekonomistët analizojnë edhe pjesën e popullsisë në moshë pune dhe të aftë për punë që nuk gjejnë punë”*.

Në mësimin e parë të po të njëjtit tekst është edhe ky përkufizim: “Ekonomia është shkencë që studion se si shoqëria i menaxhon burimet e saj të pamjaftueshme (të rralla) për të arritur maksimumin e mirëqenies për njerëzit” (f. 6). Nuk do të shqyrtojmë aspekte të saktësisë shkencore të këtij përkufizimi. Do të evidentojmë vetëm faktin se në të konsiderohen të njëjtësuar konceptet “i pamjaftueshëm” dhe “i rrallë”. Një mall mund të jetë jo i rrallë, por me shumicë. E megjithatë, mund të jetë i pamjaftueshëm për të plotësuar jo vetëm kërkesat maksimale, por edhe ato minimale të shoqërisë në një periudhë të caktuar të zhvillimit të saj. Ndërkohë, një mall tjetër mund të jetë fare i rrallë, por mund të jetë jo vetëm i mjaftueshëm, por i tepërt në raport

me kërkesat e shoqërisë në një stad të caktuar të funksionimit të saj.

Në fillim të mësimin 4 të kreut të parë të librit të sipërcituar thuhet: “Në sistemin e ekonomisë së tregut burimet prodhuese janë në pronësi të individëve dhe institucioneve private dhe jo në pronësi të qeverisë” (f. 15). Deri në ditët tona nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë qeveri që të mos ketë në pronësi të vet një sasi të caktuar burimesh prodhuese si miniera, pyje, lumenj, liqene etj. Madje, herë pas here, edhe në shtete ku është zhvilluar më hershëm ekonomia e tregut, si Britania e Madhe, Gjermania etj., sektori shtetëror është zgjeruar nëpërmjet rrishtetëzimit të disa burimeve private të prodhimit. Disa rreshta më poshtë në po këtë mësim, theksohet: “Një individ nuk ka pse të ndërtojë një shtëpi, një fabrikë, të pastrojë tokën për ta mbjellë kur dikush (p.sh. qeveria) mund ta konfiskojë këtë pronë për qëllimet e veta” (Po aty). Në kundërshtim me atë që u pohua më lart, kjo frazë flet për pronësi të qeverisë, pra për pronësi shtetërore, qoftë edhe përkohësisht, në formën e objekteve të konfiskuara për motive të ndryshme.

Në një tjetër tekst, “Filozofia 11” (Tiranë, 2017), në mësimin me temë “Shteti ideal dhe bota e ideve” theksohet: “Nuk ka asnjë filozof që në një mënyrë apo në një tjetër të mos jetë ndikuar nga mendimi i Platonit”. Përgjithësim krejt kategorik. Si i tillë, i pasaktë të paktën në dy aspekte kryesore: *Së pari*, ende nuk ka studime komplekse tërësore, të cilat të evidentojnë shkencërisht ndikimet e mendimit filozofik të Platonit të gjithë filozofët që kanë jetuar e krijuar pas tij. *Së dyti*, formulimi i sipërcituar në tekst nënkupton se nga doktrina filozofike platonike janë ndikuar edhe filozofët që kanë jetuar e zhvilluar mendimin filozofik para se të lindte ky filozof i shquar i antikitetit. Gabime të tilla logjiko-gjuhësore do të shmanë nëse do të përdorehin fjalët me kuptime relativizuese si *“Përgjithësisht filozofët që kanë jetuar në kohën kur jetonte Platoni dhe më*

pas”, ose “*Shumica e filozofëve bashkëkohës të Platonit dhe që kanë jetuar më pas janë ndikuar nga filozofia tij*” etj. Shprehje të tilla *gjuhësore* pasqyrojnë ndikimet e shumanshme të Platonit te filozofët e tjerë *brenda kornizave të saktësisë logjiko-gjuhësore e historike*, duke mos përfshirë mundësinë se disa filozofë, që kur Platoni ishte fizikisht në këtë botë e deri në ditët tona mund të mos jenë ndikuar nga filozofia e tij.

2. Sinonime që nuk janë të tillë në çdo kontekst shoqëror

Veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore gjuhëtarët shqiptarë më të kualifikuar si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej etj. kanë argumentuar se gjuha shqipe është e pasur me sinonime. Për këtë problematikë akademiku Jani Thomai ka shkruar: “Sipas konceptit për sinonime leksikore, që formulohet përgjithësisht në letërsinë shkencore shqiptare (studime, tekste, fjalorë), pranohen dy seri sinonimesh: *fjalë me kuptim të njëjtë* (fjalë shqipe – fjalë e huaj, fjalë krahinore – fjalë krahinore etj.) dhe *fjalë me kuptim të afërt* (me dallime thujtë të papërfillshme semantike)... fjalë *bie* ... vjen në “Fjalorin sinonimik...” me rreth 100 sinonime, po kështu folja *bëj* jepet këtu me 90 sinonime, emri *bisk* me rreth 40 sinonime etj.” (Thomai, J.; Samara, M.; Shehu, H.; Feka, Th., 2005:8, 7).

Thellimi i studimeve sociologjike, detajimi i tyre për grupime shoqërore e nënkulturore të ndryshme e deri për individë tregon se disa fjalë, që rëndom trajtohen si sinonime me kuptim të njëjtë ose të afërt nuk janë të tilla në sfonde sociokulturore të ndryshme. Për të ilustruar këtë ide do të analizojmë dallimet kuptimore të fjalëve *atdhe* dhe *mëmëdhe*.

Jo të gjithë gjuhët që fliten nga popujt numerikisht më të mëdhenj të Europës dhe që kanë pasur e kanë më shumë ndikim në zhvillimet kulturore europiane e më gjerë artikulohe në dyja fjalët *mëmëdhe* dhe *atdhe*.

Për shembull në gjuhën frënge qarkullon vetëm fjala *patrie* që ka kuptimin *atdhe*. Në këtë gjuhë nuk qarkullon fjala *mëmëdhe* (Kokona, V., 2008:750).

Ndërsa në gjermanisht *atdheu* shënohet me fjalët *heimat* dhe *heimatland* dhe *mëmëdheu* me fjalën *mutterland* dhe *heimat*. Fjala *heimat* ka më shumë kuptimin *vendlindje* (Dhrimo, A., 2005: 43, 733). Në gjuhën italiane përdoret fjala *patria*, me kuptime kryesore *atdhe*, *mëmëdhe* dhe me kuptim të figurshëm *vendlindje*. Ndërsa fjala *madrepatria* përdoret me kuptimin *atdhe* dhe kryesisht për mërgimtarët me kuptimin *mëmëdhe* dhe *metropol* për kolonitë (Leka, F.; Simoni, Z., 1998: 522, 418). Është domethënës fakti që mërgimtarët italianë që jetojnë në vende të tjera, vendin ku kanë lindur e shenjojnë me një fjalë të përbërë *madre-mëmë, nënë* dhe *padre-baba*. Madje edhe parajsja në gjuhën italiane quhet *patria celeste*, pra *atdheu hyjnor, qiellor* (Colombo, P., pa vit botimi, f. 540).

Në gjuhën angleze përdoren disa fjalë dhe togfjalësha për të shprehur konceptet “atdhe” dhe “mëmëdhe”: *fatherland-atdhe, vendi i lindjes së një personi*; por më dendur përdoret togfjalëshi *the mother country, motherland*, sepse koncepti i lindjes lidhet më nga afër me nënën (Hornby, A.S., 1997: 317, 559).

Në gjuhën ruse artikulohe më dendur tri fjalë për të shenjur atdheun: *otçerstvo, otçizna* dhe *rodina* me kuptimin *vendi i lindjes dhe i rritjes së njerëzve të caktuara* (Ozhegov, C.I., 1953:422, 425, 628). Në fjalorët anglisht-rusisht dhe italisht-rusisht, botime akademike shtetërore të ish-Bashkimit Sovjetik, fjalët *motherland* dhe *madrepatria* janë shpjeguar me barasvlerëset e tyre *otçestvo, rodina* dhe *otçizna* (Muller, V.K., 1967: 491; Skvarzova, N.; Maizel, B., 1972:486). Fjala *otçestvo* është e gjinisë asnjënjëse, ndërsa dy të tjerat të gjinisë femërore.

Në gjuhën shqipe përdoren dy fjalë për të karakterizuar vendin, në kuptimin e gjerë

të fjalës, ku lind një njeri, ku kanë lindur prindërit e tij ose më të parë të tyre: *mëmëdhe dhe atdhe*. Rilindasit tanë të mëdhenj Naim Frashëri, Naum Veqilharxhi, Petro Nini Luarasi, Sami Frashëri etj. përdornin më dendur termin “mëmëdhe” për Shqipërinë. Artikulonin me gojë e me shkrim këtë term për të shprehur afrinë me tokën e të parëve, e cila lëngonte nën pushtimin prej Perandorisë Osmane. Mëmëdhe shpesh karakterizohej edhe si “dheu mëmë” ose si “dheu i mëmës”.

Në poemën “Bagëti e Bujqësija” poeti kombëtar Naim Frashëri, një nga udhëheqësit shpirtërorë të ballit të parë të Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve, shprehet me kuotat më të larta të mëmëdhedashurisë dhe me thjeshtësi rrëqethëse: “*Shqipëri, o mëma ime*” (1995:21). Ndërsa Andon Zako Çajupi në pak vargje krijon një vizion sintetik poetiko-filologjik, pothuajse holistik për mëmëdheun, si përgjithësim i mendësive të shqiptarëve: “*Mëmëdheu qubet toka/ ku më ka rënë koka.../ stërgjyshërit ku kanë qenë/ dhe varret që kanë vënë/ ku jam rritur me thërrime/ ku kam folur gjuhën time.../ ku rroj në gaz e në shpresë,/ ku kam dëshirë të vdes*” (2018:14).

Në vetëdijen e shqiptarëve të shoqërisë tradicionale lidhjet e shumëfishta me atdheun/ mëmëdheun ishin ose përfytyroheshin aq të forta, saqë përshkonin edhe botën e nëndheshme, të të shumtëve. Përfytyrime të tilla janë sendërtuar në krijime folklorike të shumëllojshme si proverba, këngë etj. Ka fuqi tronditëse thirrja-klithmë e një nëne e shprehur në 4 vargje: “*Bën ç’të bësh të thotë nëneja/ Po atje të mos më mbetesh,/ Shqelmo varrin, ngrahu eja/ Në tokën tënde të tretesh*” (Vasili, K.; Mustaqi, A., 1981:391).

Ndërkohë fjala “atdhe” shpreh dheun e lindjes të atit ose të babait. Në fjalorin e hartuar prej 5 gjuhëtarëve, nga më të shquarit të seksionit të Gjuhës dhe të Letërsisë (Instituti i Shkencave), të botuar në vitin 1954, këto dy fjalë konsiderohen dublete sinonimike ose sinonime me kuptim të njëjtë: “ATDHE-U em. Vendi ku kemi

lerë dhe i të cilit jemi qytetarë” (1954:20). Në faqen 309 të këtij fjalori parashtrohet kuptimi i fjalës: “MËMËDHE-U em, Atdheu”. Në këtë fjalor nuk ka asnjë nuancë kuptimore tjetër për këto dy fjalë të karakterizuara si sinonime identike.

Në “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”, të përgatitur për botim nga Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë (në përbërje të Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë), të botuar në vitin 1980 fjalët *atdhe* dhe *mëmëdhe* përcaktohen si sinonime: “ATDHE-U m. 1. Vendi ku kemi lindur e jetojmë ne dhe ku kanë jetuar të parët tanë, vendi ku banon prej kohësh një popull a një komb, mëmëdhe... 2. Vendi ku lind e zhvillohet diçka për herë të parë, vendi prej nga buron a vjen diçka; vend i përshtatshëm për lulëzimin e diçkaje” (f. 67). Në faqen 1126 të këtij fjalori: “MËMËDHE~U m. lart. Atdhe”.

Edhe në fjalorët sinonimikë më të zgjeruar të botuar pas vitit 1990 nuk vihen në dukje dallime në nuancat kuptimore ndërmjet fjalës *atdhe* dhe *mëmëdhe*. Madje në krijime poetike të ndryshme artikulimi i fjalëve *atdhe* dhe *mëmëdhe* përcaktohet nga përpjekjet e poetëve për të balancuar numrin e rrokjeve ndër vargjet e poezive me metrikë të rregullt.

Përdorimi i këtyre dy fjalëve nuk është rastësi, por edhe nuk janë sinonime identike. Për të kuptuar dallimet ndërmjet tyre do t’i referohemi jetës dhe veprimtarisë së njerëzve që i kanë prindërit me përkatësi të ndryshme kombëtare. Më shpesh ndodh që njerëz të tillë të përfshihen me përparësi në linjën e interesave zhvillimorë të atdheut, domethënë ta identifikojnë veten me përkatësinë kombëtare të babait. Kjo ndikohet edhe nga fakti se shumica e njerëzve në botë mbajnë zyrtarisht mbiemrin e babait. Përvoja historike tregon se në situatën e konfliktive të ashpra ndërmjet strukturave politiko-ushtarake shtetërore të kombit të cilit i përket babai dhe atyre të cilave u përket nëna, njerëz të tillë janë angazhuar me përparësi ose tërësisht në anën e atdheut ose të mëmëdheut.

Në vitet 1930 dhe përgjatë Luftës së Dytë Botërore (deri në vitin 1944) informatori më inteligjent që ka ndikuar më shumë në ruajtjen e jetës së miliona njerëzve të popujve të angazhuar në luftë kundër Italisë fashiste, Japonisë militariste dhe sidomos Gjermanisë naziste, ka qenë Rikard Sorge (4 tetor 1915 – 7 nëntor 1951), i cili njihet si gazetar gjerman dhe informator i Bashkimit Sovjetik. Babai i tij ishte me kombësi gjermane, çka e ndihmoi atë të fitonte besimin e ambasadorit të shtetit nazist gjerman të akredituar në Tokio të Japonisë. Në prag të shpërthimit të konfliktit më të përgjakshëm në historinë e shoqërisë njerëzore ndërmjet ushtrisë naziste gjermane dhe Ushtrisë së Kuqe dhe popujve të ish-Bashkimit Sovjetik, Rikard Sorge, me informacionet e tij ndihmoi luftën e drejtë, mbrojtëse të popujve sovjetikë. Kështu Rikard Sorge i shërbeu mëmëdheut (kishte nënë ruse), duke përkrahur luftën çlirimtare të tij kundër luftës pushtuese, të padrejtë, të imponuar nga qarqet agresive, shoviniste të atdheut të tij. (Korolkov, J., 2007:54, 74).

Sidomos përgjatë dy dhjetëvjeçarëve 1915-1935 skenat teatrore më prestigjioze të Europës e më gjerë i tronditi me fuqinë e tij interpretive të jashtëzakonshme, me aktrimin e kryeroleve të tragjedive më të mëdha të njerëzimit, gjeniu Aleksandër Moisiu (1879-1935). Kritikët më të kualifikuar të artit dramatik, regjisorët dhe aktorët më të shquar bashkëkohës vërenin se në fuqinë interpretuese të Moisiut kishte shpërthime emocionale të veçanta, krejt origjinale që nuk ishin karakteristike për karakterin e italianëve, spanjollëve, gjermanëve, anglezëve etj. Një situatë e tillë ngriti shumë pikëpyetje për përkatësinë kombëtare të këtij aktori genial. Por këtë rebus e zgjidhi vetë Aleksandër Moisiu me deklaramë fare të qarta: “Unë jam rritur në Shqipëri dhe jo në Itali. Sigurisht që këtu kam shkuar në shkollë dhe kam jetuar, por babai im është shqiptar dhe nëna ime është shqiptare nga arbëreshët... Gjaku im i përket origjinës

sime dhe origjina është ajo që thotë fjalën e fundit. T’i shikosh shqiptarët në jetë, duken si njerëz shumë të qetë, por gjithë ajo qetësi shndërrohet në fuqi luani nëse dikush i prek në sedër ose në të drejtën e tyre...” (Shih: Kosova, B., 2002:16). Kështu përkatësia kombëtare, “gjaku” i kombit përcakton shpesh mjaft elemente të modeleve të sjelljes së njerëzve, qofshin këta të zakonshëm ose gjeni, në art ose shkencë, politikë ose veprime luftarake etj.

3. Keqkuptime të pronorëve dhe të antonimeve

Në tekstet e lëndëve shoqërore që qarkullojnë në shkollat e mesme ka përdorime pa vend e deri keqpërdorime të pronorëve, trajtime si antonime të fjalëve, të koncepteve që nuk janë të tillë. Për shembull në tekstin “Qytetaria 10” (botim i vitit 2009), theksohet me shkronja të zeza: “*Tërheqja afektive ndaj seksit të kundërt* është një tjetër problem që i shqetëson adoleshentët. Duke e ndierë veten të rritur ai/ajo kërkon të hyjë në kontakte me seksin e kundërt” (f. 107). Edhe në punime monografike konsiderohen gabimisht antonime këto fjalë dhe të tjera në linjë gjinore. Për këtë mjafton t’i referohemi një botimi të realizuar nga struktura shkencore gjuhësore me titull “Antonimet e gjuhës së sotme shqipe”: “Antonimet e plota kanë kuptime krejtësisht të kundërta. Ato janë të krijuara në polaritete ekstreme me skaje të theksuara kundërvënëse. Të tilla janë: jetë-vdekje, burrë-grua, babë-nënë” (Goçi, I., 1985:42, 43). Edhe nëse ka një traditë gjuhësore që fjalë të tilla i konsideron si antonime, është e nevojshme që këto fjalë të nxirren jashtë skemës së kundërshtisë edhe si pjesë e përpjekjeve të shumanshëm për të sfumuar e tejkaluar mjaft kontradikta ndërmjet njerëzve me përkatësi gjinore të ndryshme. Përkatësisht vajza dhe djali, gruaja dhe burri (edhe si bashkëshorte), nëna dhe babai janë krijesa njerëzore që

kanë shumëçka të përbashkët në shumë tregues jetikë. Ato dallohen biologjikisht nga përkatësitë e veçanta gjinore (nuk është mirë që në tekste të artikulohen fjalët *dallime seksuale*), të cilat në rrjedhën e kohës janë reflektuar në një seri dallimesh në staturë ekonomike e politike, arsimore e shoqërore etj.

Dallimet gjinore dhe dallime të tjera që burojnë natyrshëm prej tyre e zbukurojnë harmonikisht spektrin e funksionimit e të zhvillimit të shoqërisë. Edhe trajtimi gjuhësor i krijesave njerëzore të ndryshme për nga përkatësia gjinore si krijesa të kundërta e përforcon frymën e konfliktualitetit në shoqërinë shqiptare, e cila veçanërisht këta dy dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XXI ka qenë mjaft problematike. Ndoshta do të mbetet e tillë edhe në të ardhmen, së paku të afërt. Mendojmë se artikulli në tekste shkollorë, në media të ndryshme dhe në biseda të përditshme i njerëzve me përkatësi gjinore të ndryshme si krijesa të dallueshme në disa profile dhe jo si *“seks të kundërt”*, do të ndikojë në sfumimin e kontradiktave me sfond gjinor, në shtensionimin e shoqërisë shqiptare në tërësi.

4. Pasaktësi në kuptimin e funksioneve të ligjeve dhe të incestit

Në një tekst “Qytetaria 10” (Tiranë 2009) gjenden edhe karakterizime të tilla: “... ligji kontrollon dhe dënon këdo që e shkel atë” (f. 12).

Kjo mënyrë të shprehuri ngjan me bisedat e rëndomta të njerëzve me nivel arsimor të pamjaftueshëm. Është e nevojshme që gjuha e teksteve të lëndëve shoqërore të ngrihet mbi nivele të tilla vulgare, të cilat, në një vështrim teorik, humbin edhe logjikën gjuhësore. Ligji në vetvete nuk ka asnjë fuqi reale, praktike për të kontrolluar dhe, aq më pak, për të dënuar ndonjë njeri, pavarësisht nga krimet që ai ka kryer. Ligji përkatës, pjesë të caktuara të legjislationit në tërësi, normojnë veprimtarinë e strukturave

përkatëse të drejtësisë si prokuroria, gjykatat, përmbarimi etj. për ndëshkimin e njerëzve që kryejnë veprime penale.

Në këtë tekst parashtrohet një kuptim i gabuar për incestin: “Incesti ka të bëjë me lidhjet seksuale midis personave në lidhje gjaku” (f. 55). Shoqëria tradicionale shqiptare, madje edhe ajo e ditëve tona është mjaft ekzogame. Sipas normave kulturore kanunore shqiptarëve u ndalohej të martoheshin nëse nuk ishin në linjën e fisit të babait më larg se 400 breza dhe në linjën e lidhjeve fisnore të nënës më larg se 100 breza (Gjeçov, Sh., 1993: 23-24).

Por, në rrjedhën e historisë, shumë martesë edhe ndër shqiptarë janë realizuar ndërmjet të reja dhe të rinjve pa respektuar largësinë e brezave të përcaktuara nga normat kanunore. Praktikisht shqiptarët nuk mund t’i njohin paraardhësit e tyre para 400 brezash në linjën e babait, domethënë paraardhësit e tyre para 10-12 mijë vitesh. Në shoqërinë tradicionale bëhej kujdes që të mos martoheshin të reja dhe të rinjtë, të cilët ishin më të afërt se kushërinj të rendit të shtatë. Në disa shoqëri si ajo turke, izraelite etj., në të cilat normat kulturore nuk ndalojnë martesat e kushërinjve të parë në disa linja, nuk konsiderohen incest marrëdhëniet intime ndërmjet të martuarve të tillë. Duke pasur parasysh këtë kompleks rrethanash e përvojash jetësore, teorikisht incesti mund të përcaktohet *si marrëdhënie seksuale ndërmjet njerëzve me lidhje gjaku shumë të afërta, të cilat ndalohen kategorikisht nga normat kulturore ose ligjore të një shoqërie ose të një “segmenti”* të saj në një periudhë të caktuar të zhvillimit.

5. Jo “gjuhë e huaj”, por “gjuhë amtare” dhe “gjuhë të tjera”

Në gjuhën e folur, në dokumente zyrtare dhe në tekstet e lëndëve shoqërore të shkollave të mesme qarkullon dendur togfjalëshi ose karakterizimi “gjuhë e huaj”. Madje ka emërtime institucionesh

arsimore si “Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja”, “Fakulteti i gjuhëve të huaja” etj. Në kontekste të tilla karakterizimi i *huaj* është i pakuptimtë, së paku për disa arsye thelbësore.

Së *pari*, nëse një student shqiptar përvetëson gjuhën “e huaj”, për shembull anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht etj., a mund të quhet “e huaj” kjo gjuhë e përvetësuar prej tij, madje e përvetësuar si gjuha shqipe ose edhe më mirë se ajo.

Së *dyti*, a ka kuptim emërtimi “Fakulteti i gjuhëve të huaja”, për një student italian, francez, gjerman, sllav, grek dhe anglez që studion një gjuhë joamtare në këtë fakultet të Universitetit të Tiranës. Kësisoj, një pjesë e vetëdijes së tij gjuhësore, domethënë edhe gjuha amtare e tij, konsiderohet e huaj për të.

Së *treti*, sipas hulumtimit joshterues nëpër regjistra përkatës të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XXI kanë studiuar në degën e gjuhës turke 3 studentë turq, nënshetas të Republikës së Turqisë që e kanë turqishten gjuhë amtare dhe rreth 15 minoritarë grekë kanë studiuar në gjuhën e tyre amtare, në greqisht. Studentë të tillë kanë studiuar gjuhë të huaj?

Së *katërti*, gjuhët janë një pasuri e madhe e përbashkët e gjithë popujve të botës, pra asnjë gjuhë nuk është e huaj për askënd. Karakterizimi “i huaj” për gjuhët është i pakuptimtë. Mund të përdoren konceptet “gjuhë amtare” dhe “gjuhë të tjera”. Dhe institucionet arsimore mund të emërtohenin “Shkolla e mesme e gjuhëve”, “Fakulteti i gjuhëve”.

Së *pesti*, si rrjedhojë e rritjes së shkallës së emigrimeve, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, është rritur shkallë-shkallë numri dhe pesha specifike e familjeve të formuara nga martesat e partnerëve me përkatësi kombëtare të ndryshme. Për ta konkretizuar: një fëmijë lind në Itali dhe ka babanë shqiptar dhe nënën italiane. Ai ka gjuhën e amësisë *italishten* dhe gjuhën e

atësisë *shqipen*. Për fëmijë të tillë mund të thuhet se kanë gjuhë amësores, gjuhë atësore dhe gjuhë të tjera që ai mund t’i përvetësojë për gjatë jetës së tij. Asnjë gjuhë që flitet ose shkruhet në planetin Tokë nuk mund të jetë dhe nuk mund të konsiderohet e huaj për të dhe për askënd tjetër.

6. Shqipërime, por me masë të termave të lëndëve shoqërore

Në studimet sociologjike është argumentuar se një nga faktorët kryesorë, me ndikim në rritje për zhvillimin e shoqërive dhe të qytetërimeve ka qenë dhe është difuzimi kulturor, ose procesi i depërtimit të elementeve kulturor nga një sistem kulturor te tjetri ose të tjerët (Macionis, J., 2019:91). Përgjithësisht elementet e reja kulturore ngjizen në hapësirat e një sistemi të caktuar dhe “pagëzohen” me fjalë, me togfjalësh të këtij sistemi kulturor. Kur elementet kulturore difuzojnë nga sistemi i origjinës në sisteme të tjera, bartin me vete edhe etiketimet gjuhësore të tyre.

Fjalët e emërtimit të parë të dukurisë kulturore shoqërore, shkencore, teknike, ekonomike etj., e shoqërojnë atë kur transferohet ose riformësohet edhe në sisteme të tjera socialkulturore. Në proces është krijuar një fond i pasur fjalësh me pasaportë ndërkulturore, që japin ndihmesë të veçantë, për të përcjellë më me saktësi dije të caktuara, avanguardiste për kohën nga një sistem kulturor te tjetri. Për këtë, sociolinguisti Eqrem Çabej ka shkruar: “Ka rasa – kryesisht në punime të specialitetit – kur përdorimi i një fjale a termi të huaj paraqitet i domosdoshëm; aty për hir të saktësisë shkencore, të stilit a për një tjetër arsye, do të përdoret. Si kudo, edhe aty duhet vepruar me masë...” (Revista “Gjuha jonë”, nr. 1, 1981:44). Të gjitha gjuhët, pavarësisht nëse fliten nga popuj numerikisht të mëdhenj ose të vegjël, kanë një fond fjalësh ndërkulturore.

Veçanërisht pas Luftës së Parë Botërore deri në ditët tona shtetet me ndikime më imponuese në politikën botërore janë përpjekur përgjithësisht ta zvogëlojnë fondin e fjalëve të përbotëzuara në gjuhën zyrtare që ata përdorin, por nuk kanë arritur të tejkalojnë një fond të tillë. Në rrethanat e “luftës së ftohtë” ish-Bashkimi Sovjetik në kuadër të përpjekjeve për të ekspozuar përparësitë e rendit socialist, është përpjekur të rusifikonte shumë fjalë–terma me pasaportë ndërkulturore. Megjithëse ky shtet kishte shumë gjuhëtarë me nivel të lartë kualifikimi nuk arriti të “rusifikonte” shumë terma me qarkullim ndërkulturore. Në vitin 1949 në Moskë u botua nga Shtëpia Botuese Shtetërore e Fjalorëve të Huaj dhe Nacionalë “Slovar inostrani slov” (Fjalor i fjalëve të huaja) që qarkullonin në gjuhën ruse. Ky fjalor ka 20.000 fjalë dhe terma (Lljehina, I.; Petrova, F. N., 1949:6). Vetëkuptohet se 70 vitet e fundit, si rrjedhojë e zhvillimeve të vrullshme shkencore, tekniko-teknologjike, ekonomike e sociokulturore etj., e përf forcimit të prirjeve përbotëzuese përgjithësisht është pasuruar fondi i fjalëve me përdorim ndërkulturore në gjuhën ruse dhe në gjuhët e tjera.

Fjalët e gjuhëve të tjera që qarkullojnë në një gjuhë shpesh janë karakterizuar si *barbarizma*. Kjo fjalë vjen nga greqishtja *barbaros*, me kuptimin *i huaj, jogrek* (Leka, F.; Podgorica; E., Hoxha, S., 1972:26-7). Si rrjedhojë e psikozave etnocentrike të skajshme në rrjedhën e disa shekujve grekët përgjithësisht përçmonin si barbarë gjithçka johelene. Kjo ngarkesë emocionale përçmuese ndaj fjalëve të gjuhëve të tjera është përf orcuar edhe ngaqë shumë fjalë i janë imponuar popujve të ndryshëm nga strukturat përkatëse të instaluar prej ushtrive pushtuese, sidomos të 12 perandorive më të mëdha në rrjedhën e historisë që e kanë shtrirë autoritetin e tyre politik, ekonomik e kulturor (e rrjedhimisht gjuhësor) në territore të

gjera nga 6.5 deri 34 milionë kilometra katrorë si Perandoria Romake, Perandoria Ruse, Perandoria Spanjolle e Perandoria Britanike etj. (Brzezinski, Z., 2012:14). Në rrethanat të tilla spastrimi i gjuhëve të popujve të pushtuar prej fjalëve të gjuhëve zyrtare të pushtuesve është konsideruar si një aspekt i rëndësishëm i luftërave çlirimtare të popujve të pushtuar. Rilindësit e mëdhenj të popullit shqiptar spastrimin e shqipes nga turqizimet e panevojshme e vlerësonin si një fushëbetejë të rëndësishme të mëvetësimin të popullit shqiptar prej Perandorisë Osmane, të përparimit të popullit shqiptar në të gjithë fushat e jetës e të veprimtarive. Për këto arsye, ka argumentuar sociolinguisti Eqrem Çabej “njerëzit që kanë vepruar në këto fusha kanë qenë nganjëherë njëkohësisht burra të armës dhe të pendës, luftëtarë dhe dijetarë e shkrimtarë, ashtu si Pashko Vasa... Marko Boçari prej Suli...” (Revista “Gjuha jonë”, nr. 1, 1981:39).

Pas mëvetësimin të Shqipërisë prej Perandorisë Osmane (nëntor 1912) çdo strukturë zyrtare ose jozyrtare që ka trajtuar problemet e gjuhës shqipe në kushtet e luftërave të përbotshme ose në vite më të qeta zhvillimesh paqësore është angazhuar me përparësi në spastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët e panevojshme të gjuhëve të tjera, veçanërisht të atyre të imponuara drejtpërdrejtë dhe sidomos tërthorazi nga strukturat përkatëse të regjimeve pushtuese. Për shembull në shumicën e 494 mbledhje–diskutimeve që ka zhvilluar Komisioni i Terminologjisë në përbërje të Institutit të Studimeve Shqiptare, i cili ka funksionuar në vitet e Luftës së Dytë Botërore (8 prill 1940 – fund nëntori 1944), është trajtuar me përparësi edhe çështja e zëvendësimit të fjalëve të gjuhëve të tjera, veçanërisht të “fjalëve turqishte dhe neolatine” me barasvlerëset e tyre të gjuhës shqipe (AQSH, F. 200, v. 1942, D. 21, f. 4; ky dokument duhej të ishte në dosjet e vitit 1944, por nga pakujdesia e nëpunësve të

arkivit ose për efekte vijimësie të protokollit është vënë në ato të vitit 1942).

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990 regjimi socialist totalitar i kushtoi vëmendje të veçantë spastrimit të gjuhës shqipe nga fjalët e panevojshme të gjuhëve të tjera. Madje, për të bashkërenduar veprimtarinë e strukturave gjuhësore shkencore, të mësuesve, të gazetarëve, të shkrimtarëve etj., me vendimin numër 82, datë 7.4.1979 u krijua pranë Këshillit të Ministrave të RPS të Shqipërisë, një komision i përhershëm me detyrë kryesore: “Të organizojë e të drejtojë punën për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë amtare në të gjitha fushat dhe të kujdeset që të njihen nga masat e gjera e të vihen në jetë përfundimet e kërkimeve dhe të studimeve në këto fusha” (Revista “Gjuha jonë”, nr. 1, 1981:11).

Pas vitit 1990, përfshirja e shoqërisë shqiptare në rrjedhën e zhvillimeve demokratizuese properëndimore u shoqërua me përhapjen me ritme të shpejta të njohurive për zhvillimet bashkëkohore në çdo fushë të jetës e të veprimtarisë, veçanërisht në shkencat shoqërore si sociologjia, qytetaria, psikologjia, historia, filozofia etj. Përhapja e vrullshme e njohurive të tilla u shoqërua me një “*baticë*” termash të gjuhëve të tjera që depërtuan në gjuhën shqipe. Menaxhimi profesional i një “*baticë*” të tillë u vështirësua edhe ngaqë, pas vitit 1990, edhe si pasojë zhvillimeve objektive e subjektive u ndërpre ose u tkurr ndjeshëm veprimtaria e disa strukturave për pastrimin e shqipes nga fjalët e gjuhëve të tjera, që u përhapën pothuajse pa kurrfarë filtrimi në hapësirat e shoqërisë dhe të kulturës shqiptare. Mjaft prej fjalëve të tilla, siç ka argumentuar sociolinguisti Eqrem Çabej, janë si “mish i huaj” në gjuhën shqipe (Revista “Gjuha jonë”, nr. 1, 1981:37). Në gjuhën e folur të shqiptarëve *mish i huaj* quhen edhe *tumoret*. Po ta vazhdojmë ilustrimin e figurshëm, nëse ky mish i huaj rritet përtej caqeve të pranueshme, e kontraktkon me metastaza gjuhën shqipe, vështirëson të kuptuarit prej

shumicës së shqiptarëve të njohurive të reja që përcillen përmes fjalëve të gjuhëve të tjera. Krahas zëvendësimit me maturi të termave të shkencave natyrore, teknike, mjekësore etj., nga gjuhët e tjera me barasvlerëset e tyre në shqipe, sociolinguisti Eqrem Çabej argumentonte në mënyrë vizionare: “Një rëndësi më të madhe merr problematika e pastrimit të degëve të leksikut shoqëror, elementet e të cilit janë në përdorim të një masë më e gjerë e shtresave të shoqërisë” (Po aty: 45). Pas vitit 1990 kjo problematikë nuk është trajtuar sa e si duhet në mënyrë sistematike, të programuar nga strukturat shkencore zyrtare përkatëse, të cilat në vend që të fuqizoheshin me rritjen e numrit të punonjësve shkencorë të kualifikuar në nivele shkencore pasuniversitare në vende të tjera, u tkurren në mënyrë të dhimbshme. Ndërkohë janë përforcuar mendësitë se “gjuha shqipe, si gjuhë e një populli të vogël, ka mundësi të kufizuara për të shqipëruar termat që vijnë nga gjuhë të tjera”, se “sa më shumë masivizohet përdorimi i anglishtes, aq më i panevojshëm bëhet zëvendësimi i termave të saj me fjalë të shqipes”, se “për shqiptarët e mbytur në një det hallesh pastrimi i gjuhës shqipe nga fjalët e gjuhëve të tjera duket një luks krejt i tepërt”, se “për të rejat e të rinjtë, që e shohin të ardhmen e tyre si emigrantë në vendet e tjera, pastrimi i gjuhës shqipe nuk ngjall kurrfarë interesi” etj. Kundërvënia e argumentuar e Eqrem Çabejt ndaj mendësive të tilla joshkencore, kundërshqiptare është aktuale për ditët tona, madje krejt vizionare: “Janë pra të gjitha mundësitë për një zëvendësim të fjalëve të huaja me fjalë vendi dhe kjo pa bjerrje aspak të vlerës kuptimore të fjalëve... Në këtë punë me rëndësi kombëtare do të veprohet me guxim bashkuar me kompetencë shkencore, dhe... me hapa të matur, me maturi në punë” (Po aty: 43, 47). Lipsen nderuar përpyekjet, e strukturave gjuhësore dhe përgjithësisht individuale, me vetënishtë të studiuesve për të zëvendësuar termat shkencorë, veçanërisht në shkencat

shoqërore, në gjuhë të tjera me fjalë të shqipes. Por në jo pak raste zëvendësimet e tilla janë bërë pa profesionalizëm, duke lënë të hapur shtegun për keqkuptime, që cenojnë saktësimet shkencore dhe madje nxisin keqinterpretime vulgare e deri kontradikta logjike.

Është e lavdërueshme përpjekja për të shqipëruar termat edhe në fushë të shkencave shoqërore. Ndhimë të rëndësishme në këtë drejtim kanë dhënë edhe hartuesit e parë të teksteve, rilindësit tanë të mëdhenj si Naum Veqilharxhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri etj. Këtë traditë me frymë të thellë kombëtare e vazhduan hartues të shquar të teksteve pas mëvetësimit të Shqipërisë prej Perandorisë Osmane. Ndër ta shquhen Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, Shaban Demiraj etj.

Edhe në tekste të lëndëve shoqërore të shkruara e që janë në qarkullim në dy dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XXI vihet re prirja për të shqipëruar termat e huazuara nga gjuhë të tjera. Por jo rrallë shqipërimet e tilla nuk kanë qenë profesionale. Fjalët shqipe që kanë zëvendësuar ato të gjuhëve të tjera kanë kuptime të papërcaktuara qartë dhe nuk shprehin thelbin e konceptit shkencor përkatës. Për shembull, në disa tekste termi “divorc” që nënkupton “divorc i bashkëshortëve” zëvendësohet me fjalën “ndarje” që nënkupton “ndarje të bashkëshortëve” (Teksti “Qytetaria”, 2009; në qarkullim deri në vitin 2016, f. 45). Në gjuhën shqipe fjala “ndarje” ka më shumë kuptime se fjala “divorc”. Po e konkretizojmë: Kur një vajzë martohet, ndahet nga familja e prindërve në shumë aspekte, por ajo nuk divorcohet me babanë ose vëllezërit; kur dy vëllezër, pasi martohen, ndahen në familje më vete, por nuk divorcohen nga njëri-tjetri etj. Një zëvendësim i tillë i termit “divorc” me *ndarje* qarkullon edhe në tekste e punime monografike të gjuhëtarëve të shquar të botuar përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XXI. Studiuesi amerikan Paul Bohanan (1920-2007), i specializuar për

problematikën e divorcimit, ka argumentuar se procesi i divorcit ka 6 profile, stacione kryesore: divorci emocional, divorci ligjor, divorci ekonomik, divorci bashkëprindëror, divorci social dhe divorci psikologjik (Shih: Gidens, A., 2007:385-6). Fjala ndarje nuk mund të përcjellë një përmbajtje të tillë.

Në studimet sociologjike flitet edhe për sektorin informal ose ilegal të ekonomisë. Në këtë sektor përfshihen të gjitha veprimtaritë ekonomike që sigurojnë të ardhura të padeklaruara në strukturat zyrtare përkatëse (Macionis, J., 2019:513). Veprimtari të tilla karakterizohen edhe si *punë në të zezë*, pra punë që kryhen jashtë sistemit të taksimeve dhe tatimeve. Në faqen 92 të një teksti “Qytetaria 3”, të botuar për herë të parë në vitin 2002, *puna në të zezë* karakterizohet *punë e zezë*. Një përkthim i tillë është i pasaktë. Natyrisht, një vëllim të madh të *punës në të zezë* e përbëjnë veprimtaritë kriminale, si trafikimi i lëndëve narkotike, i armëve dhe i qenieve njerëzore, rryshfetet që marrin nëpunësit, prostitucioni ilegal etj. Këto mund të quhen *punë të zeza*. Por një vëllim të konsiderueshëm të *punës në të zezë* e përbëjnë edhe veprimtari me profil human mjaft të spikatur si puna e përkujdesit për fëmijët e fqinjëve që bëjnë mjaft adoleshentë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, puna jashtë orarit zyrtar, e pataksuar e inxhinierit ose e mjekut. A mund të quhet e “*zezë*” puna e mjekut jashtë orarit zyrtar që i shpëton jetën një të aksidentuari rëndë, që operon me shkallë të lartë profesionalizmi dhe shpëton jetë njerëzish nga sëmundje shumë të rrezikshme etj. Këto janë punë shumë fisnike, nuk mund të quhen *të zeza*, por thjeshtë *punë në të zezë*, sepse të ardhurat nga një punë e tillë nuk taksohen dhe taten sipas legjisllacionit në fuqi.

Sugjerohet që për zëvendësimin e termave të gjuhëve të tjera me ato të shqipes ose për modifikimin e tyre, është i domosdoshëm bashkëpunimi profesional, sistematik dhe afatgjatë i specialistëve të gjuhës me ato të shkencave shoqërore.

REFERENCAT

- Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar* (AQSH). 1942. Fondi 200, Dosja 21.
- Brzezinski, Zbigniew. 2012. *Vizion strategjik*, Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare.
- Colombo, Paolo. (pa vit botimi). *Vocabolario della lingua italiana* (Nuovissima edizione riveduta e aggiornata con ampia appendice di neologisimi), Bologna: Edizioni CAPITOL.
- Çabej, Eqrem. 1981. Për pastërtinë e gjuhës shqipe, *Revista "Gjuha jonë"*, nr. 1.
- Çajupi, Andon Zako. 2018. *Përmbledhje*, Tiranë: Shtëpia Botuese "ana", Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë. 1980. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë.
- Fjalor i gjuhës shqipe*. 1954. Tiranë: Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë (Instituti i Shkencave).
- Frashëri, Naim. 1995. *Vëpra letrare 1*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
- Giddens, Anthony. 2007. *Sociologjia*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Çabej".
- Goçi, Ibrahim. 1985. *Antonimet e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Buda, Aleks; Pollo, Stefanaq; Frashëri, Kristo; Alibali, Jusuf; Plasari, Ndreçi. 1967. *Historia e Shqipërisë I* (Shqipëria në shek. XVIII-XV). Tiranë: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës.
- Gjeçovi, Shtjefn. 1993. *Kamuni i Lek Dukagjinit*, Tiranë: Botimet "Albinform".
- Hornby, A.S. 1977. *Oxford Advanced Learner's Dictionary of Current English*, Oxford University Press.
- Kokona, Vedat. 2008. *Fjalor frëngjisht-shqip*, Tiranë: Botimet "Kokona".
- Korolkov, Juri. 2007. *Cili jeni ju zoti Sorge?*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Bota shqiptare".
- Kosova, Bardhyl. 2002. *Aleksandër Moisiu, aktori që tronditi skenat e botës*, Tiranë: Botimet "Ombra GVG".
- Lljehina, I. V.; Petrova FN. (redaktorë). 1949. *Sllava inostrani sllav*, Moskva.
- Müller V.K. 1967. *English-Rusian Dictionary, "Soviet Enciklopedia"* Moscow: Publishing House.
- Skvorzova, N.; Maizel, B. 1972. *Dizionario italiano-russo*, Mosca: Casa Editrice "Enciclopedia Sovjetica".
- Shkurtaç, Gjovalin. 2006. *Kultura e gjuhës*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar.
- Thomaj, Jani; Samara, Miço; Shehi, Hajri; Feka, Thomas. 2005. *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Akademia e Shkencave të Shqipërisë).
- Vasili, Kozma; Mustaqi, Arsen (mbledhën dhe përgatitën për botim). 1981. *Lirika Popullore 3*, (Këngë për nizamët dhe kurbetin), Tiranë: Botuar nga Instituti i Kulturës Popullore.

ABSTRACT

Theoretical perspectives and logical-linguistic corrections in the presentation of knowledge of social sciences in the Albanian language

Over the years, the articulation of the Albanian language with logical errors is increasingly noticed, not only in complex scientific concepts in academic environments, but also in simple words and phraseological units that are frequently used in everyday life. Such mistakes and the lack of care for the content and linguistic logic often lead to the creation of confusing situations, with misunderstandings in communication and even conflict. This article is built on the content analysis of the text. Such a study is an attempt to address the main deficiencies in the logical-linguistic presentations of social knowledge in school textbooks, starting with those of secondary schools. In the social sciences, perfection is a notion that is not reached, but that is constantly being aimed at not only by new authors, but also by the most experienced ones. This article aims to re-evaluate the importance of correct use of linguistic logic in the content of social science texts. This is considered as a way to avoid linguistic and intellectual malformations of students.

Key words: *textbook, logical-linguistic correctness, theoretical perspectives, social sciences.*

FETARIA NË KOHË PANDEMIE: KONTEKSTI GLOBAL DHE AI I MAQEDONISË SË VERIUT

Ali PAJAZITI

Universiteti i Europës Juglindore Shkup, Maqedonia e Veriut

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Email: a.pajaziti@seeu.edu.mk

PËRMBLEDHJE

Të dhënat sociologjike flasin se shoqëria moderne është në një krizë të thellë nga e cila profile të ndryshme kërkojnë rrugëdalje. Pandemia me të cilin po përballemi sot, Covid-19 ka krijuar lëkundje të fuqishme në botën fizike dhe mentale të njeriut, e ka nxitur njeriun të kërkojë strehë, të kërkojë anijen e shpëtimit nga drejtimi i gabuar të cilin e ka marrë, nga filozofia materialiste, hedoniste, utilitariste që janë instaluar kokë e këmbë në civilizimin tonë. Dhe në kohëra krizash, religjioni, feja përbën një prej agentëve socialë më të rëndësishëm që i del njeriut në ndihmë. Ai shfaqet si një *profilaksi morale*, si një element shpresëdhënës, rehatifalës. Pra, shënohet një korelacion i drejtë mes rritjes së përmasave të krizës dhe forcimit të religjiozitetit. Në situata të tilla tek besimtarët shfaqet aktivitetit spiritual i ngjeshur, një lidhshmëri më e afërt me tejfiziken, madje shënohen edhe raste më ekstreme kur edhe agnostikë, mosbesimtarë e ndryshojnë perceptimin e vet për “të vërtetën këtu dhe atje”. Në veçanti kur shkenca, madje edhe më e zhvilluara, më e sofistikuar mbetet pa tekst përpara një virusi që na dridh të gjithëve, që na pallkosur e mbyllur planetarisht. Sipas hulumtimit të Gallup të realizuar mes 28 mars dhe 1 prill 2020 është konstatuar se jeta mentale, dietale dhe stërvitore është përqësuar, kurse jeta fetare është avancuar te 19 % të të anketuarve, shifër kjo të cilën Newport (2020) e cilëson si rilindje fetare (religious renaissance). Në këtë kontekst analisti i njëjtë përmend edhe kurbën përpjetëse të personave dhe entiteteve fetare që kryejnë detyra pozitive, integruese, bamirësie... Një hulumtim i paradokohshëm (19-24 mars 2020) i Pew Research lidhur me sjelljet adhurimore tregon se më tepër se gjysma e amerikanëve (55%) janë lutur për përfundim të përhapjes së koronavirusit (86 % luten për çdo ditë, 15 % rralë por tani kanë filluar të luten për shkak të koronavirusit-CBN News, 1 prill 2020); në disa grupe kjo përqindje është shumë më e lartë (8 nga 10 protestantë evangjelistë dhe të zinj dhe rreth 2/3-tat e katolikëve). Një studim tjetër, i Jeanet Sinding Bentzen nga Universiteti i Kopenhagës, shënon se gjatë muajit mars 2020, kërkimet në

internet të fjalës “lutje” (prayer), God, Allah, Muhammad, Easter (Pashkët), Ramadan kanë shënuar kulminacionin e pesë viteve të fundit në 75 shtete, madje edhe na Danimarkë si një vend me fetari të dobët. (Zuckerman, 2020; Evangelical Focus, 3 prill 2020) Ky hulumentim bazohet në metodën historike, analitike, në të dhëna empirike lidhur me këtë çështje shumë të ndjeshme të shekullit XXI, fokusuar në dimensionin lokal dhe global. Gjetjet flasin për fuqizim të fetarisë në kohën e Covid-19: më tepër se 2/3-tat e përgjigjesve janë ndërjet me fetarë në kohën e pandemisë, ndërsa fjalët më të përdorura në intervistë ishin “besim” dhe “Zot”.

Fjalët kyçe: *Covid-19, krizë globale, fe, rigjallërim fetar, Maqedonia e Veriut*

Ali Pajaziti (1972), sociolog, hulumentues, publicist, përkthyes nga Shkupi, profesor i sociologjisë, etikës dhe antropologjisë në UEJL. Ai ka qenë President i Forumit Sociologjik të Ballkanit (2014-2021) dhe aktualisht është Kryetar i Shoqatës Sociologjike Shqiptare (ALBSA). Është, gjithashtu, redaktor i botimeve të humanistikës në Shtëpinë Botuese Logos-A. Prof. Pajaziti është autor i 20 librave, ndër to, *Ese Sociologjike* (2003), *Rinia universitare dhe religjioni* (2003), *In Veritas - Traktat Sociologjik* (2005), *Etika Publike* (2005), *Teknologjitë e informacionit dhe etika* (2008), *Studime Kulturologjike* (2012), *Praktikum sociologjik* (2020), *Lavjerrësi i fillimshekullit* (2022) etj. Ai është autor i fjalorit të parë sociologjik shqiptar (*Fjalor i sociologjisë*, 832 f., 2009). Emri i Pajazitit gjendet në botimet e Routledge, Brill, Taylor & Francis, De Gruyter, Springer, Palgrave Macmillan, IOS Press etj. Librat e tij radhiten në sirtaret e bibliotekave prestigjioze si ajo e Kongresit, e Universitetit Princeton, Yale, atij të Torontos etj.

*Shoqëria e konsumit është një kancer, ne
dubet t'ia rikthejmë asaj shpirtin*
Chaban-Delmas

Hyrje: Gjendja krizologjike

Sentenca e mësipërme është shkëputje nga një libër i veçantë përkthimin shqip të të cilit e redaktuam ditëve traumatike të prillit vitit 2020: Baudrillard, *Konsumerizmi* (*Logos-A*), ku mes tjerash bëhet një analizë brilante e *shoqërisë moderne*, e revolucionit dhe civilizimit të bollëkut, e kulturës konsumeriste, e cila që nga shekulli i tetëmbëdhjetë, përmes filozofisë hedoniste, sensualiste, empiriste, materialiste “ka mundur fort dhe sistematikisht dogmat spiritualiste tradicionale, ka shkaktuar copëtimin historik të kësaj vlere themelore të quajtur shpirt”, përreth të cilës më parë organizohej e gjithë skema individuale e shpëtimit dhe i gjithë procesi i integritimit shoqëror.” (Baudrillard, 2020) Sipas mendimtarit francez në fjalë kursi i shoqërisë permisive dhe të komunikimeve të çastit ka shkaktuar një çekuilibër themelor, *shock* informatik, anomali, depresivitet, me

nja fjalë, ka prishur *metabolizmin social*. Sot, komuniteti i madh shoqëror është i sëmurë, ndërsa qytetarët konsumatorë janë të brishtë, në mënyrë që kudo te profesionistët, nëpër gazeta dhe te moralistët analistë, mbahet ky diskurs “terapeutik” – shprehet Baudrillard. Kjo shoqëri vazhdimisht ushqehet nga dhuna e konsumuar, nga dhuna “indirekte”, nga lajmet pak të rëndësishme, vrasjet, rebelimet, kërcënimi atomik apo *bakteriologjik*. (1970: 278) Një gjë interesante që prek Baudrillard para 50 viteve është çështja bakteriologjike apo virologjike që qe dy vite (2020-2021) na ka goditur fuqishëm si racë humane, që tregon se mendimtari në fjalë ka pasur sens të zhvilluar parashikues për të ardhmen, se ka bërë “profetin social”.

Të dhënat sociologjike flasin se shoqëria moderne është në një krizë të thellë nga e cila profile të ndryshme kërkojnë rrugëdalje. Pandemia me të cilin po përballemi sot, Covid-19 ka krijuar lëkundje të fuqishme në botën fizike dhe mentale të njeriut, e ka nxitur njeriun të kërkojë strehë, të kërkojë anijen e shpëtimit nga drejtimi i gabuar të cilin e ka marrë, nga filozofia materialiste e instaluar kokë

e këmbë në civilizimin tonë. Dokumentari Seaspiracy i Ali Tabrizit (2021) na rikujton se në çfarë shkalle të pëshitur dhe grabitqare kemi arritur përmes “progresi(vizni)t”, se si jemi duke e shkatërruar planetin tonë (Zimeri), na rikujton dëmin që njerëzit ua shkaktojnë llojeve detare, shpalos degradimin alarmues global, shpërfaq çoroditjen etike dhe ligjore të industrisë komerciale të peshkatarisë. (Smith, 2021)

Dhe në kohëra krizash, religjioni, feja përbën një prej agjentëve socialë më të rëndësishëm që i del njeriut në ndihmë. Ai shfaqet si një *profilaksi morale*, si një element shpresëdhënës, rehatifalës. Pra, shënohet një korelacion i drejtë mes rritjes së përmasave të krizës dhe forcimit të religjiozitetit. Kriza e vë në test besimin, por edhe e fuqizon atë. *Homo religiosus* është i vetëdijshëm se qiellorja apo Zoti i vë njerëzit në sprovë në mënyrë të ndryshme, mes tjerash edhe me fatkeqësi natyrore, sëmundje, me kataklizma kolektive, pandemi planetare etj. Në situata të tilla tek besimtarët shfaqet aktivitetit spiritual i ngjeshur, një lidhshmëri më e afërt me tejfiziken, madje shënohen edhe raste më ekstreme kur edhe agnostikë, mosbesimtarë e ndryshojnë perceptimin e vet për “të vërtetën këtu dhe atje”. Në veçanti kur shkenca, madje edhe më e zhvilluara, më e sofistikuara mbetet pa tekst përpara një virusi që na dridh të gjithëve, që na pllakosur e mbyllur të gjithëve.

Faktet empirike na tregojnë se në këtë krizë fetaria kolektive është lëkundur një çik, por ekzistojnë relata (lidhje) individuale me të Madhërishtmen, pra religjioziteti individual, sepse feja nuk realizohet vetëm brenda tempujve, në veçanti në islam që nuk e pranon klerikalizmin dhe formulën *extra ecclesiam nulla sallus*. Në fakt, karantimi ka shkaktuar fenomenin e *fetarisë krahëtlyer*, por ka forcuar një formë tjetër të fetarisë shtëpiake apo familjare. Çdokush mundet që të lutet, të kryejë rituale edhe nga banesa e vet, prej gjithkund sepse Zoti është prezent gjithandej dhe shprehur me

gjuhën e teknologjiive informatike është gjithherë *online*. Sociologjia e religjionit shënon një lloj të ri të adhurimit, të atij virtual (*virtual worship*), të predikimit përmes mediave apo rrjeteve sociale, që përbën një version jokonvensional të përhapjes së përshpirtësisë, në veçanti për brezat më të vjetër, që janë mësuar me *fetarinë fizike*.

Covid 19 dhe fetaria globale

Siç cekëm, sociologjia e religjionit mëson se krizat krijojnë lëkundje, e luhatjet e mëdha i shtyjnë njerëzit të kërkojnë një strehë, në veçanti në sferën e metafizikes, suprahumanes, qiellores. Sipas Meredith McGuire (2007) përvoja e krizës mund t’ia përforcojë besimin që një individ e ka. Edhe këta muaj të historikes ‘Corona’, mes tjerash, kanë prurë edhe një revitalizim të fetarisë (religjiozitetit), ndoshta edhe më të fuqishëm sesa në vitet 1990 kur ra komunizmi, sepse tani nuk ra një ideologji, por një mit i kulminacionit të arritjeve njerëzore, “gjithfuqishmëria e shkencës”, sireligjioni i quajtur *scientizëm* (shkencizëm).

Ja disa tregues të fetarisë së ringjallur globalisht në vitin 2020: lutjet e organizuara për të prekurit nga Covid-19, për doktorët, kërkesa për lutje publike nga prefektët italianë, RSL (Religion and Spiritual Life) Facebook dhe RSL Instagram i studentëve të Shkollës për Teologji të Harvardit që ofrojnë postime insipiruese në kohë pandemie me qëllim të mbajtjes së njerëzve shpirtërisht të zgjuar, Kur’ani i kënduar *open air* nga mjekët turq nëpër spitale, ezanet nga minaretë e qyteteve të Gjermanisë, të Kanadasë, shpallja e 15 marsit nga Trump si Ditë Nacionale e lutjes për të prekurit nga Covid-19, e të tjera.

Pew Research ka gjetur rritje të fetarisë te amerikanët në përgjithësi, që është e krahasueshme me atë të shtatorit të vitit 2001, pas rrënimit të Kullave Binjake. Në rastin e sulmeve të 11 Shtatorit publiku

amerikan u bë më fetar sepse përballej me një gjendje që ia dëftonte mortalitetin dhe esencën fragjile të jetës: Nuk ka ateistë në istikame. (“*There are no atheists in foxholes.*”) Një studim i MIT, Universiteti Baylor dhe Duke tregon se amerikanët fetarë janë përballur më mirë me krizën ekonomike planetare të vitit 2008, së paku në aspekt të mirëqenies. Sipas hulumtimit të Gallup të realizuar mes 28 mars dhe 1 prill 2020 është konstatuar se jeta mentale, dietale dhe stërvitore është përqësuar, kurse jeta fetare është avancuar te 19 % të të anketuarve, shifër kjo të cilën Newport (2020) e cilëson si rilindje fetare (*religious renaissance*). Në këtë kontekst analisti i njëjtë përmend edhe kurbën përpjetëse të personave dhe entiteteve fetare që kryejnë detyra pozitive, integruese, bamirësie... Sipas hulumtimit të realizuar me qytetarët e 14 vendeve ekonomiksht të zhvilluara kanë parë forcim të ndjesisë fetare si te vetja ashtu edhe te të tjerët, pra të fetarisë në kontekstin shoqëror, madje këtë të dytën e konsiderojnë si më të fuqishme (vetëm te rasti i Japonisë shifrat e të parës janë të barabarta me të dytë, 5%-5%). Te amerikanët kjo rritje ka qenë 28%-28%, te spanjollët 16%-17%, te italianët 15%-19%, te kanadezët 13%-16%, te Gjermanët 5%-10% etj.

Një hulumtim i realizuar mes 19-24 mars 2020 lidhur me sjelljet adhurimore tregon se më tepër se gjysma e amerikanëve (55%) janë lutur për përfundim të përhapjes së koronavirusit (86 % luten për çdo ditë, 15 % rrallë por tani kanë filluar të luten për shkak të koronavirusit - *CBN News*, 1 prill 2020); në disa grupe kjo përqindje është shumë më e lartë (8 nga 10 protestantë evangjelistë dhe të zinj dhe rreth 2/3-tat e katolikëve). Një studim tjetër, i Jeanet Sinding Bentzen nga Universiteti i Kopenhagës, shënon se gjatë muajit mars 2020, kërkimet në internet të fjalës “lutje” (prayer), God, Allah, Muhammad, Easter (Pashkët), Ramadan kanë shënuar kulminacionin e pesë viteve të fundit në 75 shtete, madje edhe na

Danimarkë si një vend me fetari të dobët. (Zuckerman, 2020; *Evangelical Focus*, 3 prill 2020) Koronavirusi ka ngjallur edhe një lloj tjetër të fetarisë, atë elektronike ose online, George Mason University organizon seri të webinareve me tema fetare. Hind Makki, një arsimitare ndërfetare me seli në Chicago në Institutin për Politikë Sociale dhe Mirëkuptim, i tha CNN-it se planifikonte të marrë pjesë në disa iftare virtuale, që të paktën do t’i ofronin asaj një mundësi për të bashkëvepruar me të tjerët kur mbaron agjërimin në mbremje. (kumtesa.com)

Marksii në vitet 1800 e quajti fenë opium, Frojdi në ato 1900 e cilësoi atë si një iluzion, por ky institucion shoqëror po shpërfaq një funksion struktural dhe efektiv edhe në vitet 2000, edhe në fillim të mileniumit të tretë. Robert Nicholson në shkrimin e tij të 26 marsit për *Wall Street Journal* është shprehur se “murtaja e përmasave biblike”, “virusi i keq” po i shtyn amerikanët që ta zbulojnë sërish Zotin. Jo vetëm ata por shumë më gjerë, ngase ofron shpresë, ngushëllon përmes porosisë se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi, se mëshira hyjnore është e pakufishme. Besimtari është afër Zotit çdoherë, kurse besimtarët potencialë e rigjejnë atë në çaste të krizave, të tronditjeve jetike. Sipas Kissell (2020) moraliteti, mortaliteti dhe metafizika janë pjesë e çdo storjeje për pandeminë Covid-19 si “rrefimi më i madh fetar i kohës sonë” kur njerëzit sërish kërkojnë të vërtetën dhe kuptimin.

Pandemia dhe feja në Maqedoninë e Veriut

Bota vazhdon të notojë në një drejtim të panjohur edhe në vitin 2021, burim ky i një lloji të ri të pasigurisë dhe frikës. Bashkë me të edhe Maqedonia e Veriut, ku jemi mësuar të jetojmë me të gjitha llojet e lëkundjeve të tranzicionit, nga ato sociale, ekonomike deri te ato politike, tani edhe shëndetësore. Edhe tek ne siç e shprehet një autor vendas

“Përbindëshi me qafë të gjatë”, Covid-19 vazhdon të bëjë kërdinë. Ai i përngjan “Lok Nes”-it, që ka një gungë të madhe që bie poshtë në tokë dhe një qafë të madhe që ngrihet në qiell. Dallimi është se përbindëshi Lok Nes është një krijesë mitologjike nga përrallat popullore në viset malore skoceze, kurse ky yni nga grafikët është i vërtetë, agresiv dhe vdekjeprurës. (Вангели, 2020)

Instancat përgjegjëse janë munduar që përmes ekspertizës, mobilizimit dhe mjeteve në dispozicion të ulin pasojat e pandemisë. Sipas Komisionit të BE-së autoritetet e RMV-së në fillim të shpërthimit të COVID-19 në mars 2020, janë ballafaquar mirë pandeminë, me numër të mjaftueshëm të testeve, me masa kufizuese si ora policore, karantina, distanca shoqërore, ndalimi i tubimeve publike, i ceremonive fetare, ngjarjeve sportive, kulturore, me kalimin në mësinin online, me mbylljen e restoranteve dhe kafeneve në mënyrë graduale nga fillimi i majit 2020 e këndeje. Në verë, shteti luftoi me një valë të dytë të infeksioneve, që shtroi nevojën për zgjerim të kapacitetet e sistemit shëndetësor. (EC, 2020)

Sikur në shumë vende të tjera edhe tek ne ka një korelacion mes virusit dhe fetarisë. Nga hulumtimet ndërkombëtare dhe vendore konstatohet se popullata e Maqedonisë së Veriut është një nga më religjiozet në botë. Në studimin që ne kemi realizuar në vitin 1997, 78 % e studentëve janë shprehur se besonin te Zoti krijues i gjithësisë (te studentët shqiptarë kjo %

doli 98.4, kurse tek ata maqedonas 58.9). (Pajaziti, 2003: 95, 98) Një studim i vitit 2009 i realizuar me 480 studentë (95 % maqedonas ortodoksë) të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” është konstatuar se 81,3 % të të anketuarve janë përgjigjur se besojnë në Zot (39.5% fetarë konform fesë të cilës i përkasin; 10.2% jofetarë, 2.3% kundërshtarë të fesë). (Ацески, 2009: 70) Të kësaj vije janë edhe të dhënat nga studimi i Amel Kurtishit, realizuar më 2010 me 333 të rinj nga qyteti i Shkupit, sipas të cilit për 93 % të myslimanëve dhe 74.9 % të të krishterëve “praktimi i fesë është një gjë shumë e rëndësishme” (për 85.3 %-shin “Zoti është krijues i gjithçkaje që ekziston”). (Куртиши, 2020: 97-98) Punimi i masterit i Mixhit Osmanit, mbrojtur në universitetin e Bursës, nga viti 2014, që ngërthen një hulumtim empirik, anketë me 940 nxënës e studentë të qytetit të Tetovës, sjell gjetje më te reja, fetari edhe më të theksuar: 98.6 % janë shprehur se besojnë në njëshmërinë e Zotit. (Osmani, 2014: 89).

Hulumtimi i Brima Gallup i fundvitit 2016 i realizuar në 68 shtete me 66.541 person tregon se Maqedonia është vendi i dytë për nga religjioziteti në Europë: 84 % e qytetarëve janë religjiozë (10 % afetarë dhe vetëm 1 % ateistë; 88 % besonin në Zot). Sipas një hulumtimi të realizuar vitin e kaluar nga IPIS, Religjia.mk dhe Konrad Adenauer Stiftung me 1110 respondentë, 86 % të qytetarëve janë shprehur se janë fetarë ose deri diku fetarë (% e njerëzve

Ilustrimi 1: Fetaria në RMV në periudhën dhjetor 2019-korrik 2020. (Божиновски-Николовски, 2020a: 9, 24)

		dhjetor 2019	prill 2020	korrik 2020
<i>A e konsideroni veten fetar?</i>	Po	50.9%	51.1%	54.5%
	Deri diku po.	33.4%	32.7%	30.7%
	Deri diku jo.	6.0%	7.3%	8.0%
	Jo.	5.3%	6.1%	6.0%
	S'e di. Pa përgjigje.	4.5%	2.8%	.7%

pa ndjeshi fetare të krishterët 16 %, kurse të myslimanët 4 %). (Божиновски-Николовски, 2020a:9)

Gjendja e krizës tmerruese shëndetësore sikurse të tjerat (p.sh në arsim ka shkaktuar dëmtime marramendëse, ka ndikuar të 94 % të nxënësve-studentëve, 1.6 miliardë fëmijë; “has led to learning losses” [Li & Lalani, 2021]) ka prekur edhe sferën e fesë dhe të fetarisë. “Covid-19 që është reflektuar të besimtarët si edhe funksionimin aktual të organizatave fetare në Maqedoninë e Veriut. (Божиновски & Николовски/б, 2020: 5)


Një webfaqe për të ilustruar situatën ka shfaqur imazhin e një besimtari orthodox që në kohë të koronavirusit ndez qirinjtë për lutje gjatë shërbimit të mëngjesit në Kishën Shën Klementi, tempullin kryesor orthodox krishter në qytetin e Shkupit. (directrelief.org) Në rrjetet sociale më 20 mars të vitit të kaluar, e premtë, një besimtar nga Maqedonia pati postuar edhe këtë: “Of. S’paska pasë pervojë më të hidhur për besimtarin se ezani i xhumasë në të thatë.” Një kolumnë e datës 30 të muajit të njëjtë

do të shënojë edhe këtë:

“20 mars. E premtë, tradicionalisht, konservatorisht, fetarisht, myslimançe: e xhuma. Dita e tubimit, e takimit, e kuvendimit javor, në tempull, në xhami. Dita më e mbarë e javës. E kulturizimit religjioz, e socializimit, e mbushjes së baterive nga priza hyjnore. Shkollë javore, stërvitje shpirtërore. Çaste të kontaktit me metafiziken, me qielloren duke qenë përtoke, në këtë botë. Momente të kalimit në një botë tjetër, të ngjites drejt vertikales së pafundme. Rutinë e *homo religiosus*-it për çdo javë. Destinacioni i mesditës premtore. Në kushte jashtëpandemike, të gjitha rrugët shpien në faltore. Kjo është pamja gjenerale, që e sheh besimtari, pa përjashtuar edhe qëndrimin e pjesës tjetër të popullatës, për të cilët e premtja është ditë si të tjerat, përgatitje për fundjavë, për uikend. Por “virusi enigmatik” neve besimtarëve myslimanë na e ndryshoi edhe jetën fetare. Zbrazti rreth-Qabënë, Medinen, shkretoi faltoret në të katër anët e botës. Sot ezani i xhumasë më dridhi të tërin, më rrëqethi.” (Pajaziti, 2020)

Ilustrimi 2. Fetaria gjatë Covid-19 (ИПИС, 2020b: 28)

Si do të ndikojë Covid-19 në besimin fetar të njerëzve?



■ Do të forcohet ■ Do të dobësohet. ■ S'do të ketë ndryshime ■ Nuk e di./Pa përgjigje.

Ilustrimi 3. *Besimtarët e RMV-së në kohë të Covid-19 (Burimi: Anadolu Agency, Foreign Policy)*

Një sondazh i realizuar vitin e kaluar me qytetarë të RMV-së lidhur me ndikimin e Covid-19 në ndjesinë fetare të njerëzve tregon se 40.7% prej tyre janë të mendimit se feja do të fuqizohet në këtë kohë krize. (shih ilustrimin 3).

Nga i njëjti hulumtim është konstatuar se besimtarët shqiptarë janë shprehur më optimistë lidhur me ardhmërinë e fesë në kohë pandemie. 57 % e shqiptarëve dhe 35.6% e maqedonasve janë shprehur se besimi fetar do të forcohet.

Përderisa besimtarët janë në huti se si duhet të organizojnë jetën e tyre fetare, bashkësitë fetare janë treguar herë-herë të pandjeshme dhe rigjide lidhur me këtë rrezik global. Qasja e bashkësive fetare (KOM dhe BFI) është vlerësuar nga opinioni si joserioze dhe e papërgjegjshme ndaj ndjenjave fetare të qytetarëve besimtarë. Thirrja për respektim të festave dhe ritualeve fetare nga autoritetet fetare pa respektuar distancën e domosdoshme është treguar e dëmshme për shëndetin e qytetarëve (Петковска, 2020: 150)

Mitropoliti Timotej, zëdhënës i KOM, i pyetur nga mediat nëse priftërinjtë do të përdorin lugën e njëjtë për t'i kunguar njerëzit që përgjigjur me “po, pa dyshim”, duke shtuar se njerëzit që kanë drojë të mos vijnë, se nuk do të ndryshojnë një traditë shekullore. (Bosilkoski, 2020) Nga

ana tjetër, ish Reisi i BFI-së vuri veten “në rolin e mjekut, shpalli virusin korona të vdekur”. “... dhe të dini se Covid-19 mundet lirisht ta shpallin të vdekur prej sot duke pasur parasysh se e kemi fituar dhe për këtë jemi këtu” – ishte shprehur ai. (Fokus, 24.05.2020) Pohimi i tij se virusi ka vdekur është e një laiku të fushës, e një personi jokompetenet meqë nuk është pjesë e kuadrove mjekësore.

Dhe gjendja e pandemisë ende nuk ka përfunduar. Në vjeshtë përjetuam pikun e dytë të krizës së Covid 19. Të gjitha masat e përkohshme të ndërmarra në dhjetor 2020 mbetën në fuqi deri në vendimin tjetër: të gjitha lokalet duhej të punonin me 30 % të kapacitetit, u ndaluan tubimet e festave dhe ato fetare në objekte të mbyllura (mk.usembassy.gov) Më pas, në muajt mars dhe prill 2021 e përjetuam valën e tretë të pandemisë gjithashtu me masa restriktive zyrtare.

Ndërkohë feja gjithnjë e më tepër po kalon në sferën virtuale. Besimtarët myslimanë organizojnë ligjërata fetare nga distanca, ditore dhe të së premtes, madje është bërë temë debati i çështjes imamit nga distanca apo i atij nga youtube. Sot përzgjedhja e përmbajtjes fetare mund të bëhet aty për aty, ligjërata mund të dëgjohet në çast, prijësi mund të kontaktohet përmes FB, Insta, Viber, Whatsapp, mund t'i shtrohen

pyetje, të bëhen komente, mund të kërkohen sqarime, të dëgjohet transmetimi autentik, të merret “përgjigjja e besueshme”. (Pajaziti, 2020) Ndërkohë ka pasur edhe webinarë lidhur me praktikimin e fesë në kohë të pandemisë, siç ishte rasti me KAS dhe shefin e kabintetit të Kryepeshkopit të KOM (8 maj 2020), online panele, si ai i BFI-së me kryetarët e bashkësive islame të diasporës shqiptare (të Zvicrës, Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Suedisë, Danimarkës dhe Belgjikës) mbajtur më 28 prill të këtij viti e të tjera evente të kësaj natyre, ligjërata përmes Zoom-it në Ramazan, përmes kanaleve televizive (si Myftinia.tv, Tv Koha - Tetovë) ku myftinitë plasojnë porosinë fetare deri te besimtarët. Në këtë drejtim aktive kanë qenë edhe OJQ-të, teologë individualë etj.

Dhe për fund të japim ca të dhëna nga hulumtimi më i ri i realizuar në mars 2021, intervistë e realizuar me 32 shkollarë shqiptarë të Maqedonisë së Veriut. Më shumë se 2/3-at e tyre kanë pohuar se koronavirusi ka ndikuar në besimin e tyre fetar, i kë bërë më religjiozë. Ja disa sekuenca nga rrëfimi i tyre: Ligjëruesi universitar (38 vjeç) është shprehur se “*besimi ka qenë një bazë e fortë për të kaluar çastet e vështira të karantinës. Sot ka bindje edhe më të thellë te Zoti, shpresojmë te ndihma e Tij*” (#2, historian). Një muzicant është përgjigjur si vijon “*Jam më fetar në këtë fazë për shkak të humbjes së personave të afërt por edhe nga humbja e qetësisë të brendshme. Feja të sjell qetësi, optimizëm dhe mundësi për meditim dhe vetëreflektim që është shumë e nevojshme më këtë periudhë për të gjitha familjet*” (#3, 43 vjeç). “*Sigurisht që është përforcuar besimi te i Madhi Zot, shkenca na doli e pabesë*” (#4, profesor i

punës dhe politikave sociale, 66 vjeç). Një mikrobiolog, 24 vjeçar pohon se “*Covid19 nuk nënkupton diçka përtej madhështisë së Zotit, mahnisshmëria ndaj të cilit shfaqet thujtë në çdo mikro dhe makro situatë të Universit.*” (#6)

Përfundime

Feja gjithnjë ka luajtur një rol të balsamit të shpirtit dhe pjesëmarrja fetare e rregullt shoqërohet me rezultate më të mira të shëndetit emocional. Por në periudhën para Covid-19 “njeriu i trupit dhe emocioneve ka dominuar ndaj njeriut të shpirtit a man of body and (*man of spirit*).” (Kowalczyk et. al., 2020) Maqedonia e Veriut njihet si një hapësirë konservatore dhe religjioze, fakt ky që vërehet nga hulumtimet e ndryshme të realizuara gjatë periudhës 1990-2020. Gjatë kohës së njëvjeçare të ndalimit apo pauzës fetare (Штрак, 2020), të survivalizmit (luftës për mbijetesë), kur Covid-19 po trondit shoqërinë tonë dhe globin, fryma dhe kultura fetare, mënyra e jetësimit të fesë kanë ndryshuar goxha, po përjetohet një “ringjallje fetare” (*religious renewal*): edhe kategoria e jobesimtarëve dhe besimtarëve pasivë kanë filluar që shprehin një spiritualitet të fshehtë apo manifest. Nga intervistat e realizuara me pjesëtarë të shkollarisë shqiptare të RMV-së kemi konstatuar se gjatë periudhës njëvjeçare të inteligjencës shqiptare e RMV-së është evidente kurba e rritjes, apo fuqizimit të ndjenjave fetare, se fetaria individuale është më e theksuar në kohë të pandemisë, se brezi më ri (20-49 vjeç) i inteligjencës është më fetar se ai më i vjetri (50+).

REFERENCAT

- АЦЕСКИ, И. (2009). “Некои карактеристики на религиозност кај студентската популација”, <http://periodica.fzf.ukim.edu.mk/9> prill 2021.
- BAUDRILLARD, J. (2020). *Konsumerizmi*.

Shkup: Logos-A.

- БOSILKOSKI, I. (2020). “North Macedonia’s Orthodox Church Could Become a Coronavirus Super-Spreader”, *Foreign Policy*, 22 prill.

- БОЖИНОВСКИ, В. – НИКОЛОВСКИ, М. (2020а). *Употреба на религија во политички кампањи*. Скопје: ИПИС, Религија.мк, КАС.
- БОЖИНОВСКИ, В. – НИКОЛОВСКИ, М. (2020б). *Практикување на религија во услови на пандемија*. Скопје: ИПИС, Религија.мк, КАС.
- KOWALCZYK, O. et. al. (2020). “Religion and Faith Perception in a Pandemic of COVID-19”, *Journal of Religion and Health*, Völl. 59, f. 2671–2677.
- КУРТИШИ, А. (2020). *Општествените фактори и религиозноста на младите*. Скопје: Belig.
- LI, C. & LALANI, F. (2021). “How COVID-19 has changed the way we educate children”, World Economic Forum, 25 shkurt 2021.
- McGUIRE, M. (2007). *Religjioni: Konteksti social*. Скопје: Logos-A.
- NEWPORT, F. (2020). “Religion and the COVID-19 Virus in the U.S.”, <https://news.gallup.com/opinion/polling-matters/307619/religion-covid-virus.aspx>, 20 maj 2020.
- NICHOLSON, R. (2020). “A Coronavirus Great Awakening”, *Wall Street Journal*, March 26.
- OSMANI, M. (2014). *Makedonya'da Yaşayan Gençlerde Dini Şüphelerin Kaynakları ve Etkileri (Kalkandelen Örneği)*. Bursa: Uludağ Üniversitesi.
- PAJAZITI, A. (2020а). “Ditar n'kohë pandemie”, Portalb.mk, 30 mars.
- PAJAZITI, A. (2020b). “E-religjioni”, Portalb.mk, 23 nëntor.
- PAJAZITI, A. (2003). *Rinia universitare dhe religjioni*. Скопје: Logos-A.
- SMITH, E. (2021). “Review: Seaspiracy 2021 By Ali Tabrizi”, <https://brightshub.com/review-seaspiracy-2021-by-ali-tabrizi/9> prill.
- ШТРАК, К. (2020). “Религија во доба на коронавирус”, <https://www.dw.com/mkreliigijata-vo-doba-na-koronaivirus/a-53070889>, 9 prill.
- ПЕТКОВСКА, А. (2020). “Ковид-19 – цивилизациски континуитет на недоследности”, *Предизвици*, 06/2020.
- VANGELI, A. (2020). “Maqedonia dhe KOVID-19: Përbindëshi me qafën e gjatë”, *Res Publica*, 24 qershor.
- ZUCKERMAN, Ph. (2020). “Will COVID-19 Make People More Religious?”, *Psychology Today*, 15 prill.

ABSTRACT

Sociological data show that modern society is in a deep crisis from which different profiles seek a way out. The pandemic we are facing today, Covid-19 has created powerful oscillations in the physical and mental world of man. In times of crisis, religion is one of the most important social agents that comes to the aid of man. It manifests itself as a moral prophylaxis, as a hopeful, comforting element. Thus, there is a fair correlation between the increase in the size of the crisis and the strengthening of spirituality or religiosity. In situations of crises, believers experience intense spiritual activity, a closer connection with the supernatural, and even more extreme cases are recorded when even agnostics, non-believers change their perception of “truth here and there.” Especially when science, even the most advanced, the most sophisticated, is left without a text in front of a virus that shakes us all, that has plagued us and closed us planetarily. According to Gallup research conducted between March 28 and April 1, 2020, it was found that mental, dietary and exercise life has deteriorated, while religious life has advanced to 19% of respondents, a figure which Newport (2020) describes as a religious renaissance. In this context, the same analyst also mentions the ascending curve of religious persons and entities that perform positive, integrative, charitable tasks. Prof. Bentzen states that interest in informatin about prayer in Google increased sharply (in 95 countries) during March 2020 when Covid 19 became a global phenomenon. (Catholic

Herald, 2020). This paper is based on historical, analytical methods, on empirical data on this very sensitive issue of 21st century, focused on global and local dimensions. Findings from our field research show an increasing religiosity in Covid-19 times: more than 2/3 of respondents feel themselves more religious in the period of Covid-19 and the most frequent words in the interviews were 'belief' and 'God'.

Keywords: *Covid 19, global crisis, religion, spiritual renewal, North Macedonia*

SAMI FRASHËRI PËR QYTETËRIMIN, RACAT DHE KOMBET

Enis SULSTAROVA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Shkencave Politike
E-mail: enis.sulstarova@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Sami Frashëri i takon plejadës së intelektualëve reformatorë që jetuan në dekadat e fundit të Perandorisë Osmane. Samiu ishte një njohës i mirë i antropologjisë perëndimore të kohës dhe lidhjes së saj me teoritë e familjeve gjuhësore dhe të racave. Artikulli është një përpjekje për të hedhur dritë mbi përdorimin e termit “qytetërim” në tekstet e tij që janë shkruar apo përkthyer në gjuhën shqipe. Ne argumentojmë se kuptimi që Sami ka për qytetërimin është pak a shumë konsistent në tekste të ndryshme, dhe se përmes tij ai kërkon të paraqesë formimin e kulturave, racave dhe kombeve përmes evoluimit të specieve njerëzore. Gjithashtu, termi “qytetërim” është kyç për shpjegimin që ai mundohet t’i japë problemit të prejardhjes së kombit shqiptar dhe daljes së tij nga prapambetja materiale dhe kulturore, në raport me kombet e zhvilluar në Evropë në fund të shek. XIX.

Fjalë kyçe: (4-5) *qytetërim, komb, racë, arian, shqiptar.*

Prof. Asoc. Dr. Enis Sulstarova është lektor me kohë të plotë pranë Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit të Tiranës. Fushat e tij të interesit janë nacionalizmi, politikat e identitetit, sociologjia politike, politika dhe kultura në Ballkan, qytetaria. Ai është autor i disa librave dhe i shumë artikujve të botuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Hyrje

Aty nga fundi i manifestit *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*, Sami Frashëri u lëshonte këtë thirrje bashkëkombasve: “O vëllezër Shqipëtarë! Të mos na gjenjë [ndodhë] si ata t’egërtit e Avstralis’ e të

Afrikësë, që ven’ Evropjanët’ e i gënjejnë me ca ruaza e me ca dragole [vogëlsira] të qeltërta e pasqyra të pafilla [prej teneqeje] e u marrinë vendet’ e tyre nga dora” (1999: 112). Kjo ishte një thirrje për shqiptarët që të merrnin rrugën e qytetërimit modern dhe të mobilizoheshin për krijimin të

shtetit të tyre kombëtar, ashtu si Samiu i udhëzonte në pjesën e tretë të manifestit. Prej thirrjes së Samiun nënkuptohet se shqiptarët ndodheshin gjeografikisht në Evropë, por ishin shumë larg vendeve të zhvilluara evropiane për sa i përket shkallës së qytetërimit. Shqiptarët do të mund të ngjiteshin më lart për një kohë të shkurtër nëse do të fitonin pavarësinë politike dhe do të ngrinin institucione shkencore dhe kulturore që do t'i shërbenin kombit. Alternativa do të ishte zhdukja e tyre, ose nënshtimi ndaj kombeve fqinje më të fuqishme e më të përparuara, ashtu siç kishte ndodhur me shumë popuj gjatë kolonizimit. Duhet kujtuar se çereku i fundit i shek. XIX ishte periudha e garës imperialiste të shteteve perëndimore, për justifikimin e së cilës shërbenin teoritë raciste që dominonin në antropologji, shkenca natyrore e ato shoqërore.

Në këtë artikull shqyrtojmë përdorimin e “qytetërimit” në veprat e Sami Frashërit që janë shkruar në shqip dhe në ato që janë shkruar në osmanisht/turqisht e që janë përkthyer në shqip. Me gjithë njohjen e pjesshme të veprës së Samiut – p.sh. enciklopedia *Kamus al A'lam (Enciklopedia universale)* nuk është përkthyer e plotë në shqip – mund të themi se përkufizimi prej këtij autori të fjalës “qytetërim” në vepra të ndryshme është koherent me shtjellimet e tij antropologjike, historike dhe sociologjike mbi njerëzimin, përparimin e tij material, si dhe mbi formimin e kulturave, racave dhe kombeve. Siç e vumë re në citatin nga manifesti i tij politik, koncepti i qytetërimit është justifikimi epistemologjik për përfshirjen e shqiptarëve në rrjedhat e botës moderne dhe organizimin e jetesës së tyre publike rreth konceptit të kombit. Përderisa “qytetërimin” Samiu e ka huazuar nga ligjërimet e kohës së tij në Evropë dhe më gjerë, në pjesën e parë të artikullit tentojmë një përmbledhje të evoluimit dhe bashkëshoqërimit të “qytetërimit” me teoritë e racave në gjysmën e dytë të shek. XIX. Në

pjesën e dytë të artikullit përqendrohemi te ato pjesë të veprave të Samiut ku ndeshim fjalën “qytetërim” dhe përpiqemi të rindërtojmë skemën e tij mendore, ku janë të lidhura lindja e qytetërimit, evoluimi i qytetërimit, përhapja e qytetërimit në botë përmes migrimit të popujve, me klasifikimin antropologjik të shqiptarëve dhe të paraardhësve të tyre. Artikulli mbyllet me përfundimet e hulumtimit.

Qytetërimet, racat dhe kombet në shek. XIX

Termi “qytetërim” u shpik në Britaninë e Madhe dhe në Francë gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII. Sipas përdorimeve të tij të para, “qytetërimi” përshkruante si procesin e të qenit i qytetëruar, po ashtu edhe rezultatit e tij. E kundërta e qytetërimit ishte barbaria, një term ky shumë më i vjetër, i përdorur në lashtësi nga grekët dhe romakët për popujt që nuk flisnin gjuhët e tyre dhe që, për pasojë, shiheshin si të mangët në zhvillimin material e kulturor. Kësisoj, në sajë të kundërshtisë kuptimore me barbarinë apo barbarizmin, qysh në fillim supozimi pas përdorimit të fjalës “qytetërim” ishte se ai në radhë të parë i përkiste popujve të Evropës (Perëndimore), ndërsa në skaj dhe jashtë kontinentit ndodheshin qytetërimet e degraduara orientale, barbaria, egërsia apo gjendja e natyrës. Qytetërimi si term u përdor si në mënyrën përshkruese, ashtu edhe në atë normative. Në cilësinë përshkruese, ai shënjonte produktet materiale e etnografike dhe vlerat që kanë të përbashkëta një grup i caktuar njerëzish, si p.sh. kur flasim e shkruajmë për “qytetërimet e lashta”. Përkufizimi përshkrues është i ngjashëm me atë të “kulturës”, duke përshtjelluar në këtë mënyrë dallimet midis këtyre dy termave, por ai të paktën lejon ekzistencën e disa qytetërimeve të njëkohshëm dhe deri diku të barazvlefshëm në sytë e vëzhguesit. Ndërsa përkufizimi normativ ka të bëjë me atë se cili grupim i njerëzve është më i

qytetëruar se tjetri. Zakonisht, përdorimet normative dhe etnografike të qytetërimit janë shoqëruar me njëri-tjetrin, sepse shqiptuesi perëndimor i termit ka qenë ai që ka vendosur standardin krahasues, për të përcaktuar më pas hierarkinë e qytetërimeve të tjera në botë (Bowden, 2009).

Në kërkimin për gjenezën e qytetërimit, u shpik miti i racës ariane. Zanafilla e mitit është zbulimi i Uilliam Xhonsit [William Jones] në vitin 1786 se greqishtja, latinishtja, sanskritishtja dhe persishtja ishin zhvilluar nga një rrënjë e njëjtë, ndërsa termi “arian”, që mendohet se ishin folësit imagjinarë të kësaj gjuhe parake, ishte përdorur nga orientalisti francez Abraham Ankëtil-Dyperon [Abraham-Hyacinthe Anquetil-Duperron] në vitin 1763. Ai e kishte hasur termin *aryen* të *Avesta* – një koleksion tekstesh të zoroastrianizmit – për të cilin mendonte se ishte një variant i fjalës *arioi* që Herodoti e përdorte për popujt e lashtë të Persisë. Në fillim të shek. XIX Fridrih Shlegeli [Friedrih Schlegel] sugjeroi se fjala *arian* ishte e lidhur me fjalën gjermane *Ehre*, që do të thotë nder. Lidhja gjuhësore midis arianëve dhe qytetërimit perëndimor u përcaktua në një masë të madhe nga studimet mbi sanskrishten të gjuhëtarit gjerman Maks Myler [Max Müller] në mesin e shek. XIX. Ai mendonte se farefisnia gjuhësore do të thoshte edhe farefisni kulturore dhe, për rrjedhojë, sistemet e lashta fetare të Indisë janë përcjellë të paganizmi i antikitetit në Evropë. Epërsia kulturore e arianëve në raport me popullatat e jugut të Indisë, do të shënonte epërsinë historike të indoevropianëve në përgjithësi mbi popujt që i përkisnin familjeve të tjera gjuhësore:

Kombet ariane që ndoqën një drejtim veri-perëndimor qëndrojnë para nesh në histori si kombet e parë të Azisë veri-perëndimore dhe Evropës. Ata kanë qenë aktorë të shquar në dramën e madhe të historisë dhe kanë mbartur në zhvillimin më të plotë të gjithë

elementet e jetës aktive me të cilët është begatuar natyra jonë. Ata kanë përsosur shoqërinë dhe moralin dhe ne mësojmë prej letërsisë, veprave të artit, elementeve të shkencës, dhe parimeve të filozofisë së tyre. Në konflikt të vazhdueshëm me njëri-tjetrin dhe me racat semitike e turaniane, këta kombe ariane janë bërë sundimtarë të historisë dhe duket se misioni i tyre është bashkimi i të gjithë pjesëve të botës me anë të zinxhirëve të qytetërimit, tregtisë dhe fesë... (cit. tek Arvidsson, 2006: 47-48).

Krahas gjuhëtarëve, argumente për rrënjët e qytetërimit indoevropian apo arian nisën të ofronin edhe anatomistët dhe, më vonë, antropologët. Përpara zbulimit të gjeneve njerëzore si bartës të tipareve racore, hulumtimet ndodhnin në “sipërfaqe” të tipave njerëzore: përmes matjes së kafkës, formës së fytyrës, ngjyrës së lëkurës, formës dhe ngjyrës së syve, ngjyrës dhe thurjes së flokëve, përmasave të trupit etj. Gjithsesi raca nuk ishte asnjëherë një ndërtim krejtësisht biologjik. Elementë të tjerë hynin në ekuacionin e racës, si prejardhja gjeografike dhe etnike, aftësia njohëse, karakteri, edhe pse në shek. XIX këto të fundit filluan të shiheshin si shprehje të thelbit biologjik, pra ishin në “gjakun” e racave. Përfytyrimi i kombeve sipas prejardhjes së përbashkët, gjuhës dhe kulturës së njëjtë, përkonte gjithnjë e më shumë me përfytyrimet racore. Koncepti romantik mbi shpirtin dhe karakterin e secilit komb ndërthurej me theksin të prejardhja e njëjtë apo përkatësia e gjakut. Kështu, gjatë gjysmës së e dytë të shek. XIX fitorja e betejës midis gjuhëtarëve dhe antropologëve racorë po anonte nga këta të dytë. Gjithnjë e më shumë termi indoevropian nuk po përdorej për të treguar një familje gjuhësore, por një racë. Nëse Mylerin vijoi të mbronte idenë se gjuha, kultura dhe feja përbënin një popull apo një “racë”, pavarësisht tipareve fizike të anëtarëve të tij, antropologjia e kohës ishte e mendimit se pamja fizike dhe niveli i

inteligjencës (përmes matjeve të kafkës) duhej të ishin kriteret për klasifikimin e njerëzimit. Aty nga fundi i shek. XIX me ngadhënjimin e “shkencës” së racës, teoria racore zbatohet gjerësisht për kombet, të cilët konceptoheshin si raca të veçanta, nën-kategori të racave, apo përzierje të veçanta të racave, si p.sh. raca anglo-saksone, raca gjermane, raca çifute etj. (McCarthy, 2009: 5-8).

Deri aty nga gjysma e shek. XIX mendimi shkencor dominohej nga teoria e monogjenezës, sipas së cilës racat njerëzore janë evoluime të së njëjtës specie njerëzore, diçka që mbështetet edhe nga fetë monoteiste. Në vitet 1830-1840, Xhorxh Morton [George Morton] paraqiti në disa vepra teorinë poligjenetike të racave, sipas së cilës raca të ndara janë formuar pavarësisht njëra-tjetrës në pjesë të ndryshme të botës dhe përmbajnë karakteristika të dallueshme nga njëra-tjetra (po aty: 73). Dominimi i kësaj teorie deri në fund të shekullit do të thoshte që përzierja racore barazohej me degjenerimin racor dhe me rënien e qytetërimit. Një nga emrat e njohur të racizmit shkencor në fund të shek. XIX ishte Artur de Gobino [Arthur de Gobineau], i cili shkruante se të gjitha qytetërimet e lashta ishin themeluar prej arianëve dhe se vetëm ato shoqëri përparojnë ku ka një prani të racës së bardhë në përbërjen gjenetike të popullatave të tyre. Arianët e përzënë gjakun me raca të tjera, prandaj ishte iluzion kërkimi për raca të pastra. Dallimi në qytetërim midis racave e kombeve duhej kërkuar te shkalla e përzierjes së tyre. Për shembull, të bardhët për të pasur më shumë imagjinatë kanë nevojë për infuzion të gjakut të të zinjve, por marrja me tepri e elementit të zi do t'i bënte të bardhët të humbisnin inteligjencën. Gobinoja e lidhte përhapjen e qytetërimit të lartë me praninë e racës gjermanike, si trashëgimtare më e lartë e arianëve: “Në vende ku elementi gjermanik nuk ka depërtuar kurrë, nuk ka qytetërim si ai që njohim” (cit. te Jahoda, 2009: 46).

Me gjithë evolucionizmin e tij, që

kishte një karakter shkencor, Çarls Darvini mendonte se racat njerëzore ishin shumë të dallueshme prej njëra-tjetrës, duke marrë një pozicion më pranë poligjenizmit. Për pasojë, në fund të shek. XIX u arrit një sintezë midis idesë së evolucionit të pandashëm të species njerëzore dhe besimit poligjenist në kategoritë e fiksuar racore. Sipas kësaj sinteze, të gjithë njerëzit mund të kenë pasur një origjinë të vetme, por kjo e fundit është kaq e lashtë sa që racat me t'u formuar kanë pasur secila trajektore të veçanta. Sipas filozofit e sociologut Herbert Spenser [Herbert Spencer], racat e tjera kishin përparuar më ngadalë se raca e bardhë, prandaj ato gjendeshin më mbrapa në shkallën e evolucionit. Kjo do të thoshte se i egri e i gjysmë-qytetëruari i shek. XX ishin e shkuara e racës së bardhë dhe se racat e tjera do të ndiqnin të njëjtën linjë evolucionit, por pa e arritur dot racën e bardhë, nëse kjo e fundit e ruante pastërtinë dhe virtytet e saj (Jackson & Weidman, 2004: 71-80).

Në vitet 1870 termi “barbar” filloi të ndryshonte kuptim në studimet që merreshin me racën dhe qytetërimin. Tanimë barbarët nuk ishin shkatërrimtarët e qytetërimit klasik, por një etapë e nevojshme e përparimit të qytetërimit. Antropologu Luis Morgan [Lewis H. Morgan] në vitin 1877 paraqiti skemën e përparimit të njerëzimit sipas tri shkallëve, egërsia, barbaria dhe qytetërimi, të cilën e kishte huazuar nga Monteskeja. Adam Smithi favorizonte idenë e përparimit sipas katër shkallëve: gjuetarët, nomadët blegtorë, bujqit dhe shoqëria tregtare. Nisur prej këtyre përshkallëzimeve të qytetërimit, filozofi Georg Hegel mendonte se kombet e qytetëruar ishin të justifikuar nëse i trajtonin si barbarë kombet që ndodheshin më poshtë në shkallën e zhvillimit, sikurse popujt blegtorë mund të bënin të njëjtën gjë me ata gjuetarë (Bowden, 2009: 56-69). Pranimi gati universal i hierarkisë së racave, bëri që nacionalistët e kombeve të Evropës t'i përfshinin paraardhësit e

përfytyruar të kombeve të tyre në kategoritë prestigjioze racore, si p.sh. arianët, keltët, galët, nordikët etj.

Shkencëtarët e periudhës propozonin disa “atdhe” alternativë për popullatën ariane. Disa u tërhoqën pas persianëve/iranianëve si populli zanafillor arian, duke u nisur nga gjuhët e lashta të Iranit dhe nga pozita e ndërmjetme e këtij midis Evropës dhe Indisë. Disa dolën në pëfundimin se atdheu i indo-evropianëve duhet të ketë qenë në vendburimin e lumenjve Oksa (Amu Darja) dhe Jaksarta (Sir Darja), që do të thotë në vargmalet Pamir në Azinë Qendrore, ku sot takohen kufijtë e Afganistanit, Takhikistanit dhe Kirkizistanit dhe Kinës. Të tjerë autorë, që kërkonin një atdhe evropian dhe, për pasojë, kritikonin “indomaninë” e Mylerit dhe të studiuesve të tjerë propozonin malet Kaukaz e të tjerë sugjeronin Lituanië e Skandinavinë (prej nga kemi termin “raca nordike”) (Arvidsson, 2006: 52-54, 141-143). Siç e shohim në pjesën e mëposhtme, Samiu ishte i mendimit se arianët janë formuar si popull në krahinën e Heratit, që sot është pjesë e Afganistanit dhe e cila ndodhet pranë kufirit me Iranin në perëndim dhe Turkmenistanin në veri.

Samiu mbi qytetërimin, racat dhe kombet

Termi *medeniyet* u shfaq në fjalorët osmanë në vitet 1830-1840, së pari në kuptimin e mirësjelljes, përmirësimit të vetes e zhvillimit moral dhe më pas fitoi kuptimin e qytetërimit, duke u bërë në vitet 1860 një element qendror në ligjërimin burokratik dhe centralist të shtetit në raport me periferitë. Të ndikuar nga antropologjia perëndimore e gjysmës së dytë të shek. XX disa intelektualë osmanë nisën ta përdorin “qytetërimin” në antitezë me “primitivitetin” apo “egërsinë”. Këtë dualitet e shohim në shkrimet e ndryshme të Sami Frashërit. Sipas tij, “qytetërimi është mjeti i lehtësimit të rrotjes së njerëzve”, si në aspektin

teknologjik (hekurudha, avullorja, telegrafi), po ashtu edhe në aspektin moral e shpirtëror, sepse, “qëllimi i qytetërimit e i përparimit është që njerëzit të jetojnë në harmoni, në qetësi, në lumturi, në fatbardhësi e me lehtësi”. Duke arsyetuar në këtë mënyrë, Samiu shkruan se edukimi i grave është mësimi i parë i qytetërimit, përderisa përpara lehtësirave në teknologji, njeriu ka nevojë për harmoni e lehtësi në jetesën familjare (Frashëri, 2004 [XV]: 19). Pra, qytetërimi është akumulimi i dijes njerëzore për të përballuar vështirësitë e jetesës në natyrë, për t’u shkëputur nga egërsia që është gjendja e tij në natyrë: “Njerëzimi ka qenë më parë në egërsi, pastaj doli në barbari e më vonë në qytetëri” (Frashëri, 1988: 274). Qytetërimi ka dy aspekte, njëri është përparimi teknologjik që lehtëson jetesën e njeriut, tjetri është aspekti moral që lehtëson jetesën e tij në paqe me të tjerë dhe që është baza e shoqërisë.

Ku është zanafilla e qytetërimit? Samiu përqafon idenë se krijues i parë i qytetërimit është populli arian. Emrin Aria që shfaqet te shkrimet e gjeografëve të vjetër grekë Samiu e lidh me qytetin e Heratit në Afganistan dhe një popull të vjetër që ka banuar në zonën rreth tij. Ky popull, arianët, është përhapur më vonë në Evropë dhe Indi. Aria është djepi i qytetërimit, sepse aty janë shpikur bujqësia dhe vendbanimet e përhershme, në kohën kur shumica e njerëzve të tjerë ishin blegtorë dhe endacakë. Samiu shkruan se arianët janë raca më e përkryer njerëzore, sepse “popullsia e tij [Heratit] zotëron më shumë se çdo popullsi tjetër njerëzore harmoninë e gjymtyrëve dhe zgjuarsinë e është më përpara se të gjithë të tjerët” (Bakui, 2015: 29-30). Kemi përshtypjen se Samiu e sheh biologjinë, më saktë sasinë e trurit brenda kafkës dhe kapacitetin mendor te njeriut si një faktor të pavarur në lindjen e qytetërimit. Bazuar në studimet antropologjike të kohës së tij, Samiu shkruan se trajta më tërheqëse e kokës njerëzore është ajo e rrumbullakët, ose e zgjatur pak, dhe është kjo trajtë që

përmban edhe më shumë lëndë trunore. Ky tip në përgjithësi gjendet te raca kaukaziane dhe Samiu përmend dy natyralistë të kohës që kanë dalë në përfundimin se populli me kokën më të bukur në gjininë njerëzore është ai shqiptar (Frashëri, 2004[XIX]: 63-64). Në këtë mënyrë, mund të thuhet se Samiu mendonte se arianët ishin deri diku “të paracaktuar” fizikisht dhe mendërisht për të bërë të parët kalimin e madh nga egërsia në qytetërim. Edhe pse qytetërimi mund të mbartet të të gjithë popujt, Samiu mendon se disa raca janë më të prira për ta përthithur dhe zhvilluar më tutje atë. Nga vendndodhja aziatike e arianëve, qytetërimi më së pari u përhap në Indi dhe Kinë, prandaj Azia, shkruan Samiu, “vazhdimisht është gjykuar si djepi i gjinisë njerëzore” (po aty: 31).

Dallimi i qytetërimit nga egërsia është se njerëzit e egër, edhe pse mund të jetojnë në grupe nuk kanë zhvillimin teknologjik të njerëzve të qytetëruar. Të egrit nuk dinë të ndërtojnë vendbanime e të veshin rroba, nuk dinë të mbjellin e madje as nuk dinë të gjuajnë në mënyrë të organizuar. Sipas Samiut, në kohën e tij në gjendje të egër ndodheshin maorët e Zelandës së Re, vendasit e Amerikës Veriore, të Kalifornisë dhe të Brazilit të Jugut. Pak më lart se sa të egrit e shkallës së parë, ndodhen ata të shkallës së dytë, popujt peshkatarë si eskimezët, laponët etj. dhe popujt gjuetarë si pjesa më madhe e indianëve të Amerikës, shumica e zezakëve të Afrikës dhe banorët e trevave të brendshme të ishujve të Oqeanit Indian. Pas njerëzve të egër vjen kategoria e popujve endacakë që merren me blegtori. Në vende të tjera duket se për këtë fazë të udhëtimit të njeriut drejt qytetërimit, Samiu përdor termin e “barbarisë”. Më lart se endacakët (barbarët) janë popujt e qytetëruar që merren edhe me bujqësi, xehetari, zejtarë etj. Kuptohet që edhe popujt e qytetëruar në historinë e tyre kanë kaluar nëpër etapat e egërsisë dhe të endacakërisë, ndërsa popujt të tjerë kanë mbetur pa u qytetëruar.

Duke përgjithësuar, Samiu shkruan se raca kaukaziane gjendet në shkallën e epërme të qytetërimit, ajo mongole në shkallën e mesme, ndërsa zezakët janë ende të egër dhe gjenden në shkallën e poshtme të qytetërimit (po aty: 77-85).

Esat Reso dhe Zija Xholi kanë shprehur mendimin se Samiu mund të jetë mbështetur te antropologu Luis Morgan, në veprën e të cilit me titull *Shoqëria e lashtë* (1877) kjo ndarje në tri etapa e evoluimit të njerëzimit ka një vend qendror (Reso, 1962: 98; Xholi, 1987: 322). Kujtojmë se vepra e Morganit ka ndikuar në konceptimin materialist e dialektik të ndryshimit shoqëror të Karl Marksi dhe Fridrih Engelsi. Studimi *Shoqëria e lashtë* është referenca kryesore e librit të Engelsit *Origjina e familjes, e pronës private dhe shtetit*, e shkruar nga Engelsi. Samiu mund ta ketë lexuar dhe përdorur librin e Morganit, ose kjo përcjellje e skemës së Morganit të Samiu është parapëlqyer prej studiuesve shqiptarë të periudhës komuniste për të afruar Samiun me metodën dialektike të klasikëve të marksizmit.

Termin “racë” (*vrk, cins*) Samiu e përdor për të përshkruar një komb, apo tog kombesh, të dallueshëm në tiparet fizike nga të popujt të tjerë dhe që ndodhet në një fazë të caktuar të qytetërimit. Për Samiun, kombi (*kavim*), apo populli, është bashkësia e njerëzve që kanë prejardhje të njëjtë dhe që flet një gjuhë. Fjalën “populli” (*millet*) Samiu e përdor edhe në kuptimin e bashkësisë fetare, mirëpo, të paktën në tekstet që kemi shqyrtuar, ky kuptim nuk është më i rëndësishëm se sa ai që ka të bëjë me prejardhjen dhe gjuhën. Përderisa Samiu mendonte se qytetërimi fitohet kryesisht përmes edukimit, edhe qytetërimi islam është zhvilluar prej kombeve/popujve arabë e persë, të cilët gjuhët “universale” të islamit, arabishten dhe persishten, i kishin gjuhë amtare dhe që i mësonin edhe myslimanët joarabë e jopersë. Samiu pjesëmarrjen e Perandorisë Osmane në qytetërimin modern e shihte të pashkëputur nga zhvillimi i

gjuhës turke dhe këtij qëllimi ai i kushtoi veprat madhore. Edhe pse turqit në kohën e Samiut mund të quheshin kombi “titullar” i perandorisë, siç ishin anglezët kombi qendror i Perandorisë Britanike, prapëseprapë gjuha e tyre, turqishtja ishte më pak e zhvilluar, sepse burokracia osmane fjalët që i duheshin për administrimin e shtetit i huazonte nga arabishtja dhe persishtja, si edhe së fundi nga gjuhët evropiane. Këtë gjë Samiu e shihte si dobësi dhe kërkonte që osmanishtja të kthehej për nga rrënjët e saj turke. Në këtë aspekt, Samiu vlerësonte si bashkësi ideale atë që fliste një gjuhë dhe që kuptohet kishte prejardhje të njëjtë.

Prej një kombi mund të formohen të tjerë, por prapëseprapë ata trashëgojnë vetitë e tij, si p.sh. prej arianëve rrjedhin kaukazanët, prej kaukazanëve rrjedhin pellazgët, keltët dhe grekët, prej pellazgëve rrjedhin ilirët, trakasit, maqedonasit dhe frigjitë, prej ilirëve rrjedhin shqiptarët. Në këtë kuptim të gjithë këta popuj janë pjesëtarë të një lloji (*cins*) apo race (*ırk*). Dallimet midis racave e kombeve nuk kanë të bëjnë me ngjyrën e lëkurës, por me aftësitë mendore dhe qytetërimin. Samiu shkruan se në kohën e tij Franca ishte e qytetëruar dhe Borneo ishte populluar me njerëz të egër, mirëpo para dy mijë vjetësh në Francë jetonin njerëz të egër, ndërsa në Lindjen e Mesme, në luginën e Tigrit, ku sot shihen fise endacake, dikur ka pasur popuj të qytetëruar. Pra dallimi midis popujve të një epoke dhe dallimi midis etapave historike të një populli është dallim qytetërimi (Frashëri, 2004 [XIII]: 20-21).

Bartës të qytetërimit në kohë të ndryshme mund të jenë kombe të veçantë në epoka të caktuara, por për sa kohë që ata ia përcjellin dijet njëri-tjetrit, qytetërimi si i tillë nuk shuhet: “Qytetëria ndërrohet vend, nga një komb në tjetrin, por kurrë nuk humbet” (Frashëri, 1988: 274). Kështu, midis qytetërimit të lashtë grek dhe atij modern evropian nuk ka shkëputje, sepse midis tyre ka ekzistuar qytetërimi islam, i cili, thotë

Samiu, ishte më i plotë e më i përsosur se ai grek (Frashëri, 2004[XIII]: 26-27). Mirëpo, qytetërimi në një vend të caktuar dhe te një popull i caktuar edhe mund të prapësohet. Dikur kaukazanët ishin të egër, ndërsa kinezët, që i takojnë racës mongole, dikur ishin më të qytetëruar se kaukazanët. Edhe pse në një artikull të vitit 1878 Samiu shkruan se “nuk besojmë që të ketë ndonjë vend, ndonjë komb e ndonjë popull që të mos jetë i aftë të pranojë qytetërimin” (Frashëri, 2000: 166), prapëseprapë duket se ai beson se aftësitë fizike e mendore të një race të caktuar e bëjnë atë më të aftë, apo më pak të aftë për të qenë bartëse dhe zhvilluese e qytetërimit. Vërtet kinezët dikur ishin më të përparuar se popujt e tjerë, mirëpo për shkakun e aftësive të tyre të kufizuara mendore ata qëndruan për mijëra vjet në të njëjtin stad teknologjik dhe nuk bënë më tutje. Përkundrazi, evropianët për një kohë më të shkurtër jo vetëm që arritën nivelin e zhvillimit të kinezëve, por ua kaluan atyre. Përparimi i evropianëve nuk është rastësor, sepse “raca kaukaziane, krahas përsosurisë së organeve të tjera të trupit, ka kokë më të madhe dhe tru më të shumtë e më të rëndë, del se është më e mençur, më e aftë dhe me më shumë talente” (Frashëri, 2004[XIX]: 87-88). Mund të themi se Samiu qëndron më pranë pozitës poligeniste të ndarjeve racore, sepse duket se evoluimi njerëzor ka përcaktuar njëherë e mirë pabarazinë e kapaciteteve të racave dhe se kjo pabarazi e vendos racën kaukaziane më lart se racat e tjera, edhe pse një pjesë e popujve kaukazanë mund të mos jenë të qytetëruar në një periudhë të dhënë (p.sh. shqiptarët në shek. XIX).

Samiu shkruan se prej arianëve që emigruan në Evropë dhe sollën qytetërimin në këtë kontinent, u krijuan dy degë, pellazgët dhe keltët (Bakui, 2015: 28-31). Ndoshta sepse vendndodhjen e pellazgëve Samiu e përcakton në Anadoll dhe në Ballkan, pra më pranë qytetërimeve mesdhetare të lashtësisë, ndërsa atë të keltëve në Evropën Qendrore

e Veriore, ai privilegjon të parët si bartës të qytetërimit për të gjithë Evropën:

Duketë që këta [pellazgët] erdhë më parë se gjithë prej mezit t'Azisë n'Evropë; edhe këta prunë në këtë vënd ditjen e të bërit shtëpi me mur si edhe diturin' e të lëruarit, të mbjellit të korrurit; se ata njerës që gjendeshin më parë tyre n'Evropë ishin t'egërë e roninë nëpër pyje e nëpër shpella duke ushqyer me pemëra t'egra e me mish gjahu (Frashëri, 1999: 5-6).

Siç dihet, teoria e pellazgëve si populli i parë “arian” që ka jetuar në Ballkan është përfaqëuar prej rilindësve shqiptarë gjatë përplasjes së tyre me nacionalizmin grek. Ndërsa intelektualë të caktuar grekë e përdorin teorinë e prejardhjes pellazgjike për të argumentuar se shqiptarët dhe grekët rridhnin nga i njëjti trung etnik apo racë, teoria pellazgjike pas ripunimit prej nationalistëve shqiptarë, nuk thekson lidhjen e shqiptarëve me grekët, por diferencimin midis tyre. Ardhja e pellazgëve në Ballkan ishte më e hershme se ajo e helenëve dhe gjuha shqipe konsiderohej me prejardhje të drejtpërdrejt ariane (Clayer, 2009: 247-248). Kështu, Samiu shkruan se “Tesalia prej grekëve të lashtë konsiderohej si djep i qytetërimit dhe më parë banohej nga pellazgët” (Bakui, 2015: 45), duke aluduar se ishin pellazgët ata që përcollën qytetërimin e parë te helenët. Mirëpo, për shkak të vendeve malore ku jetonin pellazgët, ose ku ata u shtynë prej valëve të helenëve, pellazgët trakas filluan të merreshin kryesisht me blegtori e gjueti, humbën qytetërimin dhe “janë njohur për të egër” e luftëtarë trima nga ana e grekëve. Megjithatë, grekët e lashtë besonin se poezia dhe muzika e kanë pasur zanafillën në Trakë (po aty: 55). Për maqedonasit e lashtë, Samiu shkruan se kanë pasur të njëjtin gjak me shqiptarët e sotëm dhe se “ishin të privuar nga qytetërimi dhe jetonin si beduinë (endacakë)” (po aty: 82).

Ngjashëm, edhe fiseve të vendosura në Iliri e që i përkisnin racës pellazge, “u

mungonte dituria e qytetërimi dhe kishin prirje për vjedhje e korsari [pirateri]” (po aty: 65). Mirëpo, rënia e ilirëve në barbari dhe izolimi i tyre prej rrjedhave të qytetërimit, bëri që ata të ruajnë më të pastra gjenet pellazgo-ariane, krahasuar me përzierjen e helenëve me latinë, sllavë, turq etj. Siç e pamë në pjesën e parë të artikullit, edhe ata studiues të racave që e pranonin se nuk mund të kishte raca krejtësisht të pastra dhe të papërziera me të tjera, gjithsesi përzierjen racore e barazonin me degjenerimin, prandaj ata vlerësonin më lart ata popuj bashkëkohorë ku procesi i përzierjes racore supozohej të ishte ndalur kohë më parë, ose të kishte avancuar më pak se te të tjerët. Samiu mendon se shqiptarët e kohës së tij janë, për nga aspekti racor, më lart se popujt përreth, sepse morali dhe zakonet e tyre nuk ndryshojnë prej atyre të ilirëve e pellazgëve; këta të fundit kanë qëndruar “veçan nga kombet e qytetëruar... ashtu si malësorët e tanishëm të Dibrës dhe të Shkodrës” (po aty: 279). Te manifesti ai shënon se “jemi m'i vjetri komp i Evropësë edhe m'i fisçmi e më trimi; flasimë më të vjetrënë e më të mirënë gjuhë të farësë arjane” (Frashëri, 1999: 108).

Kjo panoramë romantike e jetesës së veçuar në skaj të botës së qytetëruar, të kujton idenë e Zhan Zhak Rusoit për “fisnikun e egër” që ka ruajtur mirësinë e karakterit dhe nuk është paprekur nga korrupsioni që pashmangshëm shoqëron qytetërimin (Bilmez, 2009: 362). Mirëpo qëllimi i Samiut ishte modernizimi i Shqipërisë, dhe “pastërtia” racore u kishte kushtuar shqiptarëve mbetjen mbrapa në zhvillimin e qytetërimit. Sami shkruan te abetarja e tij e gjuhës shqipe se “nukë mund të quhemi të qytetëruarë plot gojëjënë, po as fare barbarë s'jemi; jemi gjysmësë-barbarë, edhe udha që kemi për të marrë gjer sa t'arrijmë në qytetërit është shumë m'e gjatë se udha që na ka nxjerrë nga barbaria” (Frashëri, 1988: 275). Arsimimi dhe fitimi i dijeve është rruga e duhur për të marrë

pjesë në qytetërimin modern dhe ajo fillon me mësimin e shkrimit të gjuhës amtare. Shqiptarët nuk mund të qëndrojnë më të veçuar prej qytetërimit nëse ata duan të ruajnë lirinë dhe mëvetësinë e tyre, për vetë faktin se qytetërimi modern po depërton në viset e tyre. Ashtu si dikur popujt e egër të kontinentit të ri u detyruar të përfshihen me përdhunë në qytetërimin e kolonëve evropianë, edhe në fund të shek. XIX ekziston rreziku që shqiptarët të trajtohen si një komb i egër. Në këtë aspekt, është me rëndësi të shihet se çfarë shkruan Samiu në një artikull të botuar në vitin 1878:

Qytetërimi dhe ndikimi i kohës është një lumë i madh që rrjedh shumë shpejt dhe me rrëmbim. Atë që qëndron para tij dhe që përpiqet të rezistojë, e merr dhe e zhduk. Ai që do shpëtimin duhet të nënshtrohet. Një popull që është i qytetëruar, shumë rrallë bie nën sundimin e një populli tjetër, dhe, në qoftë se do të binte, në sajë të arsimitit e qytetërimit që ka, do ta ruante kombësinë e vet dhe natyrisht një ditë ia del që të rikthejë pavarësinë e vet (Frashëri, 2000: 282).

Politikanët dhe intelektualët ballkanas në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX përpiqeshin të tregonin se popujt e gadishullit i përkisnin të njëjtit qytetërim si dhe Perëndimi, dhe kërkonin që të largonin prej vetes etiketën e popujve “të egër”, “barbarë” e “orientalë”. Turku paraqitej si “tjetri barbar” i ardhur nga Azia. Edhe Samiu dha ndihmesën e tij për vendosjen e një dallimi racor e qytetërimor midis kombit shqiptar dhe atij turk, sidomos në manifestin *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*. Duke parashikuar se sundimit osman në territoret evropiane po i vinte fundi, Samiu mendonte për një shkëputje të butë të një shteti shqiptar nga perandoria. Për të orientuar këtë shkëputje, që ai besonte se po ndodhte me Lidhjen e Pejës, Samiu shkroi në manifestin e tij edhe vlerësimin e mëposhtëm për turqit:

Ç’janë Tyrqitë? - Një komp i egërë t’ardhmë nga shkretëtirat e Asisë së veriut me nga një hosten në dorë. Këta me egërsi të tyre zunë më të bukurit’ e vendeve të botësë e më të qytetuarëtë; edhe si rojnë, i gremizë e i doqnë, po i mbajnë edhe gjer sot nënë egërsi, nënë një varfëri, nënë një tirani, që tëmëron gjithë botënë. Nga gjithë këta vende që po rënkojnë që nga kaqë qint vjet e tëhu, edhe njëri është Shqipëri’ e gjerë që heq këtë tirani, a heq më shumë se gjithë vëndet e tjerë nga pakujdesj’ e shqiptarëvet. Tyrqitë janë nga ata kombe, që kanë shkuarë mi dhet si një breshërimë e si një borë. Ku janë sot Hynëritë, Vandalëtë, Mongolëtë, Avarëtë, Gotëritë e kaq kombe t’egëre, që zunë gjysmësën’ e faqes së dheut duke djegurë, duke gremizurë e duke derdhurë gjak? Tyrqitë s’kishin të drejtë të rojnë më tepër se ata shokët e tyre; rojtjen’ e qëndrimnë gjer më tani e patnë qelepir, tani s’kanë monjë të drejtë të rojn’ e të qëndrojnë më edhe as din’ e as duanë e të rojnë më, se gjer më sot s’kanë bërë një kombëri e një qeveri si gjithë bota, po duanë të rojnë për jetë me egërsi. Këta do të humbasinë dhe duhet të humbasinë që të shpëtonjë njerëzia syresh; po ç’kanë me na që, duke rënë duanë të na marrinë edhe na me vetehe? Na ç’kemi me ta? A mos erthmë me ta? Jo kurrë! Na s’jemi as Turqias të ardhurë nga shkretëtirat e Asisë. Na jemi m’i vjetri komp i Evropësë; kemi të drejtë në dhet’ t’Evropësë më tepër se çdo komp (1999: 71-72).

Në librin *Arratisje nga Lindja* (Sulstarova, 2019), këtë citat e kemi interpretuar si shembull të orientalizmit shqiptar në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare, meqenëse Samiu vendos një vijë imagjinare midis Azisë dhe Evropës për të treguar se njërën anë ndodhet barbaria e në tjetrën qytetërimi. Turqit, si popull aziatik, janë barbarë që kanë qëndruar në Evropë për shekuj dhe jo vetëm që nuk janë qytetëruar vetë, por vijnë në mbajnë nën barbari popuj evropianë, midis këtyre edhe shqiptarët.

Sigurisht që orientalizmi, i kritikuar nga Eduard Said [Edward W. Said] dhe të tjerë pas tij, është një ligjërim që bazohet mbi këndvështrimin imperialist perëndimor për Lindjen, ngaqë dëshiron që këtë të fundit ta përcaktojë si “tjetrin” e Perëndimit.

Këtij interpretimi i përmbahemi edhe këtu, duke theksuar aspektin racor, që mendojmë se qëndron i fshehur pas diferencimit që bën Samiu midis turqve endacakë e barbarë, me atdhe Azinë, në njërën anë dhe shqiptarëve si kombi më i vjetër i Evropës në anën tjetër. Edhe pse Samiu nuk e thotë, ka mundësi që për këtë diferencim ai të jetë ndikuar prej ndarjes “fillestare” racore midis arianëve dhe turanianëve, këta të fundit të cilësuar gjerësisht në shek. XIX si paraardhës të turqve. Në gjysmën e dytë të këtij shekulli u bë i zakonshëm krahasimi i arianëve me një popullit tjetër mitik që supozohej se e kishte origjinën në një zonë të Azisë që në shkrime të lashta quhej Turan. Maks Myleri, prej studimeve të teksteve të shenjta të zorostrianizmit, doli në përfundimin se armiqte e bujqve indo-evropianëve ishin sidomos popujt endacakë turanianë, gjuha e të cilëve ishte më pak e zhvilluar se familja e gjuhëve indo-evropiane (Arvidsson, 2006: 57). Anatomisti e antropologu suedezi Anders Retzius, nismëtari i studimit të formës dhe vëllimit të kafkës dhe zbatues i pseudoshkencës së frenologjisë, zbuloi se suedezët, norvegjezët, danezët, gjermanët, holandezët dhe anglezët ishin kokëgjatë, prandaj e kishin prejardhjen prej arianëve, ndërsa finlandezët, hungarezët, turqit dhe sllavët, si kokëgjerë, e kishin origjinën prej pushtuesve “turanianë” të ardhur nga Azia. Në gjykimin e tij, turanianët ishin më inferiorë se arianët (Jahoda, 2009: 41). Një frenolog dhe antropolog britanik, Xhon Uiliam Xhekson [John William Jackson] në një artikull të botuar në vitin 1868 në dy numra të revistës *The Antrological Review*, termin “turanian” e përdorte si emërtim të të gjithë popujve joarianë dhe josemitë të

Azisë, duke përfshirë në të turqit, kinezët, mongolët, japonezët, koreanët etj. Sipas hierarkisë së tij të racave, turanianët vinin më poshtë arianëve dhe më sipër zezakëve në shkallën e qytetërimit. Me fjalë të tjera, turaniani nuk ishte një racë e egër, por barbare. Përballë tipit “nervoz” të arianit, turaniani ishte “muskuloz”, fizionomia e këtij ishte e vrazhdë dhe intelekti i kufizuar. Sipas Xheksonit, “turaniani është një njeri i ndalur përpara se të arrinte nivelin kaukazian të zhvillimit; me fjalë të tjera ai është thjesht trajta embrionik e iranianit [arianit]”. Turaniani mund të punonte shumë, por nuk mund të ngrihej në shkallën e intelektit të arianit dhe kjo shpjegonte pse Kina e Japonia kishin pasur qytetërime të sofistikuar shumë herët në histori, por që kishin degjeneruar më vonë. Po kështu edhe pse turqit kishin sunduar për një kohë të gjatë mbi arianët, kjo ka ardhur kryesisht prej dobësisë së këtyre të fundit në një epokë historike. Tashmë gjithçka tregonte se epërsisë së turanianit mbi arianin kishte përfunduar njëherë e mirë dhe tani ishte radha e turanianit t’i nënshtrohej kolonizimit të njeriut të bardhë (Jackson, 1868).

Sigurisht që Samiu e njihnte mirë këtë lloj racizmi të shprehur nga pseudoshkencëtarë evropianë si Xheksoni. Skemën e diferencimit racor me tri raca kryesore e zbaton edhe Samiu, i cili përdor termin “mongol” në vend të atij “turanian” të Xheksonit. Samiu te citati i mësipërm mbi turqit mbështetet mbi supozime racore të egërsisë dhe barbarisë së aziatikëve që kanë sunduar mbi evropianët e prejardhjes ariane, siç janë shqiptarët. Mirëpo, në enciklopedinë e tij në gjuhën turke, ai shkruan se turqit janë një popull i madh që shtrihet nga Adriatiku deri në Kinë. Ata i përkasin racës mongole dhe janë pasardhës të popullit turanian (*ümem-i Turaniye*). Gjuhën turke e quan si një nga më të bukurat në botë. Ajo ka qenë e shkruar me alfabetë të ndryshme, përpara islamizimit të turqve të perëndimit dhe përvetësimit prej tyre të alfabetit arab. Shkrimet e

Samiut për prejardhjen e turqve, shtrirjen gjeografike të popujve turq dhe për gjuhën e kulturën turke i kanë shërbyer formimit të nacionalizmit politik të turqit e Perandorisë Osmane. (Bilmez, 2009: 352-354). Në këtë mënyrë Samiu i kushtohet dy identiteteve kombëtare, atij shqiptar dhe turk, në mënyrë paralele. Kur ai shkruante mbi kombin turk, ai përpiquej që ta lartësonte të shkuarën, kulturën dhe gjuhën e tij, por kur i kushtohet kombit shqiptar, ai nuk druhej që, për hir të lartësimit të prejardhjes së supozuar ariane të shqiptarëve, ai të shprehej për turqit si një komb i egër e barbar.

Gjithsesi, shkrimet e tij paralele për kombin shqiptar dhe atë turk kishin për bazë idenë e qytetërimit. Samiu i konsideronte kombet si trajtën më të përparuar të shoqërisë njerëzore dhe bashkësinë që përshtatej më mirë me qytetërimin modern. Ndërsa ai kërkonte organizimin e shqiptarëve në një shtet kombëtar, ai rezervohet të kërkonte të njëjtën gjë për kombin turk, për sa kohë që perandoria osmane ekzistonte. Ndoshta ai mendonte se kombi turk duhej të zhvillohej kulturalisht dhe të përgatitej për eventualitetin e shpërbërjes së perandorisë, siç ndodhi në të vërtetë me shpalljen e Republikës së Turqisë.

Përfundim

Sami Frashëri i takon plejadës së intelektualëve reformatore që jetuan në dekadat e fundit të Perandorisë Osmane. Ata çmonin aspekte të qytetërimit modern perëndimor dhe kërkonin që ato të huazoheshin edhe në Perandorinë Osmane. Samiu ishte një njohës i mirë i antropologjisë perëndimore të kohës dhe lidhjes së saj me teoritë e familjeve gjuhësore dhe të racave. Në Perëndimin e gjysmës së dytë të shek. XIX dominonte ideja se kombet ishin bashkësi me prejardhje të pashkëputur historike dhe për pasojë bartës së gjeneve, tipareve fizike e mendore të paraardhësve të tyre. Kultura bartej nga gjenet dhe gjuha shihej si

manifestim i aftësive mendore e intelektuale të një kombi. Dominimi perëndimor në botë, degradimi i perandorive shekullore në Lindjen e Afërt, Lindjen e Mesme e Azi shiheshin si dëshmi se raca e bardhë, kaukaziane, qëndronte më lart në shkallën e qytetërimit. Thurja e kësaj ideje me zbulimin e farefisnisë së shumicës së gjuhëve të Evropës me persishten dhe sanskritishtja, bëri që të zhvillohej teoria e prejardhjes së njerëzve të bardhë nga një popull i vetëm, ai arian, që njëherazi konsiderohej si shpikës e përhapës i qytetërimit të parë në botë.

Samiu e trajtoi temën e lindjes dhe të përhapjes së qytetërimit në veprat e tij enciklopedike e gjuhësore, por edhe në ato që kishin lidhje me etnogjenezën e shqiptarëve dhe situatën politike të kombit shqiptar në kohën e tij. Për aq sa kemi mundur të hulumtojmë në vepra të Samiut që disponojmë në gjuhën shqipe, në këtë artikull jemi përpjekur të ndërtojmë marrëdhënien që Samiu mendonte se ekzistonte midis qytetërimit, racave dhe kombeve që rrjedhin prej tyre. Sipas tij, “qytetërimi” përmbledh gjithçka që njerëzimi ka krijuar për të dominuar mbi natyrën dhe për të lehtësuar jetesën e tij. Qytetërimi nuk ka të bëjë vetëm me përparimin material të njerëzimit, por edhe me atë shpirtëror. Për këtë arsye, njerëzit e parë, edhe pse mund të kenë pasur gjuhë e disa vegla, kanë jetuar në gjendje të egër dhe kanë qenë më të varur prej natyrës se sa njerëzit e epokave të mëvonshme. Por jo të gjithë njerëzit janë zhvilluar njëllë, prandaj në secilën epokë ka pasur grupe njerëzore në gjendje të egër dhe grupe më të qytetëruara. Sipas shkallareve egërsi, barbari dhe qytetërim që ishin koncepte të përhapura në kohën e tij për të karakterizuar hierarkinë e racave dhe të kombeve, Samiu shkruan se popujt gjuetarë janë të egër, ata endacakë e blegtorë janë barbarë dhe ata që merren me bujqësi janë të qytetëruar.

Populli i parë bujqësor, sipas tij, ka jetuar në krahinën e Heratit, prej nga u

quajt “arian”. Ata ishin të aftë për të bërë kalimin në qytetërim sepse evoluimi i kishte favorizuar fizikisht dhe, ç’është më e rëndësishmja, mendërisht, duke bërë që ata të ishin më të zgjuar se të tjerët. Si pasojë e emigrimeve, arianët e përhapën bujqësinë dhe qytetërimin në Azi dhe Evropë. Sipas Samiut, përparësitë e racës ariane janë përcjellë te pasardhësit e tyre gjenetikë dhe kjo ka bërë që një pjesë e këtyre të fundit, edhe nëse kanë rënë në shkallaren e barbarisë apo të gjysmë-qytetërimit, të jenë të aftë t’i ringjisin sërish, në këtë mënyrë duke ia kaluar sërish racave të tjera.

Pellazgët, thotë Sami, ishin një popull arian dhe, gjenet ariane ata i përcollën te ilirët e këta i përcollën te shqiptarët. Samiu kombin shqiptar e mban për më të vjetrin, më të hijshmin dhe më të zgjuarin në Evropë.

REFERENCAT

- Arvidsson, S. (2006) *Aryan Idols: Indo-European Mythology as Ideology and Science*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Bakui, Z. (përg.) (2015) *Shqipëria dhe shqiptarët: Hulumtime historike në enciklopedinë* Kamus Ul Alam të Sami Frashërit. Tiranë: West Print.
- Bilmez, B. (2009) “Shemseddin Sami Frashëri (1850-1904): Contributing to the Construction of Albanian and Turkish Identities”, në Mishkova, D. (përg.), *We, the People: Politics of National Peculiarity in Southeastern Europe*. Budapest: Central European University Press.
- Bowden, B. (2009) *The Empire of Civilization: The Evolution of an Imperial Idea*. Chicago: The University of Chicago Press.
- Frashëri, S. (1988 [1879]) *Alfabetare e gjuhësë shqip, në Vëpra I*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH.
- Frashëri, S. (1999 [1989]) *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë.
- Frashëri, S. (2000) *Kush e prish paqen në Ballkan? Publicistika e Sami Frashërit turqisht*. Pejë: Dukagjini.
- Frashëri, S. (2004 [XIII] [1879]) *Vëpra 13: Qytetërimi islam*. Shkup: Logos-A.
- Frashëri, S. (2004 [XV] [1879]) *Vëpra 15: Gratë*. Shkup: Logos-A.
- Frashëri, S. (2004 [XIX] [1885]) *Vëpra 19: Përsëri njeriu*. Shkup: Logos-A.
- Jackson, J. W. (1868) “Iran and Turan”, *The Anthropological Review*, 6 (21): 121-137, 6 (22): 286-301.
- Jackson, J. P. & Weidman, N. M. (2004) *Race, Racism and Science: Social Impact and Interaction*. Santa Barbara: ABC-CLIO.
- Jahoda, G. (2009) “Intra-European Racism in the Nineteenth-Century Anthropology”, *History and Anthropology*, 20 (1): 37-56.
- McCarthy, T. (2009) *Race, Empire and the Idea of Human Development*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Reso, E. (1962) *Pikëpamjet filozofike, politike dhe shoqërore të Sami Frashërit*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Sulstarova, E. (2019) *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Bot. I 4-të. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Xholi, Z. (1987) *Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare*. Tiranë: 8 Nëntori.

ABSTRACT

Sami Frashëri is one of the most distinguished and reformist intellectuals who lives in the last period of the Ottoman Empire. He was knowledgeable in the anthropological discoveries and theories of his time and debates about the genealogies of languages, races and nations. The article is an attempt to shed light on his use of the terminology of “civilization”, based on a survey of the texts that he himself wrote in Albanian, or which are now available in the Albanian language. The article argues that the meaning of “civilization” in various text is more or less consistent. Through it, Sami wanted to organize his conception of the formation of the cultures, races and nations during the evolution of mankind. Also, “civilization” is employed by Sami in his explanations about the origins and the evolution of the Albanian nation and about overcoming this nation’s material and cultural backwardness, when compared to the most developed European nations at the end of the 19th century.

Key words: *Civilization, race, nation, aryan, Albanian*

NJË EKSPLORIM I TIPAREVE TË IDEACIONIT PARANOID DHE HOSTILITETIT NË SHOQËRINË SHQIPTARE

Blerta BODINAKU
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë
E-mail: bbodinaku@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Ky artikull eksploron tipare të hostilitetit dhe ideacionit paranoid të pranishme në shoqërinë Shqiptare, duke përdorur të dhëna të standardizuara për popullatën Shqiptare dhe të mbledhura përmes administrimit të variantit shqip të SCL-90-R. SCL-90-R u administrua në një popullatë përfaqësuese në Tiranë ($N = 501$) dhe në popullatë të qëllimshme klinike ($N = 209$). Përmes analizave statistikore u krahasuan vlerat midis kampionëve në nivel global, në nivel nënshkallësh dhe nivel pohimesh, duke evidentuar nivelin *normal* të simptomatologjisë në nivel popullate të përgjithshme. Të dhënat evidentuan diferenca të pritshme midis vlerave të raportuara nga popullata e përgjithshme dhe ajo klinike, ku padyshim popullata klinike shfaq vlera më të larta në të gjitha konstruktet psikologjike. Konstrukti i hostilitetit dhe mendimit paranoid shfaqën diferencat më të ulëta midis popullatave dhe në disa raste në nivel shumë të krahasueshem. Hostiliteti dhe ideacioni paranoid janë tipare gjithmonë e më të dukshme në shoqërinë Shqiptare dhe që manifestohen në formën e sjelljes agresive dhe mosbesimit në të gjitha trajtat dhe nivelet në jetën shoqërore dhe ndërveprimet personale. Të dy këto konstrukte ushqejnë njëra tjetrën, por edhe një sërë problemesh të tjera sociale të pranishme në shoqërinë Shqiptare. Megjithatë, si hostiliteti i shtuar, ashtu edhe ideacioni paranoid, më tepër se problem në vetvete, duhen kuptuar si manifestime simptomatike të dinamikave traumatike dhe të trashëguara në mënyrë ndërbreznore në kulturën dhe shoqërinë Shqiptare.

Fjalë kyçe: *SCL-90-R, hostilitet, ideacion paranoid, agresivitet, mosbesim, tranzicion*

Dr. Blerta Bodinaku është pedagoge pranë Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Blerta Bodinaku është psikologe klinike dhe psikoterapiste. Gëzon titullin doktore shkencash në psikoterapi dhe vlerësimin psikometrik, lëshuar nga Universiteti Sigmund Freud në Vienë.

Prej 32 vitesh, shoqëria Shqiptare po përjeton një tranzicion politik, social dhe ekonomik, i cili reflektohet në mënyrë të dukshme në dinamikat dhe sjelljen shoqërore të shqiptarëve, në të gjitha dimensionet e jetës shoqërore. Nga dinamikat brenda njësisë më të vogël, familjes, deri në ato të strukturave më komplekse si politikë, ekonomi, drejtësi, shëndetësi, arsim, etj., shoqëria Shqiptare paraqet në mënyrë konstante nivel të shtuar agresiviteti dhe mobesimi.

Çdo sistem politik shoqërohet nga një regjim social dhe ekonomik specifik, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mënyrën se si ndihen dhe si mendojnë njerëzit (Clarke & Hoggett, 2004; Glassner, 1999; McNally, 2008; Thomas, 2011). Për këtë arsye, tranzicionet nuk janë asnjëherë të thjeshta; ato vijnë me nevojën për ndryshim të mendësisë, të mënyrës së të menduarit, nevojën për të zhvilluar mekanizma të reja shoqërore dhe personale, kërkojnë aftësi për t'u përshtatur dhe për të gjetur kuptime të reja.

Historia e tranzicioneve politike në shoqërinë Shqiptare është e gjatë dhe komplekse. Vetëm në pak më shumë se 100 vitet e fundit, shoqëria Shqiptare ka përjetuar me një shpeshtësi të pazakontë disa zhvendosje dramatike politike, shoqërore dhe ekonomike. Këto zhvendosje përfshijnë shkëputjen nga perandoria Osmane dhe themelimin e shtetit Shqiptar, themelimin e republikës, zëvendësimin brenda një kohe të shkurtër me monarki, vendosjen e e regjimit totalitar, rënien e komunizmit dhe përpjekjet për të ndërtuar një sistem demokratik dhe me ekonomi të lirë. Midis këtyre këtyre zhvendosjeve janë përjetuar dy Luftërat Botërore dhe një sërë ngjarjesh traumatike që kanë ndodhur gjatë viteve të tranzicionit. Një dinamikë e tillë ndryshimesh dramatike, nuk ka mundësuar hapësirën e nevojshme për psikën shoqërore për t'u përshtatur, për të zhvilluar një sistem vleror të qëndrueshëm dhe mekanizmat e nevojshëm të funksionimit shoqëror. Në

të kundërt, çdo kalim na njëri sistem në tjetrin, ka mundësuar tranferim brez pas brezi dhe shtresëzim të vazhdueshëm të tipareve të një sistemi të mëparshëm në atë pasardhësin (Bardhoshi, 2010). Bashkë me to janë transmetuar dhe traumat kolektive, të cilat, sipas Ajdukovic (2004) dëmtojnë aftësinë për rigjenerim social, aftësinë për të ndërtuar institucione dhe vlera shoqërore, si dhe aftësinë për të ndërtuar modele të reja ndërvepruese në kontekstin e nevojave të reja komunitare.

Në të gjitha rastet, zhvendosjet vlerore kanë qenë të dhunshme dhe traumatike. Kështu, sistemi vleror i shoqërisë Shqiptare para-socialiste u sulmua në mënyrë sistemike dhe sistematike nga shteti komunist (Kovaci, 2014), i cili synonte të godiste normat dhe kujtesën kulturore (Doja, 2010), familjen (Kaser, 2000), besimin (Littlewood, 2002), pronën private (Bardhoshi, 2012) vlerat e besimit dhe përkatësisë në grup (Lubonja, 2001) si dhe praktikat sociale të vetrregullimit (Musaraj, 2012). Këto ndërhyrje synonin të zbehnin antagonizmin ndërgrupor duke ushqyer homogenitet kulturor, (Musaraj, 2012; Verdery, 1996) si dhe të reduktonin ndjeshëm aftësinë e grupeve dhe individëve për të reaguar në mënyrë të pavarur dhe aftësinë për të ushtruar kontroll mbi jetët personale. Këto praktika rezultuan në marrëdhënie shoqërore dhe familjare të tëhuajësuar, imazhe të kufizuara për veten, familjen, shoqërinë (Doll, 2010; Lubonja, 2001; Nixon, 2009), mendim paranoid dhe dikotomik (Lubonja, 2001) si dhe dëmtuan mekanizmat shoqërorë të reziliencës dhe vetërregullimit (Littlewood, 2002).

Rënia e regjimit (1990/1991) e ekspozoi shoqërinë Shqiptare me të tjera sfida, po aq drastike dhe traumatike sa ato të mëparshmet (de Waal, 2005; Kovaci, 2014). Liberalizimi i menjëhershëm dhe drastik i jetës dhe ekonomisë (Kaser, 2000) krijoi një zhvendosje radikale nga një gjendje kontrolli absolut në një gjendje neglizhimi absolut

nga shteti. Në emër të lirisë, shteti hoqi dorë nga një sërë funksionesh rregullatore, duke lejuar në mënyrë direkte ose indirekte vetrregullimin e proceseve migratore dhe emigratore (de Waal, 2005; Kaser, 2000), ato të drejtësisë (Bardhoshi, 2012; Voell, 2012) dhe të ekonomisë (Muço, 1998; Pettifer, 1996; Schmidt, 1998). Kjo dinamikë e neglizhuar ndryshimi shoqëror krijoi disbalanca shoqërore (Morozzo della Rocca, 1998) të pasuara nga probleme të mprehta ekonomike, shoqërore dhe psikologjike. Për më tepër, lidhshimi i ri politik mbarti një sërë tiparësh autoritariane karakteristike të lidhshimit komunist (Amy & Gjermani, 2013; Kalemaj, 2016), duke ngjallur mosbesim, mendim paranoid, hostilitet, frustrim dhe modele nënshtrimi të ngjashme me ato të sistemit të mëparshëm (Bodinaku, 2014).

Aftësia për t'u përshtatur dhe për të evoluar mundet të jetë veçanërisht e dëmtuar në shoqëritë të cilat kanë dalë nga sisteme totalitare. Autorë të ndryshëm që kanë studiuar shoqëritë post-totalitare të të gjitha llojeve, kanë argumentuar se ekspozimi ndaj terrorit politik sistematik dhe të zgjatur shkakton viktimizim kolektiv, (Pick, 1999), trauma kolektive (Ajdukovic, 2004), identitet të zbehtë individual, prirje për t'u shkruar me tjetrin (Horowitz, 1993) dhe mekanizma psikologjikë dhe social mohues ndaj dhimbjes dhe problemeve (Thomas, 2011). Studimet tregojnë se të gjitha shoqëritë post-komuniste shfaqin probleme të shtuara në lidhje me shëndetin fizik, stresin (Rosenberg et al., 2018; Salavecz et al., 2010), depresionin (Pikhart et al., 2004), probleme të tjera të shëndetit mendor (Pinquart & Silbereisen, 2004), si dhe modele të ngjashme problemesh sociale të tilla si dhuna në familje, apo shoqërore (Ajdukovic, 2004; Raikhel & Bemme, 2016).

Metodologjia

Qëllimi i këtij artikulli është të eksplorojë tiparet e hostilitetit dhe mendimit paranoid të shoqërisë Shqiptare, duke u bazuar në kategori klinike dhe psikometrike të standardizuara dhe duke i shpjeguar nën dritën e tipareve kulturore, historike dhe politike të vendit.

Studimi përfshin kampionin e popullatës së përgjithshme, ose ndryshe kampioni joklinik ($N=501$) dhe kampion klinik ($N=209$). Kampioni joklinik ishte rastësor, i shtresëzuar dhe përfaqësues i popullsisë së Tiranës. Duke pasur parasysh faktin që Tirana (i) paraqet 1/3 e popullsisë së Shqipërisë dhe (ii) karakterizohet nga heterogjenitet shumë i lartë i krijuar nga procese të vazhdueshme migratore dhe duke marrë në konsideratë që (iii) kampionimi i popullsisë së Tiranës në këtë studim përmbush kritere shumë rigorozë përfaqësueshmërie, mund të sugjerojmë që gjetjet për popullsinë e Tiranës mund të përgjithësohen në një shkallë të konsiderueshme në nivel kombëtar. Pjesëmarrësit në kampionin joklinik u shtresëzuan në 3 kohorte moshore (18-29, 30-49, 50+ vjeç) and nëpërputhje me 16 njësitë administrative të Tiranës¹. Kampioni klinik përfshiu 249 gra (49.7%) dhe 252 burra (50.3%). Moshë në këtë kampion varioi nga 18 deri 76 vjeç ($M = 40.2$, $SD = 15.1$).

Kampioni klinik u zgjodh në bashkëpunim me tre qendrat komunitare të shëndetit mendor në Tiranë. Profesionistëve pranë këtyre shërbimeve i'u kërkua t'u paraqisnin pyetësorët të gjithë subjekteve klinike që shfaqën vullnetin të merrnin pjesë në studim. Moshë në kampionin klinik varioi nga 18 deri në 59 vjeç ($M = 37.0$, $SD = 12.4$), nga të cilët 129 ishin gra dhe 80 burra.

Instrumenti i përdorur është Listë-

¹ Njëmbëdhjetë njësitë administrative bashkiake të Tiranës, bashkia Kamëz, bashkia Vorë, komuna Baldushk, komuna Ndroq, komuna Kashar.

Kontrolli i Simptomave 90-i Revizionuar [Symptom Check List 90-Revised (SCL90R)], i cili është një pyetësor vetraportues që vlerëson statusin mendor të individit. Përmban 90 pohime, të cilat janë të organizuara në 10 nënshkallë, përkatësisht: Somatizimi (SOM, 12 pohime), Obsesion-Kompulsioni (O-K, 10), Ndjeshmëria Ndërpersonale (NN, 9), Depresioni (DEP, 13), Ankthi (ANX, 10), Hostiliteti (HOS, 6), Ankthi Fobik (FOB, 7), Ideacioni Paranoid (PAR, 6), Psikoticizmi (PSI, 10) dhe një nënshkallë me Pohime Plotësuese (Plot, 7). Totali i të gjitha pohimeve përbën Indeksin Global të Ashpërsisë (IGA). Çdo pohim i SCL90R vlerësohen në një shkallë Likert 0 (aspak) deri 4 (shumë) që tregojnë intensitetin e simptomave të përjetuara gjatë javës së fundit.

SCL-90-R është një instrument i validuar dhe standardizuar në shqip (Bodinaku, 2014) dhe cilësitë psikometrike të tij janë të krahasueshme me ato të variantit original (Derogates, 1994).

SCL-90-R u administrua në të dy kampionët në kohë paralele dhe të dhënat e gjeneruara u krahasuan duke evidentuar konstruktet psikologjike më të spikatura

të popullatës së përgjithshme. Gjetjet u interpretuan nën dritën e faktorëve historikë, kulturorë dhe politikë të shoqërisë shqiptare.

Rezultatet

Krahasimi i të dhënave midis të dy popullatave përmes mesatareve dhe masës së efektit (effect size) evidentoi dallime të pritshme midis popullatës së përgjithshme dhe asaj klinike, ku kjo e fundit, qartazi, shfaq një nivel më të lartë simptomash. Diferencat rezultuan statistikisht domethënëse në të gjitha konstruktet që vlerëson instrumenti përmes nënshkallëve të tij.

Kështu, IGA i SCL-90-R për kampionin joklinik ishte ($M = 0.97$, $SD = 0.55$) ndërsa në kampionin klinik ($M = 1.62$, $SD = 0.84$). Magnituda e diferencës në mesatare ishte -0.65 (95% CI: -0.76 deri -0.55); masa e efektit d të Cohen ishte 1.01. Testi t për të dy grupet ishte domethënës: $t(708) = -12.24$, $p \leq .001$ (two-tailed). Tabela 1 tregon diferencat midis kampionit klinik dhe atij joklinik për të gjitha nënshkallët e SCL-90-R. Pavarësisht se të gjitha nënshkallët paraqesin masë efekti statistikisht domethënëse, të gjitha në nivelin $p \leq .001$, dy prej

Tabela 1. Mesataret dhe devijimet standarde për SCL-90-R në kampionin klinik dhe atë joklinik

		joklinik		klinik		ES	t-test	
		n≈501		n≈209			df≈708	
		m	S	M	s	d	T	
SCL	IGA Indeksi Global i Ashpërsisë	.97	.55	1.62	.84	1.01	8.61	***
SCL-E	ANKTHI	.85	.69	1.83	1.05	1.20	14.53	***
SCL-D	DEPRESIONI	.97	.64	1.82	.95	1.14	13.83	***
SCL-I	PSIKOTICIZMI	.64	.56	1.39	.98	1.05	12.77	***
SCL-G	ANKTHI FOBIK	.60	.60	1.30	1.04	.93	11.24	***
SCL-C	NDJESHMËRIA NDËRPERSONALE	1.03	.64	1.62	.93	.81	9.80	***
SCL-J	POHIME PLOTËSUESE	1.07	.70	1.68	.94	.78	9.48	***
SCL-A	SOMATIZIMI	1.02	.74	1.64	.97	.76	9.28	***
SCL-B	OBSESION-KOMPULSION	1.32	.68	1.79	.94	.61	7.46	***
SCL-F	HOSTILITETI	.99	.76	1.35	1.10	.41	4.96	***
SCL-H	IDEACIONI PARANOID	1.27	.76	1.56	1.05	.34	4.08	***

*** $p \leq .001$, one-sided

Tabela 2. Pohimet e SCL-90-R për shkallën e Hostilitetit në kampionin klinik dhe atë joklinik

		joklinik		klinik		ES	t-test	
		n≈501		n≈209			df≈708	
		m	s	m	s	d	t	
SCL-F	HOSTILITETI	.99	.76	1.35	1.10	.41	4.96	***
SCL63	Impuls i brendshëm për të goditur, dëmtuar, ose lënduar ndonjë njeri	.47	.88	.90	1.34	.41	5.00	***
SCL81	Të bërtitura ose flakje objektesh	.59	1.00	1.04	1.39	.39	4.78	***
SCL67	Shtysa për të thyer ose përplasur gjëra	.61	1.02	.98	1.37	.32	3.87	***
SCL11	Acarim ose irritim i menjëhershëm	1.73	1.28	2.11	1.36	.29	3.48	***
SCL24	Shpërthime inati dhe kokëfortësie, të cilat nuk mund t'i kontrollosh	1.53	1.30	1.84	1.47	.23	2.79	**
SCL74	Zihesh shpesh (me fjalë) me njerëzit	1.01	1.15	1.19	1.33	.15	1.85	*

*p ≤ .05, ** p ≤ .01, *** p ≤ .001, one-sided

nënshkallëve shfaqin masë efekti ndjeshëm më të ulët krahasimisht me të tjerat.

Përkatësisht, nënshkalla e Ideacionit Paranoid dhe ajo e Hostilitetit paraqesin diferencat më të ulëta midis kampionit klinik dhe joklinik, duke sugjeruar që ideacioni paranoid dhe hostiliteti/agresiviteti përfaqësojnë konstrukte të hasura shpesh në popullatën e përgjithshme.

Të dhënat e tableës 2 paraqesin dallimin e mesatareve midis kampionit klinik dhe joklinik për secilin pohim të nënshkallës së Hostilitetit. Të gjitha pohimet në këtë nënshkallë paraqesin masë efekti që varion nga e ulët në të moderuar. Pohimet 63 “Impuls i brendshëm për të goditur, dëmtuar, ose lënduar ndonjë njeri” shfaqin masën e efektit më të lartë, pasuar nga pohimi 81 “Të bërtitura ose flakje objektesh”, dhe 67 “Shtysa për të thyer ose përplasur gjëra”. Këto pohime evidentojnë sjellje që janë më pak të hasura në popullatën e përgjithshme, ndryshe nga pohimet 11, 24 dhe 74. Këto të fundit sugjerojnë se irritueshmëria, shpërthimet e inatit dhe sherret e shpeshta janë tepër të pranishme në popullatën e përgjithshme, me dallim shumë të ulët nga popullata klinike.

Krahasimi i pikëve mesatare midis

kampionëve paraqet një tablo edhe më interesante në rastin e Ideacionit Paranoid (Tabela 3). Midis 10 dimensioneve të SCL-90-R, ky dimension paraqiti diferencat më të ulëta midis kampionit klinik dhe atij joklinik. Diferencat për të gjitha pohimet në këtë shkallë varionin nga të ulëta në shumë të ulëta dhe ishin statistikisht domethënëse. Kjo sugjeron që popullata e përgjithshme ka raportuar pikë shumë të larta në të gjitha pohimet e kësaj shkalle.

Pohimi me diferencën më të lartë midis popullatave ishte pohimi 08 “*Ndjenja që të tjerët janë përgjegjës për problemet e mia*”, pasuar nga 43 “*Ndjesia se të tjerët të vëzhgojnë, ose flasin për ty*” dhe 68 “*Mendime, ose besime, të cilat të tjerët nuk i besojnë*”. Edhe pse këto pohime shfaqën diferencat më të larta në mesatare, vlerat mbeten të ulëta. Pohimet 83 “*Ndjesia se të tjerët do të të shfrytëzojnë nëse ti i lejon*” dhe 76 “*Të tjerët i vlerësojnë shumë pak arritjet e tua*” shfaqën masën më të ulët të efektit.

Surprizues ishte rezultati për pohimin 18 “*Ndjenja se shumicës së njerëzve nuk mund ti besoj*”. Ndryshe nga çdo pohim tjetër në shkallë globale, ky është i vetmi pohim ku popullata joklinike raportoi vlera më të larta se kampioni klinik (d = -.20; domethënia statistikore p ≤ .01.)

Tabela 3. *Pohimet e SCL-90-R për shkallën e Ideacionit Paranoid në kampionin klinik dhe atë joklinik*

		joklinik		klinik		ES	t-test	
		n≈501		n≈209			df≈708	
		m	s	m	S	d	t	
SCL-H	IDEACIONI PARANOID	1.27	.76	1.56	1.05	.34	4.08	***
SCL08	Ndjësia se të tjerët janë përgjegjës për shumicën e problemeve të tua	1.19	1.25	1.74	1.56	.40	4.92	***
SCL43	Ndjësia se të tjerët të vëzhgojnë, ose flasin për ty	1.14	1.19	1.61	1.46	.37	4.54	***
SCL68	Mendime, ose besime, të cilat të tjerët nuk i besojnë	.92	1.06	1.33	1.42	.35	4.26	***
SCL83	Ndjësia se të tjerët do të të shfrytëzojnë nëse ti i lejon	.92	1.12	1.19	1.38	.22	2.72	**
SCL76	Të tjerët i vlerësojnë shumë pak arritjet e tua	1.27	1.16	1.54	1.33	.22	2.70	**
SCL18	Ndjësia se shumicës së njerëzve nuk u zihet besë	2.17	1.29	1.91	1.48	-.20	-2.37	**

** p ≤ .01, *** p ≤ .001, one-sided

Diskutime

Asnjë shoqëri, asnjë kulturë nuk është statike; ato reflektojnë dinamikat sociale, politike dhe historike përmes vlerave shoqërore, modeleve të ndërveprimit, modeleve të qasjes ndaj problemeve, marrëdhëniet me institucionet shoqërore, si edhe përmes simptomave dhe modeleve dominuese të psikopatologjisë. Manuali Diagnostikues dhe Statistikor për Sëmundjet Mendore -5 (DSM-5), tashmë përcakton qartë se psikopatologjia përcaktohet dhe formësohet *gjithmonë* në raport me kulturën (American Psychiatric Association, 2013, fq. 758). Kështu, sjelljet dhe problemet shoqërore duhen parë dhe kuptuar gjithmonë nën dritën e tipareve kulturore, dinamikave sociale, politike dhe ekonomike.

Prej vitesh shoqëria Shqiptare manifeston nivele shqetësuese agresiviteti në të gjitha nivelet agresiviteti i cila raportohet në media masivisht, por edhe në raportimet vjetore në nivel kombëtar ndër vite (Data Centrum Research Institute, 2014; Children's Human Rights Centre of Albania [CRCA], 2007; Instat, 2018). Po ashtu, në mënyrë më të tërthortë, reflektohet niveli

i lartë i mosbesimit të gjerë shoqëror, i cili manifestohet kryesisht në mosbesimin ndaj institucioneve shtetërore dhe shoqërore: mosbesim ndaj institucioneve të drejtësisë, shëndetësisë, arsimit, etj. (Acer, 2017; Transparency International [TI], 2020). Këto dinamika agresiviteti dhe mosbesimi, të cilat shkojnë krahas krahas duke ushqyer njëra-tjetrën, duhen kuptuar në mënyrë sistematike, si manifestime *simptomatike* të vuajtjes shoqërore dhe traumave kolektive historike.

Historia e trazuar sociale dhe politike e shoqërisë Shqiptare e ka ekspozuar shoqërinë Shqiptare ndaj një sërë sfidash të lidhura me tranzicione të vazhdueshme që kanë shkaktuar ndryshime sociale të menjëhershme dhe nevojë për t'u përshtatur me vlera shoqërore të lidhura me sistemet politike dhe ekonomike specifike (Bardhoshi, 2010).

Ky studim tregon se në gamën e sjelljeve patologjike, konstrukti i mosbesimit dhe hostilitetit domimojnë mbi të tjerët dhe karakterizojnë në një shkallë të gjerë sjelljen shoqërore në popullatën e përgjithshme Shqiptare.

Gjetjet sugjerojnë se ndjenja e mosbesimit është tipar tepër i pranishëm

në popullatën Shqiptare. Në këtë plan, mosbesimi mund të kuptohet si një reagim i përshtatur, i përgjithësuar që vjen si rezultat i një historie të gjatë diktature dhe tipareve paranoide të induktuara gjatë saj. Ndryshe nga popullata e përgjithshme, në popullatën klinike, mosbesimi paranoid nuk është i përgjithësuar, por është i organizuar rreth një objekti specifik mosbesimi.

Këto gjetje korrespondojnë me supozimin se historia social-politike e Shqipërisë gjatë komunizmit dhe viteve pas ndërrimit të sistemeve ka inkurajuar zhvillimin e vlerave të mosbesimit, të izolimit ndërgrupor dhe agresivitetit të shtuar (Amnesty International [AI], 2013; Lubonja, 2001; Nixon, 2009).

Hostiliteti dhe agresiviteti i lartë në popullatën Shqiptare, po ashtu, mund të shpjegohet, të paktën pjesërisht, përmes dinamikave shoqërore karakterizuese të sistemit komunist dhe të viteve të tranzicionit të sistemeve. Tensioni ndërgrupor i ushqyer përgjatë komunizmit përmes trajtës së qëndrimeve negative ndaj grupeve të caktuara shoqërore (të deklasuarit) dhe rajoneve të ndryshme gjeografike, u riaktivizuan në periudhën e ndërrimit të sistemeve nën ndikimin e problemeve shoqërore të shkaktuara nga migrimi i brendshëm

i pakontrolluar (Kaser, 2000; Morozzo della Rocca, 1998). Pasiguria ekonomike (Morozzo della Rocca, 1998), përplasia e vlerore midis subkulturave, marginalizimi i disa nëngrupeve përkundrejt të tjerave (Voell, 2012), kalimi nga një sistem kontrolli absolut në një sitsem liberalizimimi neglizhent, destabiliteti politik dhe pasiguria pasuese (de Waal, 2005), ngjarjet e njëpasnjëshme traumatike që përjetoi shoqëria Shqiptare gjatë tranzicionit, përfaqësojnë vetëm disa nga faktorët kulturorë, politikë, social dhe ekonomikë, të cilat i japin kuptim nivelit të lartë të frustrimit dhe agresivitetit të shtuar në shoqërinë Shqiptare.

Së fundmi, duhet thënë se shoqëritë në zhvillim mund të analizohen sipas aftësisë së tyre për rikonstruksion shoqëror, që i referohet aftësisë së tyre për të ndërtuar institucione dhe vlera shoqërore, si dhe modele ndërveprimi funksionale në përputhje me kontekstet e reja dhe nevojat e komunitetit (Ajdukovic, 2004). Por sipas Fletcher dhe Weinstein (2002), rikonstruksioni social i shoqërive të traumatizuara bëhet i mundur vetëm kur shoqëria është e aftë të prodhojë besim, drejtësi, demokraci, progres ekonomik dhe paqe me të shkUARËN. Në këtë drejtim, Shqipëria ka ende shumë rrugë për të bërë.

REFERENCAT

- Ajdukovic, D. (2004). Social contexts of trauma and healing. *Medicine, Conflict and Survival*, (20)2, 120-135.
- Albanian Center for Economic Research (2017). Ethics in the Albanian Education System. Study Report. ACER
- American Psychiatric Association. (2013). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders* (5th ed.). American Psychiatric Publishing.
- Amnesty International (2013). *Albania – Amnesty International Report 2012*. <http://www.amnesty.org/en/region/albania/report-2013>
- Amy, L. E., & Gjermani, E. (2013). Where is the 'State' in Albania? The unresolved contradictions confronting civil society in the 'transition'
- Bardhoshi, N. (2010). *Për një antropologji të modernitetit Shqiptar* [For an anthropology of the Albanian modernity]. *Polis*, 9, 77-88.
- Bardhoshi, N. (2012). Family property in Albanian customary law. In A. Hemming, G. Kera, & E. Pandejmoni (Eds.), *Albania: Family, society and culture in the 20th century* (pp. 67-78). Berlin: Lit Verlag.
- Bodinaku, B. (2014). *Translation, validation and*

- standardization of the Albanian version of the SCL-90-R (Symptom Checklist-90 -Revised) and CORE-OM (Clinical Outcomes in Routine Evaluations – Outcome Measure)*. Unpublished doctoral dissertation [Attached in Supplemental online material]. Sigmund Freud Private University, Vienna.
- Children's Human Rights Centre of Albania (2007). *Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri: Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri*. [Juvenile criminality in Albania: An analysis of factors of juvenile criminality]. Tiranë: Author.
- Clarke, S., & Hoggett, P. (2004). The empire of fear: The American political psyche and the culture of paranoia. *Psychodynamic Practice*, (10)1, 89-106.
- Data Centrum Research Institute (2014). *Raport i studimit bazë mbi dhunën në familje dhe policinë e Shtetit Shqiptar*. [Report on the basic study on domestic violence and State Police of Albania]. Tiranë: Author
- Derogatis, L. R. (1994). *SCL-90-R Administration, Scoring and Procedures Manual*, (3rd ed.). Minneapolis: Pearson, Inc.
- De Waal, C. (2005). *Albania today: A portrait of a post-communist turbulence*. I. B. Tauris.
- Doja, A. (2010). Fertility trends, marriage patterns, and savant typologies in the Albanian context. *Journal of Family History*, 35(4), 346-367.
- Doll, B. (2010). The relationship between the clan system and other institutions in the Northern Albania. *Southeast European and Black Sea Studies*, (3)2, 147-162.
- Fletcher, L. E., & Weinstein, H. (2002). Violence and social repair: Rethinking the contribution of justice to reconciliation. *Human Rights Quarterly*, 24, 573-639.
- Glassner, B. (1999). *The culture of fear: Why Americans are afraid of the wrong things*. New York: Basic Books.
- Horowitz, I. L. (1993). The politics of the physiological psychology Ivan Pavlov's suppressed defense of scientific freedom and its consequences. *Integrative Physiological and Behavioral Science*, 28(2), 137-142.
- Kalemaj, I. (2016). Albania's democracy challenges: External stimuli and internal factors at play. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 5(3), 107 – 112.
- Kaser, K. (2000). The history of the family in Albania in the 20th century: A first profile. *Ethnologia Balkanica*, 4, 45-57.
- Kovaci, K. (2014). Democracy in Albania: Shortcomings of Civil Society in Democratization due to the Communist Regime's Legacy. *Undergraduate Journal of Global Citizenship*, 2(1), 1-30.
- Littlewood, R. (2002). Trauma and Kanun: Tëo responses to loss in Albania and Kosova. *International Journal of Social Psychiatry*, (48)2, 86-96.
- Lubonja, F. (2001). Privacy in a totalitarian regime. *Social Research*, 68(1), 237-254.
- McNally, R. J. (2008). Panic and posttraumatic stress disorder: Implications for culture, risk and treatment. *Cognitive Behavior Therapy*, (37)2, 131-134.
- Morozzo della Rocca, R. (1998). Socio-cultural aspects of the Albanian crisis. *The International Spectator*, 33(2), 69-78.
- Muşo, M. (1998). The Albanian economy after the storm: Prospects for rehabilitation and recovery. *The International Spectator*, 33(2), 105-116.
- Musaraj, S. (2012). Alternative publics: Reflections on marginal collective practices in communist Albania. In A. Hemming, G. Kera, & E. Pandejmonji (Eds.), *Albania: Family, society and culture in the 20th century* (pp. 175-186). Lit Verlag.
- National Institute of Statistics (2018). Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018. Instat
- Nixon, N. (2009). You can't eat shame with bread': Gender and collective shame in Albanian society. *Southeast European and Black Sea Studies*, 9(1-2), 105-121.
- Pettifer, J. (1996). Polling towards a one-party state. *World Today*, 52(7), 180-181.
- Pick, T. M. (1999). A note on a relationship between personal and societal problems. *Psychiatry*, 62(3), 196-208.

- Pikhart, H., Bobak, M., Pajak, A., Malyutina, S., Kubinova, R., Topor, R., Sebakova, H., Nikitin, Y., Marmot, M. (2004). Psychosocial factors at work and depression in three countries of Central and Eastern Europe. *Social Science and Medicine*, 58(8), 1475-1482.
- Pinquart, M., & Silbereisen, R. K. (2004). Human development in times of social change: Theoretical considerations and research needs. *International Journal of Behavioral Development*, 28(4), 289-298.
- Raikhel, E., & Bemme, D. (2016). Postsocialism, the psy-ences and mental health. *Transcultural Psychiatry*, 53(2), 151-175.
- Rosenberg, D., Kozlov, V., & Ibman, A. (2018). Political regimes, income and health: Evidence from sub-national comparative method. *Social Science Research*, 2 (72), 20-37.
- Salavec, G., Chandola, T., Pikhart, H., Dragano, N., Siegrist, J., Jöckel, K- H., Erbel, R., Pajak, A., Malyutina, S., Kubinova, R., Marmot, M., Bobak, M., Kopp, M. (2000). Work stress and health in Western European and post-communist countries: an East-West comparison study. *Journal of Epidemiological Community Health*, 64(1), 57-62. <https://doi.org/10.1136/jech.2008.075978>
- Schmidt, F. (1998). Upheaval in Albania. *Current History*, 97(617), 127-131.
- Thomas, N. K. (2011). On turning a blind eye and a deaf ear: Society's response to the use of torture. *International Journal of Group Psychotherapy*, (61)1, 7-25.
- Tirta, M. (2003). *Etnologjia e Shqiptarëve*. [The ethnology of Albanians]. Tiranë: Geer
- Transparency International (2020). Corruption Perception Index 2019. https://www.transparency.org/files/content/pages/2019_CPI_Report_EN.pdf
- Verdery, K. (1996). *What was socialism and what comes next*. Princeton University Press.
- Voell, S. (2012). "The smiling daughters". Traditional clan structures and customary law in post-socialist Albania. In A. Hemming, G. Kera, & E. Pandejmoni (Eds.) *Albania: Family, society and culture in the 20th century* (pp. 146-162). Lit Verlag.
- Young, A. (2000). *Women who become men: Albania's sworn virgins*. Oxford: Berg

ABSTRACT

Ky artikull eksploron tipare të hostilitetit dhe ideacionit paranoid të pranishme në shoqërinë Shqiptare, duke përdorur të dhëna të standardizuara për popullatën Shqiptare dhe të mbledhura përmes administrimit të variantit shqip të SCL-90-R. SCL-90-R u administrua në një popullatë përfaqësuese në Tiranë ($N = 501$) dhe në popullatë të qëllimshme klinike ($N = 209$). Përmes analizave statistikore u krahasuan vlerat midis kampionëve në nivel global, në nivel nënshkallësh dhe nivel pohimesh, duke evidentuar nivelin *normal* të simptomatologjisë në nivel popullate të përgjithshme. Të dhënat evidentuan diferenca të pritshme midis vlerave të raportuara nga popullata e përgjithshme dhe ajo klinike, ku padyshim popullata klinike shfaq vlera më të larta në të gjitha konstruktet psikologjike. Konstrukt i hostilitetit dhe mendimit paranoid shfaqën diferencat më të ulëta midis popullatave dhe në disa raste në nivel shumë të krahasueshem. Hostiliteti dhe ideacioni paranoid janë tipare gjithmonë e më të dukshme në shoqërinë Shqiptare dhe që manifestohen në formën e sjelljes agresive dhe mosbesimit në të gjitha trajtat dhe nivelet në jetën shoqërore dhe ndërveprimet personale. Të dy këto konstrukte ushqejnë njëra tjetrën, por edhe një sërë problemesh të tjera sociale të pranishme në shoqërinë Shqiptare. Megjithatë, si hostiliteti i shtuar, ashtu edhe ideacioni paranoid, më tepër se problem në vetvete, duhen kuptuar si manifestime simptomatike të dinamikave traumatike dhe të trashëguara në mënyrë ndërbreznore në kulturën dhe shoqërinë Shqiptare.

Keywords: *SCL-90-R, hostilitet, ideacion paranoid, agresivitet, mosbesim, tranzicion*

IMPAKTI SHUMËDIMENSIONAL I DIABETIT TE FËMIJËT E PREKUR, FAMILJARËT E TYRE, SISTEMI SHËNDETËSOR DHE SHOQËRIA

Laurant KOLLAÇAKU

*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, Shqipëri
Njësia e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë
Departamenti i Pediatriisë
E-mail: ledianrusta@gmail.com*

Sonila TOMORRI

*Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, Shqipëri
Njësia e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë
Departamenti i Pediatriisë
E-mail: sonila.tomori@gmail.com*

PËRMBLEDHJE

Diabeti mellitus tip 1 (DMT1) përfaqëson një sëmundje që ka një impakt shumë dimensional tek fëmija i prekur, familjarët e tij, sistemin shëndetësor dhe gjithë shoqërinë, duke përfshirë pasojat në cilësinë e jetës, pasojat sociale dhe ekonomike. Shoqërimi i DMT1 me një sërë komplikacionesh e bën edhe më të rëndësishme marrjen e masave për parandalimin dhe menaxhimin e përshtatshëm të kësaj sëmundjeje. Rritja e shpeshtësisë së DMT1 në të gjithë botën ka vënë në alarm sistemet shëndetësore të cdo vendi. Në Shqipëri të dhënat lidhur me epidemiologjinë e DMT1 në moshën pediatrike janë të pakta. Në këtë kuadër ne ndërmorëm një studim që përfshiu të gjithë pacientët pediatrikë të diagnostikuar në mënyrë definitive me DMT1 pranë Shërbimit tonë gjatë periudhës 2010-2014. Në total 152 fëmijë të moshës 0-14 vjeç u diagnostikuan me DMT1 gjatë kësaj periudhe dhe u përfshinë në studim. Të gjithë fëmijët u ekzaminuan në momentin e paraqitjes në shërbimin tonë dhe më pas u ndoqën për një periudhë deri në 5 vjet pas vendosjes së diagnozës për disa parametra laboratorikë kryesorë. Rezultatet e studimit sugjeruan se moshja mesatare e fëmijëve me DMT1 është 8.3 vjeç, tre të katërtat jetojnë në zonat urbane dhe rreth 61% diagnostikohen gjatë vjeshtës dhe dimrit. Koha mesatare e diagnozës së DMT1 është rreth 23 ditë, nga fillimi i simptomave, me

një variacion të madh nga 0 ditë në 90 ditë. Niveli i vdekshmërisë nga KAD midis fëmijëve me DMT1 në studimin tonë është 2.9%. Bazuar në gjetjet e këtij studimi, rekomandohet që të ndërmerren fushata ndërgjegjësuere për prindërit në mënyrë që ata t'i njohin shpejt dhe drejt shenjat dhe simptomat e KAD.

Fjalët kyçe: diabet mellitus tip 1, fëmijë, adoleshentë, epidemiologjia, efekte psikologjike

Laurant Kollcaku është specializuar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë në Departamentin e Shërbimit të Specialitetit Pediatrik, Njësia e Endokrinologjisë dhe Diabetologjisë me specializim pediatër dhe subspecialitet në Endokrinologji dhe Diabetologji. Kandidat për Doktor i Shkencave Mjekësore. Ai jep kontributin e tij si pediatër në departamentin e endokrinologjisë në QSUT dhe në të njëjtën kohë pedagog me kohë të pjesshme. Ka marrë pjesë në konferenca të shumta dhe të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka kryer disa studime në këtë fushë me interes.


Sonila Tomorri - Psikiatër për Fëmijë e Adoloshentë me eksperiencë 17 vjeçare në fushën e Shëndetit Mendor. Fusha e interesit të saj ka të bëjë me psikosomatikën, puna me fëmijët me diagnoza komorbide, sëmundjet e neurozhvillimit dhe specifikat e shëndetit mendor të adoleshencës. Doktor i Shkencave Mjekësore që prej 2015, me interes në studime kërkimore mbi sëmundjet gjenetike të rralla. Pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë dhe konsulente pranë Shërbimit të Pediatrisë në QSNUT. Themeluese e Medical Institute of Albania dhe Anëtare e Shoqatës Shqipëtare të Pediatrisë, Shoqatës Shqipëtare të Psikiatrisë

Diabeti mellitus (DM) është një çrregullim metabolik kompleks me etiologji të shumtë i cili karakterizohet nga hiperglicemia kronike me çrregullim të metabolizmit të karbohidrateve, yndyrnave dhe proteinave si rezultat i difekteve në sekretimin e insulinës, veprimin të insulinës ose të dyja (World Health Organization, 1999).

Diabeti mellitus tipi 1 (DMT1) është sëmundja endokrine dhe metabolike kronike më e zakonshme në fëmijët dhe adoleshentët (American Diabetes Association 2015) i cili ndodh për shkak të deficitit asolut të insulinës nga shkatërrimi autoimun i qelizave beta insulin prodhuese në ishujt e Langerhansit në pankreas, në personat gjenetikisht të predispozuar me ndërmjetësi autoimmune, duke rezultuar në deficit progresiv të insulinës (American Diabetes Association 2001; Gale, 2001; Atkinson dhe Maclaren, 1994), si rezultat i ndërveprimit kompleks i faktorëve gjenetik dhe imunologjik të nxitura nga faktorë mjedisorë të shumtë (Bluestone, Herold dhe Eisenbarth, 2010). DMT1 është një sëmundje autoimmune me komponent të fortë gjenetik (Noble dhe Erlich, 2012;

Steck dhe Rewers , 2011). Pavarësisht shpeshtësisë së rritur e diabetit tip 2, DMT1 përfaqëson 5-15% e diabetikëve dhe mbetet tipi më i zakonshëm i diabetit në fëmijët ≤ 19 vjeç duke përbërë rreth dy të tretat e rasteve të reja të diabetit megjithëse një e katërta e rasteve diagnostikohen në moshën adulte (Lipton et al., 2005; Duncan, 2006; SEARCH for Diabetes in Youth Study Group et al., 2006). Proçesi i shkatërrimit karakterizohet nga një periudhë e gjatë latente, progresiv prej shumë muajsh ose vitesh gjatë së cilës fëmija është asimptomatik dhe normoglicemik. Si rrjedhojë, markuesit gjenetik të diabetit tip 1 janë të pranishëm në lindje, markuesit imunologjik janë të identifikueshëm ose të matshëm pas fillimit të proçesit autoimun ndërsa markuesit metabolik shfaqen pas dëmtimit të shprehur i qelizave beta dhe para se të shfaqet hiperglicemia simptomatike (McCulloch dhe Palmer, 1991). Periudha e gjatë latente është reflektim se nga fillimi i procesit autoimun deri sa të shfaqet hiperglicemia duhet të dëmtohet një numër i madh qeliza beta funksionale (figura).

Markuesit gjenetikë janë të pranishëm

Figura: Periudha e zhvillimit të diabetit tip 1

që nga lindja, markuesit imunë fillimisht shfaqen në kohën e ngjarjeve nxitëse të mjedisit dhe markuesit metabolik të deficitit të sekretimit të insulinës shfaqen menjëherë pas fillimit të disfunkcionit të qelizave beta. Megjithatë, manifestimet klinike të diabetit tip 1 vetëm pasi të jetë dëmtuar një masë e madhe e qelizave beta funksionale

Studimet e vjetra epidemiologjike të incidencës përcaktojnë 'fillimin e diabetit tip 1 'datën e injektimit për herë të parë të insulinës' për shkak se fillimi i simptomave dhe diagnostikimi ndodh në kohë të ndryshme (Diamond Project Group, 2006).

Klasifikimi i diabetit mellitus

Deri në 1970 kujdesi dhe trajtimi i diabetit në fëmijët bëhej nga mjekët internist, pediatër, nefrologë dhe mjekët e përgjithshëm (Rosenbloom dhe Ongley, 1974). Pas viteve 1970 konsultimi i fëmijëve 0-15 vjeç me diabet bëheshin nga internistët, mjekët e përgjithshëm dhe pediatrit e përgjithshëm. Gjatë kësaj periudhe endokrinologët pediatër ishin të pakët dhe shumica e tyre nuk e konsideronin

diabetin si çrregullim endokrin (Wilkins, 1965). Nga 1993, vizitat e pacientëve diabetik 0-21 vjeç në 35% e rasteve kryeshin nga endokrinologët pediatër (pothuajse ½ e tyre kryeshin në shërbim privat); 37% nga internistët (kryesisht adoleshent dhe adult) dhe 28% nga pediatrit e përgjithshëm. Në praktikën e endokrinologjisë pediatrike, diabeti bërbën 50-60% të ngarkesës së punës (Rosenbloom et al., 1998).

Lëvizja e diabetologjisë në drejtim të endokrinologjisë pediatrike ka arsye të shumta përtej rëndësisë klinike të patologjisë përfshi mundësinë rreth kërkimeve të diabetit dhe funksionimit të tij, fiziologjisë endokrine që prek diabetin, përfshirja e diabetit në kërkesat e akreditimit të programeve të trajnimit dhe certifikimit të bordit për endokrinologji pediatrike. Kjo histori meriton konsideratë dhe reflektim sepse endokrinologët pediatër janë aktualisht të angazhuar në një revolucion të krahasueshëm në atë që konsiderohet të jetë brenda sferës së endokrinologjisë pediatrike.

Epidemia bashkëkohore e diabetit tip 2 (DMT2) në moshat e reja i ka ngarkuar endokrinologët pediatër me një përgjegjësi

të madhe për një patologji e cila më parë ka qënë e rrallë në grup moshën pediatrike. Për më tepër, endokrinologët pediater u duhej të rishqyrtonin probleme lidhur me obezitetin i cili ka qënë prej kohësh një arsye e shpeshhtë për referim në klinikat endokrine, por trajtoheshin rrallë pasi përjashtoheshin sindromat jot ë zakonshme ose shkaqe mjeksore.

Kjo epidemi obeziteti ka pasur endocrinologët pediater të cilët merreshin me sëmundshmëri të ndryshme shoqëruese të insulinorezistencës që dikur ishin domen ekskluziv i mjekëve që trajtonin adultë. Ashtu sic bënë më parë për DMT1, endokrinologët pediater u përfshinë në ekipin e zhvillimit të merren me këtë të sfidë klinike të vështirë dhe në rritje të obezitetit dhe DMT2.

Tipi i diabetit që i vendoset një personi në diagnozë për herë të parë zakonisht bazohet në karakteristikat në prezantim, megjithatë, gjithnjë e më shumë aftësia për të bërë një diagnozë klinike vështirësohet nga faktorë përfshi prevalencën në rritje e mbipeshës në të rinjtë me diabet tip 1 (Minges, Whittemore dhe Grey M, 2013; da Costa VM, et al., 2016) dhe prania e ketoacidozës diabetike (KAD) në disa prej të rinjve me diagnozë diabet tip 2 (Raghupathy, 2015; American Diabetes Association, 2017a)

Përveç kësaj, shfaqja e një formë familjare të diabetit të lehtë gjatë adoleshencës lindi dyshimin e diabetit monogenik, i cili është përgjegjëse për 1-4% e rasteve pediatrike të diabetit (Winter, 2000; Reardon et al., 1992; van den Ouwenland et al., 1992; Kadowaki et al., 1994).

Aktualisht klasifikimi i diabetit mellitus bazohet në etiopatogjenezën (etiologjinë dhe fiziopatologjinë) në 4 kategori klinike të dallueshme: diabeti tip 1, diabeti tip 2, diabet nga shkaqe specifike dhe diabet gestacional (Tabela 1).

Në 1997, Komiteti i Ekspertëve për Diagnozën dhe Klasifikimin e Diabetit e klasifikoi diabetin melitus bazuar mbi moshën e fillimit (diabet juvenil dhe adult)

[Report of the Expert Committee on the Diagnosis and Classification of Diabetes Mellitus, 1997] ndërsa në vitin 1999, ekspertët e Shoqatës Amerikane të Diabetit (ADA) e modifikuan klasifikimin duke u bazuar në fiziopatologjinë e tipeve të ndryshme të diabetit (American Diabetes Association, 2005).

Klasifikimi i diabetit melitus sipas ADA nuk pasqyron heterogjenitetin klinik të pacientëve me diabet. Koncepti i sotëm është se disfunksioni i hershëm i qelizave beta ka më shumë mundësi të jetë defekti primar në fiziopatologjinë e diabetit, pavarësisht tipit të diabetit. Klasifikimet e reja propozojnë se diabeti melitus pavarësisht shkaktuar primar sipas nevojës për insulin duhet klasifikuar si: (1) nevojë për insulinë për të mbijetuar, (2) nevojë për insulinë për të kontrolluar metabolizmin jo për të mbijetuar, (3) mungesë e nevojës për insulinë për të kontrolluar metabolizmin (trajtim me metoda jo farmakologjike por jo insulinë) [Leslie et al., 2008].

Janë propozuar skema të tjera të klasifikimit, duke marrë parasysh autoimmunitetin e qelizave beta, funksionin e qelizave beta, karakteristikat klinike dhe peshën trupore. Prevalenca e lartë e mbipeshës / obezitetit në popullatë e ka ndërlikuar më shumë sistemin e klasifikimit duke shtuar elementin e rezistencës së insulinës edhe në diabetin e tipit 1. Në të ardhmen pritet që nëntipe të tjera të tipit 1 (dhe diabetit të tipit 2) të përcaktohen më qartë.

Karakteristikat klinike të diabetit melitus tip 1

Manifestimi klinik i diabetit mund të ndryshojë nga pacienti në pacient, sipas tipit të diabetit dhe moshës së fillimit. Simptomat klasike e prezantimit të diabetit tip 1 për herë të parë në fëmijët janë poliuria, polidipsia, polifagia dhe humbja e peshës. Në përgjithësi, pacientët kanë një histori paraprirëse incidioze relativisht të shkurtër

nga kontrolli anormal i glukozës deri në zhvillimin e simptomave klinike të diabetit. Ri-shfaqja e urinimit në shtrat, nokturia dhe nevoja për të dalë nga klasa gjatë orës së mësimi në shkollë për të përdorur tualetin janë ankesa që sugjerojnë poliurinë.

Një tjetër prezantim tipik për fëmijët që kanë diabet melitus tip 1 është përkeqësimi metabolik në ketoacidozë diabetike (KAD). Ketoacidoza është prezantimi i dytë i shpeshtë i shfaqjes së diabetit tip 1 për herë të parë në fëmijët. Në situata të caktuara diagnoza e diabetit duhet të konsiderohet në mungesë të simptomave klasike (fëmijët që prezantohen me një sëmundje febrile akute në të cilën matja e vlerës së glukozës plazmatike është pjesë e panelit biokimik është e rritur). Hiperglicemia kronike në vajzat, në foshnjat dhe fëmijët 1-3 vjeç në të dy gjinitë zakonisht manifestohen me candidiasis perineale.

Ritmi i humbjes së qelizave beta pas diagnozës është mjaft i ndryshueshëm dhe varet pjesërisht nga agresiviteti i procesit të sëmundjes së diabetit tip 1. Ky agresivitet mund të përcaktohet nga faktorë të shumtë përfshi predispozitën gjenetike primare, moshën e pacientit, kontrollin metabolik dhe mund të variojë brënda individëve gjatë ecurisë së diabetit të tyre.

DMT1 në fëmijët dhe adoleshentët mund të prezantohet në mënyra të ndryshme në pacientë të ndryshëm dhe moshë të ndryshme. Tre janë format e prezantimit të diabetit për herë të parë (Haller, Atkinson dhe Schatz, 2005):

- Prezantim klasik; polidipsi, poliuri, humbje peshe, hiperglicemi dhe ketonemi (ose ketonuri)
- Ketoacidozë diabetike
- Asimptomatik (zbulim i heshtur i rastësishëm).

Poliuria, polidipsia dhe humbja e peshës janë simptomat klasike të prezantimit të diabetit tip 1 për herë të parë në fëmijët dhe adoleshentët. Gjithashtu mjaft shpesh fëmijët mund të prezantohen me manifestimet

e KAD. Ndërsa shumë rrallë T1DM prezantohet në formën asimptomatike apo e heshtur, në mënyrë tipike në familjet që kanë histori familjare ose stafi mjekësor me shkallë të lartë dyshimi.

Megjithëse në përgjithësi, shumica e pacientëve prezantohen me simptomat klasike, ato nuk janë gjithmonë simptomat prezantuese. Pothuajse të gjithë pacientët kanë një histori incidioze paraprirëse relativisht të shkurtër; nga vlera glicemie anormale deri në zhvillimin e simptomave klinike klasike të diabetit. Shpesh fëmijët paraqiten në mjediset ambulatorre me ankesa jo specifike, dobësi të përgjithshme, pafuqi, këputje, lodhje, përgjumje, prishje e humorit nokturni, enurezis, ndërrim i shpeshtë i pelenave dhe/ose pelena jashtëzakonisht të mbushura, rash i shpeshtë nga pelenat, candidiasis perineale në vajzat dhe katarakt (Quinn et al., 2006) sidomos në fëmijët e vegjël (Quinn et al., 2006). Prandaj marrja e kujdesshme dhe e hollësishme e anamnezës është mjaft e rëndësishme në njohjen e këtyre simptomave e cila do të conte në diagnozë të hershme të diabetit tip 1. Kohëzgjatja mesatare e simptomave para prezantimit klinik është mesatarisht 10 ditë (Roche et al., 2005).

Manifestimet jo klasike/ të tjera që mund të shfaqin fëmijët me KAD janë si më poshtë (Neufeld et al., 1998; Dunger et al., 2004);

Polifagi dhe ulje oreksi. Në fillim të sëmundjes fëmijët manifestojnë oreks të shtuar (polifagi) por me theksimin e deficitit të inulinës dhe zhvillimin e ketoacidozës, oreksi ulet.

Shenja gastrointestinale. Shumë pacientë mund prezantohen me nauze, të vjella, konstipacion, dhimbje barku të cilat imitojnë apendicitin, gastroenteritin.

Shenja kardio-respiratore. Fëmijët me KAD mund të prezantohen me takikardi, hiperpne, takipne (hiperventilim dhe frymarrje Kussmaul), të cilat janë kompesime respiratore ndaj acidozës metabolike.

Hiperpnea është rezultat i rritjes së volumit në minutë (frekuencë x volumin tidal) dhe mund të rritet edhe vetëm nga volumi tidal pa rritje të frekuencës respiratore. Si rrjedhojë gjatë vlersimit të fëmijëve duhet të observohen me kujdes lëvizjet e toraksit dhe frekuenca respiratore. Në fëmijët e vegjël hiperpnea mund të manifestohet vetëm si takipne. Gjithashtu pacientët mund të manifestojnë frymarrje si erë molle të kalbur sekondare nga eliminimi i acetonit.

Shenja hipovolemie. Fëmijët me KAD në përgjithësi prezantohen me deficit të likideve 5-10%.

Shenja neurologjike. Manifestimet neurologjike variojnë nga përgjumje, letargji, alterim të nivelit të ndërgjegjes deri në koma. Manifestimet lidhen me gravitetin e hiperosmolalitetit dhe/ose me shkallën e acidozës (Edge et al., 2006).

Komplikacioni më i madh i ketoacidozës është edema cerebrale, e cila ndodh në 0.5-1% të rasteve të KAD që është edhe shkaku kryesor i vdekshmërisë. Mjekët duhet të jenë vigjilent për shënjat e hershme të edemës cerebrale dhe duhet ta trajtojnë menjëherë nëqoftëse dyshohet.

Gjendja neurologjike e rëndë në prezantim është një tregues prognostik i keq, pjesërisht sepse pacientë të tillë janë në rrisht të rritur për të zhvilluar edemë cerebrale gjatë terapisë. Fëmijët me KAD dhe edemë cerebrale ose vdesin ose mbijetojnë në një gjendje të vazhdueshme vegetative.

Qëllimi i studimit dhe metodologjia

Qëllimi i këtij studimi është të përshkruhen karakteristikat të fëmijëve të diagnostikuar me diabet mellitus tip 1 në Shërbimin e Endokrinologjisë dhe Diabetit, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUT), si e vetmja qendër terciare dhe qendër reference në Shqipëri për fëmijët dhe adoleshentët me diabet mellitus tip 1, në mënyrë që të ndricohen këto fenomene dhe të orientohen

profesionistët e kujdesit shëndetësor për vendosjen e një diagnoze sa më të hershme dhe fillimin e hershëm të trajtimit të këtyre gjendjeve shëndetësore dhe impakti shumë dimensional tek fëmija i prekur, familjarët e tij, sistemin shëndetësor dhe gjithë shoqërinë, Përvec kësaj, gjetjet e këtij studimi mund të mbështesin dhe fushatat ndërgjegjësuese midis prindërve me qëllim njohjen e shenjave të hershme të ketoacidozës diabetike.

Objektivat e studimit

- Të përcaktohen karakteristikat e përgjithshme të fëmijëve me DMT1 të përfshirë në studim.
- Të përcaktohet shpërndarja e pacientëve pediatrikë me DMT1 sipas moshës në momentin e diagnozës, gjinisë dhe vendbanimit.
- Të përcaktohet shpërndarja e pacientëve pediatrikë me DMT1 sipas sezonit të lindjes dhe sezonit të diagnozës së DMT1.
- Të përcaktohet prania e infeksioneve virale, stresit psiko-social, aplikimi i vaksinave midis fëmijëve me DMT1 të përfshirë në studim.
- Të përcaktohet koha midis shfaqjes së simptomave dhe vendosjes së diagnozës së DMT1 midis fëmijëve me DMT1 të përfshirë në studim

Në këtë studim u përfshinë 152 fëmijë me diabet mellitus tip 1 (DMT1).

Mund të vihet re se moshë mesatare e subjekteve në momentin e diagnozës është 8.3 vjet ± 3.6 vjet. Më shpesh, fëmijët me DMT1 i përkasin grup-moshës 5-9 vjet (40.1%), pasuar nga grup-moshë 10-14 vjet (39.5%) dhe ajo 0-4 vjet (20.4%). Nga ana tjetër, gati gjysma e fëmijëve me DMT1 janë meshkuj (52%) dhe pjesa tjetër janë femra (48%). Tre të kartërtat e fëmijëve me DMT1 jetojnë në zonat urbane dhe 25% në zonat rurale.

Duke u bazuar në gjetjet tona dhe diskutimin e rezultateve, konkluzionet e studimit aktual mund të përmbliidhen si vijon:

Mosha mesatare e fëmijëve të diagnostikuar për herë të parë me DMT1 është 8.3 vjec dhe tre të katërtat e fëmijëve me DMT1 banojnë në zonat urbane.

Gati dy në dhjetë fëmijë të diagnostikuar përfundimisht me DMT1, fillimisht nuk dyshohen se janë të prekur nga kjo sëmundje; kjo është një gjetje që mund të ketë implikime të rëndësishme për personelin e kujdesit shëndetësor.

Më shumë se dy në tre (67.8%) fëmijë paraqesin ketoacidozë diabetike në momentin e diagnozës së DMT1, duke nënkuptuar një mungesë të qartë të ndërgjegjësimit të familjeve dhe stafit të kujdesit shëndetësor lidhur me shenjat e hershme të këtij komplikacioni. Edhe kjo gjetje mund të ketë implikime të rëndësishme, duke patur parasysh rrezikun që paraqet prania e KAD-it në ecurinë e mëtejshme të fëmijëve me DMT1.

Rreth 1 në 5-6 fëmijë me DMT1 kanë histori familjare pozitive për DMT1 ose DMT2 kurse prevalenca e infeksioneve virale shpërthyes midis fëmijëve me DMT1 është rreth 24%.

Mesatarisht kalojnë rreth 23 ditë për të diagnostikuar diabetin mellitus tip 1 tek fëmijët e prekur nga kjo sëmundje.

Rreth 6 në 10 fëmijët me DMT1 diagnostikohen në stinën e vjeshtës dhe dimrit dhe pjesa tjetër prej 39.5% diagnostikohen me DMT1 në pranverë-verë.

Triada klasike e diabetit është e pranishme në pothuajse të gjithë fëmijët me DMT1 dhe kjo gjetje ka gjithashtu implikime të rëndësishme për familjet e fëmijëve me DMT1 dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor gjithashtu.

Pacientët pediatrikë me DMT1 mund të shfaqin një tablo të pasur klinike, ku dominojnë prania e lodhjes dhe pafuqisë në pothuajse 90% të tyre, distresi respirator, rënkimet, dispnea, përgjumja, të vjellat, etj.

Prevalenca e sëmundjeve autoimune shoqëruese tek fëmijët me DMT1 është 25.5%, në mënyrë domethënëse më e lartë tek vajzat se sa tek djemtë.

Prania e KAD shoqërohet me një kuadër klinik më të pafavorshëm krahasuar me fëmijët me DMT1 pa KAD lidhur me eneruezis nokturna, dobësinë/lodhjen, të vjellat, erës së acetonit, distresit respirator, rënkimeve, dispnesë, përgjumjes dhe konfuzionit.

Prevalenca e kandidozës orale, distresi respirator kusmaul, rënkimeve, dispnesë dhe edemës cerebrale/komës ulet me rritjen e moshës së fëmijëve me DMT1.

Mesatarisht, fëmijët me DMT1 kanë përjetuar rreth 2.7 episode glukozurie deri në momentin e diagnozës fillestare të DMT1.

Prevalenca e KAD-it është më e lartë tek vajzat.

Në përgjithësi, fëmijët me DMT1 me KAD diagnostikohen më herët sesa fëmijët me DMT1 pa KAD, ndoshta për shkak të klinikës më të shprehur të tyre.

Numri mesatar i episodeve të glukozurisë si dhe vlera mesatare e glicemisë, pH-it, HCO₃, dhe triglicerideve është më e lartë midis fëmijëve me DMT1 me KAD krahasuar me fëmijët me DMT1 pa KAD.

Prevalenca e ketonurisë është në mënyrë statistikisht domethënëse më e lartë midis fëmijëve me DMT1 me KAD krahasuar me fëmijët me DMT1 pa KAD.

Diferenca statistikisht domethënëse u evidentuan për vlerën mesatare të kreatinemisë (mosha 5-9 vjec paraqiti vlerën mesatare më të lartë), natremisë (trend linear pozitiv me rritjen e moshës) dhe C-peptidit (mosha 5-9 vjec paraqiti vlerën mesatare më të lartë).

Midis fëmijëve me DMT1 me KAD, prevalenca e KAD të rëndë rezultoi 38.6%, prevalenca e KAD të moderuar rezultoi 15.9% dhe prevalenca e KAD të lehtë rezultoi 29.5%, bazuar në pH venoz; kurse bazuar në nivelin e HCO₃ serike,

prevalencat përkatëse janë: 34.9%, 34.9% dhe 27.9%.

Gjinia femër dhe mosha 0-4 vjec janë të lidhur me rritjen domethënëse të gjasave për praninë e KAD tek fëmijët me DMT1. Po kështu, gjasat e KAD-it rriten në mënyrë domethënëse tek fëmijët me DMT1 që paraqesin enurezis nokturna, dobësi/ lodhje, të vjella, erë aceton, dhe përgjumje. Ketonuria > se 2+ i rrit shumë gjasat e KAD tek fëmijët me DMT1.

Gjasat e KAD-it rriten në mënyrë domethënëse me rritjen e numrit të episodeve të glukozurisë dhe rritjen e nivelit të glicemisë, triglicerideve; një lidhje negative u vërejt me nivelin e pH-it dhe HCO₃. Ecuria e HbA_{1c} në kohë është më e pafavorshme tek fëmijët me DMT1 me KAD krahasuar me fëmijët me DMT1 pa KAD. Niveli i vdekshmërisë nga KAD midis fëmijëve me DMT1 në studimin tonë është 2.9%.

Disa përfundime e rekomandime

Bazuar në rezultatet dhe konkluzionet e këtij punimi shkencor, ne rekomandojmë si vijon:

Diagnoza e DMT1 duhet të dyshohet gjithnjë tek fëmijët e vegjël, kur shenjat dhe simptomat klasike të diabetit janë të pranishme. Ky rekomandim merr një rëndësi edhe më të madhe në kontekstin kur incidenca e DMT1 tek moshat e vogla është në rritje. Vëmendja e shtuar ndaj diagnozës potenciale të DMT1 do të mundësonte kapjen e hershme të sëmundjes edhe në rreth 20% të fëmijëve me DMT1 ku diabeti nuk dyshohet fillimisht.

Prevalenca shumë e lartë e KAD midis fëmijëve me DMT1 sugjeron nevojën për ndërjegjësimin e familjes lidhur me simptomat tipike dhe ato më pak të zakonshme të DMT1 tek fëmijët; diagnoza më e shpejtë mund të minimizojë rrezikun e zhvillimit të ketoacidozës dhe komplikacioneve të lidhura me të.

Prania tek fëmijët e shenjave dhe/ose simptomave të tilla si lodhja/dobësia, distresi respirator, rënkimet, dispnea, përgjumja, dhe/ose të vjellat duhet të shërbejë si një sinjal alarmi për profesionistët e kujdesit shëndetësor në drejtim të përfshirjes së DMT1 në listën e diagnozave potenciale tek këta fëmijë; dështimi për ta bërë këtë mund të vonojë diagnozën e DMT1 dhe të rrisë rrezikun e zhvillimit të ketoacidozës diabetike.

Prania e eneruezis nokturna, dobësisë/ lodhjes, të vjellave, erës së acetonit, distresit respirator, rënkimeve, dispnesë, përgjumjes dhe konfuzionit duhet të zgjojë vëmendjen e profesionistëve të kujdesit shëndetësor lidhur me praninë potenciale të KAD-it në terrenin e fëmijëve të prekur nga DMT1.

Profesionistët e kujdesit shëndetësor duhet të kenë parasysh faktin që ketoacidoza diabetike ka më shumë gjasa të shfaqet tek vajzat sesa tek djemtë si dhe tek fëmijët 0-4 vjec krahasuar me fëmijët e moshave më të rritura.

Duke qënë se sëmundjet autoimmune shoqëruese janë një barrë shtesë për fëmijët me DMT1, atëherë është e nevojshme që këto gjendje të diagnostikohen në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme si dhe të menaxhohen ato në mënyrën e duhur, duke ofruar një mundësi për trajtimin më efektiv të këtyre pacientëve pediatrikë.

Prania e ketonurisë tek një fëmijët i moshës pediatrike duhet të tërheqë vëmendjen e personelit të kujdesit shëndetësor drejt diagnozës së DMT1, potencialisht të komplikuar me KAD; kjo mund të ndihmojë në diagnozën e hershme të DMT1, menaxhimin pasues efektiv dhe parandalimin e komplikacioneve të kësaj gjendjeje shëndetësore.

Strategjia kyce për një fushatë të suksesshme ndërjegjësimi është bashkëpunimi i ngushtë midis familjes, mësuesve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor, dhe vecanërisht të profesionistëve që punojnë në kujdesin

shëndetësor parësor duke përfshirë pediatri e familjes, etj.

Duke qënë se ecuria e parametrave laboratorikë të pacientëve me DMT1 me KAD është më e disfavourshme sesa tek fëmijët pa KAD, nevoja për zbulimin e hershëm të DMT1 dhe parandalimit të instalimit të ketoacidozës diabetike bëhet edhe më e rëndësishme.

Është e rëndësishme që të hetohen në detaje rastet e diagnozës së vonuar të DMT1, duke i'u referuar rasteve kur koha e diagnozës është mbi kohën mesatare të diagnozës; kjo do të mund të identifikonte faktorët përgjegjës për këtë diagnozë të vonuar dhe rrjedhimisht propozimin e masave për shmangien e këtij fenomeni.

Studime të tjera më të thelluar mund të ndërmerren në Shqipëri për të eksploruar

diagnozën më të shpeshtë të DMT1 gjatë stinëve të ftohta të vitit, dhe duke e lidhur potencialisht me prevalencën e infeksioneve virale, në mënyrë të ngjashme me studimet në arenën ndërkombëtare. Kjo do të shërbente për ndricimin më të mirë të faktorëve të lidhur me DMT1 tek fëmijët në vendin tonë dhe marrjen e masave përkatëse.

Bazuar në nivelin e lartë të vdekshmërisë nga KAD midis fëmijëve diabetikë në studimin tonë, rrjedh se duhet të bëhet c'është e mundur që të ulet ky nivel vdekshmërie. Midis masave që mund të merren, ndërgjegjësimi i prindërve mund të jetë një pikë kyce që mund të cojë në diagnozë të hershme dhe trajtim të përshtatshëm. Natyrisht, rritja e kapaciteteve diagnostikuese dhe trajtuese është një nevojë e padiskutueshme.

REFERENCAT

- Bakhsheshian J, Mehta VA, Liu JC. Current Diagnosis and Management of Cervical Spondylotic Myelopathy. *Global Spine J.* 2017;7(6):572-586.
- Burkhardt JK, Mannion AF, Marbacher S, et al. A comparative effectiveness study of patient-rated and radiographic outcome after 2 types of decompression with fusion for spondylotic myelopathy: anterior cervical discectomy versus corpectomy. *Neurosurg Focus.* 2013;35: E4.
- Boogaarts HD, Bartels RH. Prevalence of cervical spondylotic myelopathy. *Eur Spine J.* 2015 Apr;24 Suppl 2:139-41.
- Fehlings MG, Smith JS, Kopjar B, et al. Perioperative and delayed complications associated with the surgical treatment of cervical spondylotic myelopathy based on 302 patients from the AOSpine North America Cervical Spondylotic Myelopathy Study. *J Neurosurg Spine.* 2012; 16:425-32.
- Etheridge J, Kalantar SB. The pathophysiology and biological mechanisms of cervical spondylotic myelopathy. *Spine Surg* 2014;26:62-7.
- Kaiser MG, Haid RW, Shaffrey CI, Fehlings MG. (Eds.) *Degenerative cervical myelopathy and radiculopathy. Treatment approaches and options.* Springer. 2019.
- Kane SF, Abadie KV, Willson A. Degenerative Cervical Myelopathy: Recognition and Management. *Am Fam Physician.* 2020 Dec 15;102(12):740-750.
- Huang ZY, Wu AM, Li QL, et al. Comparison of two anterior fusion methods in two-level cervical spondylosis myelopathy: a meta-analysis. *BMJ Open.* 2014;4:e004581. Medscape.com. a. Cervical Spondylosis Differential Diagnosis. August 11, 2021. E disponueshme nw: <https://emedicine.medscape.com/article/306036-differential>.
- McCormick WE, Steinmetz MP, Benzel EC. Cervical spondylotic myelopathy: make the difficult diagnosis, then refer for surgery. *Cleve Clin J Med* 2003;70:899-904.
- New PW, Cripps RA, Bonne Lee B. Global maps of non-traumatic spinal cord injury epidemiology: towards a living data repository. *Spinal Cord.* 2014; 52:97-109.

- Nouri A, Tetreault L, Singh A, Karadimas S, Fehlings M. Degenerative cervical myelopathy: epidemiology, genetics and pathogenesis. *Spine (Phila Pa 1976)*. 2015;40: E675-93.
- Northover JR, Wild JB, Braybrooke J, Blanco J. The epidemiology of cervical spondylotic myelopathy. *Skeletal Radiology*. 2012 Dec;41(12):1543-1546.
- Yu YL, Gong WC, Xin B, et al. The comparison of therapeutic efficacy between two operative methods for the treatment of two-adjacent-level CSM. *Med Coll J Qiqihaer*. 2007;28:28213.
- Young WF. Cervical Spondylotic Myelopathy: A Common Cause of Spinal Cord Dysfunction in Older Persons. *Am Fam Physician*. 2000 Sep 1;62(5):1064-1070.
- Wu JC, Ko CC, Yen YS, Huang WC, Chen YC, Liu L, Tu TH, Lo SS, Cheng H. Epidemiology of cervical spondylotic myelopathy and its risk of causing spinal cord injury: a national cohort study. *Neurosurg Focus*. 2013;35: E10.

ABSTRACT

Type 1 diabetes mellitus (T1DM) has a multidimensional impact on the affected child, his family, the health system and society as a whole, including quality of life, social and economic consequences. The association of DMT1 with a number of complications makes it even more important to take measures for the prevention and proper management of this disease. The increasing frequency of T1DM worldwide has alerted the health systems of every country. In Albania, the information on the epidemiology of T1DM in pediatric age patients is scarce. In this context we undertook a study that included all pediatric patients definitively diagnosed with DMT1 at our Service during the 2010-2014 period. A total of 152 children aged 0-14 years were diagnosed with T1DM during this period and were included in the study. All children were examined at the time of presentation to our service and then followed for a period of up to 5 years after the diagnosis for some key laboratory parameters. The results of the study suggested that the average age of children with T1DM is 8.3 years, three-quarters live in urban areas and about 61% are diagnosed during the fall-winter seasons. The average time of diagnosis of T1DM is about 23 days, from the onset of symptoms, with a large variation from 0 days to 90 days. The DKA mortality rate among children with T1DM in our study was 2.9%. Based on the findings of this study, it is recommended to undertake awareness campaigns for parents so that they recognize quickly and correctly the signs and symptoms of DKA.

Keywords: *Albania, diabetes mellitus type 1, epidemiology, clinical picture*

ROLI I MËRGATËS NË ZHVILLIMIN E KULTURËS DHE ARTIT LETRAR SHQIPTAR

Rina RASIMI

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan, Kosovë

E-mail: rina.rasimi@uni-gjilan.net

PËRMBLEDHJE

Në korpusin e shkrimtarëve të letërsisë shqipe, që nga fillimet e shkrimit të dokumentuar të saj, me vepra në gjuhën shqipe e edhe në gjuhët e tjera, një vend të posaçëm ka zënë poetika e autorëve të cilët jetuan dhe vepruan jashtë atdheut, por ruajtën në kujtesë atdheun e tyre Shqipërinë dhe mallin për të e jetësuan në vargjet poetike që sot jetojnë jo vetëm si dëshmi historike, por edhe si vlerë estetike e letrare. Shkrimtarët mërgimtarë, të lidhur ngushtë me vendlindjen, shpërfaqnin mungesën për të, projektonin atdheun ideal në krijimet e veta, apo ironizonin e bëheshin kritikët më të ashpër të rrethanave politiko-shoqërore dhe dukurive negative që e përfshinin Shqipërinë. Ndër autorët që shkruan nga larg, por u afruan shumë me lexuesit shqiptarë janë: Naim Frashëri, Anton Zako Çajupi, Fan Noli, Faik Konica etj, por pikëvështrimi ynë qendror në këtë artikull është roli e kontributi i veprimtarisë së Arshi Pipës në zhvillimin e kulturës dhe artit letrar shqiptar. Duke dhënë një pasqyrë të shkurtër të rrethanave historike përgjatë periudhave të daljes në pah të këtij autori, pra duke njohur kontekstet jashtëletrare, do të ndalemi më gjerësisht në frymën, motivet dhe idetë që i përshkon krijimet e tij, si dhe përmes metodës analitike do të shohim individualitetin krijues të tij. Arti dhe kultura shqiptare janë të lidhur ngushtë me letërsinë e krijuar nga mërgimi, ndaj çdo interpretim për shkrimet e tyre, është nxitje e re për diskutime të mëtejshme letrare.

Fjalë kyçe: *Shkrimtarët mërgimtarë, atdheu, individualitete krijuese, Arshi Pipa*

Rina RASIMI është asistente e angazhuar në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, në fakultetin e Edukimit, për grupin e lëndëve si: Letërsia për fëmijë, Lexim dhe interpretim letrar, Shkrim akademik, Etnologji dhe letërsi popullore etj. Është kandidatë në studimet e nivelit të Doktoratës, në degën e Letërsisë, në universitetin "Hasan Prishtina", në Prishtinë.

Historiku i unifikimit të kombit shqiptar, rrugëtimi i gjatë i tij nga pushtimi shumëshekullor drejt lirisë dhe pavarësisë, migrimet e detyrueshme jashtë tokës mëmë që nga pushtimet turke e edhe të tjerat më vonë, por edhe ato nga vetë diktatura komuniste në Shqipëri, ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit dhe Kongresit të Berlinit në vitin 1878, thënë shkurt, rrethana të ndryshme socio-politike e historiko-shoqërore të një kombi të vogël që mëtonte të njihet me identitetin e vet, i dhanë letërsisë shqipe emra të shumtë që do të bënin pjesë në truallin e madh të mërgimtarëve të cilët shkruan dhe botuan në gjuhën shqipe, e edhe në gjuhë të huaja, letërsi të mirëfilltë, si me tematika e motive universale, ashtu edhe me të tjera në qendër mallin dhe dashurinë për atdheun e largët. Figura të shquara, me ndikim jo vetëm në rrethin shqiptar por edhe në vendet ku jetonin dhe vepronin, në tëhuajësimin e tyre, rigjetën veten përmes artit letrar, edhe pse fizikisht mbetën deri në fund të jetës larg atdheut si: Naim e Sami Frashëri në Stamboll, Anton Zako Çajupi në Egjipt, Martin Camaj në Gjermani, Fan Noli, Faik Konica e Arshi Pipa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj.

Shpesh leximi i artit letrar apo edhe shkrimi i tij është përdorur si arratisje nga realiteti, mburojë, dhe funksioni i tij si përjetim i kënaqësisë dhe dobisë nga leximi, del të jetë gjithaq edhe rrugëdalje për mbijetesë, fizike a metafizike, dëshmi e qartë e përdorimit të tij për projektim ëndrrash, mungesash a nostalgjish, rrugë drejt komunikimit të përhershëm me kujtesën për atdheun. Gjatë luftërave dhe përpjekjeve të popujve për çlirim e pavarësi, letërsia më shumë se letërsi, ka qenë armë për të ngritur zërin e për të zgjuar vetëdijen kombëtare për mosnënshtrim, drejt njohjes së lirisë, të të drejtave dhe emancipimit të gjithmbarshëm. Njëloj, shumë shkrimtarë të letërsisë shqipe, në mungesë të literaturës së mjaftueshme shkollore, të veprave letrare

në shqip, sepse dihet, letërsia shqipe, si e dokumentuar shfaqet vonë, me dokumentin e parë të shkruar në gjuhën shqipe “Formula e pagëzimit” e vitit 1462 dhe me librin e parë të shkruar shqip më 1555, ndonëse ka dyshime që ekzistenca e saj është shumë më e hershme, në mungesë të shkollave shqipe dhe duke e njohur shkallën e thellë të analfabetizmit në Shqipëri, nën shtypjen okupuse, me shkrime e vepra të botuara në shqip e edhe në gjuhë të tjera, letërsinë e shkruajnë edhe për shkak të misionit që i vendosin vetes: Vargjet e tyre të jenë nxitëse për bashkim e unifikim kombëtar. Qëllimi i tyre ka qenë që poezia e tyre të lexohet nga një masë e gjerë lexuesish, lexuesi shqiptar, te i cili do të zgjohet ndjenja dhe vetëdija kombëtare, dhe lexuesi i huaj, i cili do të njohë një popull me kulturë dhe traditë të pasur, që ngulmon për lirinë dhe pavarësinë e vet. Në këto shkrime, sa i janë përmbajtur letërsisë dhe ligjësi që ajo shtron? Kur letërsisë i vishet një funksion, dhe ngecet në atë domen pa mundur të shpërthejë më shumë, mirëpritur apo refuzohet? Pse Shqipëria në poezinë e Naimit është aq e bukur, aq platonike? Është empatia e thellë që krijohet për vendlindjen kur je larg, apo në glorifikimin e Shqipërisë fshihet edhe mesazhi moral e etik që atdheu duhet të çmohet? Pse poezitë atdhetare të Anton Zako Çajupit lexohen me ritëm të shpejtë e buçitës, apo ato të Fan Nolit që të thuash metaforikisht “të bëjnë gati për sulm”, ndërsa Faik Konica e zhvesh nga hierarkia e vlerave Shqipërinë për ta mbushur me satirë e kritikë? Si projektohet atdheu nga grilat e burgut dhe më vonë nga migrimi? Çfarë e karakterizon poezinë e Arshi Pipës shkruar nga një shkrimtar që është edhe më larg nga atdheu se shkrimtarët e lartpërmendur, është në burg? Secili prej tyre ka stilin dhe presedeun krijues, sado që te dy të fundit mesazhet e tyre poetike janë më të motivuara artistikisht dhe si e tillë krijimtaria e tyre shpreh fuqinë e artit, që qëndron më lart se fuqia e misionit, çfarëdo qoftë ai. Po

të gjurmosh në biografinë e secilit prej këtyre shkrimtarëve, është përpjekja dhe lufta e palodhshme e tyre për integrimin e shqiptarëve në njohjen dhe civilizimin botëror. Jeta dhe vepra e Naim Frashërit janë të lidhura ngushtë me vendlindjen. Naim Frashëri, ndër veprimtarët më të shquar të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, është shkrimtar letërsia e të cilit, është lexuar, pranuar, interpretuar e admiruar në të gjitha trevat shqiptare. Naim Frashëri shkruan letërsi për fëmijë, poezi në të cilat mundohet të përfshijë njohuri nga fusha të tjera të dijes që të mbush boshllëkun e veprave të mangëta në atë kohë, dhe letërsi për të rritur, veçanërisht te lexuesi, te i cili para njohjes dhe kuptimit të thellë të artit kërkon kuptimin e menjëhershëm, të drejtpërdrejtin, sepse, Naimi vendos që para se gjithash të jetë edukator i kombit. Pra, Naim Frashëri është shkrimtar misionar. I pajisur me kulturë e njohuri të gjerë, përpos në gjuhën shqipe shkruan edhe në persisht, arabisht e turqisht. I vetëdijshëm se rruga drejt krijimit të kombit shqiptar nuk mund të arrihet pa një popull të arsimuar, me krijimet e tij ai “ka arritur ta qojë përpara jetën arsimore, kulturore, letrare, morale, në tërësi, jetën shpirtërore të popullit shqiptar” (Qosja, 1990: 558)

Njëlloj edhe krijimtaria e Anton Zako Çajupit çmohet aq sa kontributi i tij i shumë për çështjen kombëtare. Faik Konica gjatë gjithë jetës punoi për atdheun e tij, qëndroi aktiv në reprezentimin sa më të denjë të vendit të tij si diplomat shqiptar, ndërsa krijimtaria e tij poetike, sado që nuk njuh shtrirje aq të gjerë të leximit si ajo e Naim Frashërit, për kah vlerat artistike dhe estetike që bart, bën që emri i tij të zë vend të posaçëm në letërsinë moderne shqipe dhe në letërsinë shqipe në përgjithësi. Arshi Pipa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka shfaqur interesimet dhe interpretimet e tij lidhur me veprat më të çmuara të letërsisë shqipe e botërore, duke i botuar këndvështrimet për to në gjuhë angleze,

italiane e shqipe e rol të posaçëm në shtypin shqiptar të diasporës patën edhe shkrimet e botuara në gazetën “Dielli”, “Albanica”, duke qenë njëherësh edhe redaktor i tyre, por si libri më i rëndësishëm përmbledhës, i cili poashtu kishte në qendër rrethanat socio-politike të Shqipërisë dhe Kosovës, mbetet ai me titull “Albanian Stalinsm Ideopolitical Aspects”. Krijimtaria e Arshi Pipës është e gjerë. Përveç librave politikë është marrë edhe me kritikë letrare, estetike e filozofi, ndërsa përmbledhjet e tij me poezi janë: “Lundërtarë” (1944), “Libri i burgut” (1959), “Rusha” (1966), “Meridiana”, 1969. Në secilën prej këtyre përmbledhjeve, prej të cilave disa janë shkruar gjatë periudhës së burgimit në sistemin diktatorial të komunizmit, e disa më herët apo më vonë, si temë qendrore shfaqet fati i njeriut dhe i kombit, malli për vendlindjen dhe brenga për të, dhembja individuale dhe kolektive e cila kapërthyer mes vargjes, duke u përvijuar mes metaforash, simbolesh e figurash interesante, jehon si artikulum i fuqishëm poetik. Vuajtja nëpër burgjet e Durrësit e Burrelit, revolta e drama e brendshme shpirtërore, mungesa e lirisë, edhe qëndrimi larg atdheut, pra gjithë përvoja vetjakë e autorit dhe rrugëtimi i gjatë i tij drejt idealeve, gërshetohen me shpirtin krijues të autorit, arti i të cilit tejkalon ndjesitë personale të unit lirik, duke i ngritur në dimension më të gjerë, filozofik e universal. Përmbledhja “Lundërtarë” veçon poezi të një lirisimi ligjërimit i të cilit anon ka romantizmi mes përshkrimesh, detajesh e një gjuhe elegante.

Poezia “Kujtime fëmijërie” me ndërtim të ngjashëm të strofës safike, ndërtuar nga strofa katrenash me tri vargjet e para më të gjata, dhe pasuar gjithmonë nga një varg i shkurtër, është një panoramë kujtimesh të vendit ku ka jetuar fëmijërinë autori, njerëzve të dashur me të cilët është rritur, detajet e shtëpisë që ia zgjojnë mallin dhe ndjesitë, pemët e lulet e kopshtit, mandi i moçëm, dhomat e zbehta të shtëpisë ku

prej pemëve nuk mund të hyjë rrezja e diellit, përjetimi i puthjes nga një nuse së cilës i vesh krahasimin e bukur *nuse bardh si shkume detesh*, rikujtimi i dashurisë së parë, puthjes së parë nga një burbuqe, si e quan subjekti lirik, aty ku përvijohet ambienti i ditëve fëmijërore. Një lirizëm i pastër me ngjarje e situata të së shkuarës, detaje dhe veprime të shpërfaqura me nota të buta e melankolike, me kujtesën e gjallë dhe të përherëshme për vendlindjen, ku shtjellohet biografia shpirtërore e autorit.

Autori i këndon shtresës së varfër, fshatarit e bujkut që punon me nder për bukën e gojës, zellit e paqes shpirtërore që i karakterizon ata, si në poezinë “Nga dritareja e çilun”, që shfaqet si idil i këndshëm, apo edhe në poezinë “Sonatë fusharake” ku glorifikohen punët e rënda e lodhja në fushë e fshatarëve, sepse është e ndershme dhe frytdhënëse, për të shtresuar përfytyrimin e netëve plot jetë pas lodhjes, edhe dashurisë e këngës së jetës që mbretëron nëpër kasolle.

*Fryn flladi i dlinë i plepavet
e merr me veshje jonet e një kangë
plot dashuni e uzdajë.
Asht kanga qi një nanë i këndon foshnjës
tu e përkundun nëdjep.
Flen foshnja tue kqyr hyzjt
flen nana tue kqyr fosljen* (Pipa, 1998:63)

